CISP
COMITATO INTERNAZIONALE PER LO SVILUPPO DEI POPOLI

QSB
Qendra Sociale Balashe

# Histori jete

Tirane 2004

CISP
COMITATO INTERNAZIONALE
PER LO SVILUPPO DEI POPOLI

QSB
Qendra Sociale Balashe

# Histori jete

Tirane 2004

Per realizimin e kesaj permbledhjeje falenderojme
Dr. Nora Habed, per mbeshtetjen teknike dhe ne menyre te veçante te gjithe punonjesit dhe stafin e CISP-it per marrjen e intervistave

Per la realizzazione di questa racolta si ringrazia la
Dott.ssa Nora Habed, per il supporto tecnico ed in particolare tutti gli operattori e lo staff del CISP per la conduzione delle interviste





## PREZANTIM

*Ne Shqiperi, proçesi i thelle i ndryshimit te permbajtjes ekonomike dhe sociale, ne vazhdim duke filluar nga fillimi i viteve '90, eshte treguar veçanerisht kompleks per disa grupe me vulnerabile te popullsise, te cilet kane perjetuar direkt rrugen dhe pasojat e tranzicionit. Per kete qellim, ne kuadrin e proçesit te identifikimit te nevojave dhe te hipotezave projektuale per realizimin te aktiviteteve te kooperimit te Ministrise se Punes dhe Ceshtjeve Sociale shqiptare dhe Qeveria Italiane, Ministria e Punes dhe Ceshtjeve Sociale, eshte hartuar nje program integrues, "Programi ELBASAN", i orientuar drejt fuqizimit te sherbimeve ne favor te grupeve me vulnerabile: te te moshuarve, personave me aftesi te kufizuar, femijeve dhe grave ne veshtiresi, ne territorin te Rajoni dhe te Prefektures se Elbasanit, sot Qarku i Elbasanit.*

*Programi, i realizuar ne dy makro – faza, ka filluar ne vitin 2000 dhe tani gjendet ne fazen perfundimtare.*

*Ne brendesi te "Programit Elbasan", OJF – te italiane: Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli - CISP, Progetto Sviluppo e MOVIMONDO, kane perqendruar aktivitetet e veta per krijimin e "Qendres Balashe" si referim unik per perkrahjen e integruar te te moshuarve dhe te personave me aftesi te kufizuar dhe ne veçanti, CISP – i ka punuar mbi perkrahjen e te moshuarve ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i Sherbimeve te Perkrahjes ne Favor te te Moshuarve ne Prefekturen e Elbasanit".*

*Qendra Balashe, sot njihet si figura juridike autonome me nje statut te saj, me perkrahjen e Bashkise Elbasan dhe te Sherbimit Social Shteteror sot me S.S.S. Qendra eshte unike ne llojin e saj ne te gjithe Shqiperine dhe konsiderohet nga organizata te tjera nderkombetare dhe nga vete institucionet shqiptare si model per tu perseritur.*

*Me kete volum, CISP ka dashur ti jape ze protagonisteve te qendres Balashe dhe pa dyshim deshmimtareve te privilegjuar te historise se Shqiperise.*

*Pasuria e ngjarjeve reale te perjetuara nga disa prej te moshuarve, qe kane realizuar me CISP – in eksperienca e Qendres Balashe, dhe tregimet e tyre, jane fragmente qe ata kane dashur te na dhurojne e qe, me kete publikim, ne duhet te ndryshojme.*

***Deborah Rezzoagli***
***Pergjegjese e programeve ne Shqiperi te CISP -it***





## PRESENTAZIONE

*In Albania, il profondo processo di cambiamento del tessuto economico e sociale, in corso a partire dall'inizio degli anni 90', si è rivelato particolarmente complesso per alcuni gruppi più vulnerabili della popolazione, i quali hanno vissuto direttamente il percorso e le conseguenze della transizione. A questo proposito, nell'ambito di un processo di identificazione dei bisogni e di ipotesi progettuali per la realizzazione di attività di cooperazione fra il Ministero del Lavoro e dell'Assistenza Sociale albanese ed il Governo Italiano, Ministero del Lavoro e della Solidarietà Sociale, è stato elaborato un programma integrato, "Programma ELBASAN", orientato al potenziamento dei servizi a favore delle fasce più vulnerabili della popolazione: anziani, disabili, minori e donne in difficoltà, nel territorio del Distretto e della Prefettura di Elbasan, oggi Regione di Elbasan*

*Il programma, realizzato in due macro-fasi, ha avuto inizio nel 2000 ed è oggi in fase conclusiva.*

*All'interno del "Programma Elbasan", le ONG italiane: Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli - CISP, Progetto Sviluppo e MOVIMONDO, hanno concentrato le proprie attività per la creazione del "Centro Balashe" come riferimento unico per l'assistenza integrata di anziani e disabili ed in particolare, il CISP ha lavorato sull'assistenza agli anziani nell'ambito del progetto: "Potenziamento dei Servizi di Assistenza a Favore della Popolazione Anziana Della Prefettura Di Elbasan".*

*Il Centro Balashe, ad oggi è riconosciuto come figura giuridica autonoma con un suo statuto, sotto gli auspici del Comune di Elbasan e dell'AGASS. Il centro è anche unico nel suo genere in tutta l'Albania e considerato da altre organizzazioni internazionali e dalle stesse istituzioni albanesi. come modello da replicare.*

*Con il presente volume, il CISP ha voluto dare voce ai protagonisti del centro Balashe e senza dubbio a testimoni privilegiati della storia dell'Albania.*

*La ricchezza dei reali vissuti di alcuni degli anziani, che hanno realizzato con il CISP l'esperienza del Centro di Balashe, ed i loro racconti, sono frammenti che loro hanno voluto regalarci e che, con questa pubblicazione, noi vogliamo ricambiare.*

***Deborah Rezzoagli***
***- Responsabile programmi in Albania del CISP***





## MOSHA E TRETE NJE REALITET SOCIAL DINAMIK

Te shkruash per moshen e trete, une do te thoja se eshte e veshtire. Behet kjo me e veshtire te komunikosh e te trasmetosh tek njerez e grupe, te cilet i perkasin moshave, kulturave pse jo edhe interesave te ndryshme. Komuniki nepermjet historise se jetes me duket intriguese dhe e gjetur aq sa edhe une do te deshiroja te prezantoja jo pa histori moshen e trete sipas kendveshtrimit te Zyre Rajonale te Sh.S.Sh. Elbasan.

Para vitit 1990 ne kontekstin shqiptare mosha e trete nuk eshte nje politike, administrim, grupim, statistike me konteks social. Sistemi i kaluar moshen e trete si edhe grupimet apo fenomenet sociale (do te mbaja rezerve ne kuptimin e fjales) i trajtonte ne kontekstin e filozofine e administrimit burokratik dhe jo pak ideologjik. Sistemi ofronte per moshen e trete mbeshtetje nepermjet skemes e pensioneve dhe trajtimin rezidencial, azilant, kete te kufizuar per ata te moshuar te cilet nuk kishin familjare me te cilet mund te jetonin apo bashkejetonin.

Ndryshimet politike te viteve '90 e perball moshen e trete me tre alternativa. Para se ti prezantoj i kerkoj lexuesit ti rikujtoje me qellim qe te kuptojme dinamiken ashtu dhe nivelin ku jemi sot.

*Alternativa e pare*: perfitimi nga skema e pensionve. Kjo skeme ofronte nje shume te ardhurash mujore e cila ne kontekstin ekonomik te kohes, zhvleresimin e vazhdueshem dhe te shpejte te monedhes vendase dhe ngritjen e cmimeve nuk plotesonte nevojat jetike minimale. Gjithashtu kjo skeme mbarte diferencime jo te vogla midis perfituesve banor ne qytet e banore ne fshat, kjo e fundit jo per arsye te vendbanimit por te historise se punesimit.

*Alternativa e dyte*: sistemimi ne qendra rezidenciale per te moshuarit. Kjo alternative ishte mjaft e kufizuar. Ne te tere vendin

mbeteshin te hapura e te trasheguara 5 qendra azilante me karakter nacional dhe kapacitet te kufizuar. Trajtimi ne keto qendra eshte vetem sherbim me ushqim e hoteleri, pra strehim.

Alternativa e trete: (i kerkoj ndjes lexuesit) abandonimi, braktisja, varferia e rruga.

Ne maj te vitit 1993 Parlamenti Shqiptare miraton ligjin e pare me permbajtje sociale, ne te cilin gjejne mbeshtetje dhe merren persiper te drejtat sociale te individit. Miratimi i Ligjit Nr. 7710 date 18.05.1993 i hapi rruge realizimit te politikave sociale, krijimit te strukturave administrative, pergjegjesise dhe detyrimit te shtetit shqiptare ndaj grupeve sociale. Theksimi i ketij ligji nuk perjashton faktin se ligjet e tjera para tij nuk kane parasysh nje konteks social. Do te deshiroja te ndaja me lexuesin te njejtin opinion mbi ligjin e privatizimit te banesave shteterore. Ky ligji u dha shansin dhe praktikisht mundesoi mos braktisjen e te moshuarve dhe te qenurit i pastreh. Mungesa e strehimit u shfaq si fenomen i shoqerise dhe jo i izoluar tek mosha e trete. Pa frike mund te themi se me teper ne drejtim te strehimit e te abandonimit per moshen e trete, si fenomen social, solli renia ekonomike nga lulezimi i firmave piramidale se vitet 1990 deri 1993.

Qe nga viti 1993 e deri ne 2004 mosha e trete nuk ka qene jasht vemendjes se politikes dhe administrimit te realitetit social.

Ne argument te kesaj do te deshiroja te prezantoj:

Se pari: ekziston dhe eshte permiresuar vazhdimisht kuadri ligjore i cili i njeh moshes se trete te drejten e perfitimit te ndihme ekonomike si nje nga format e mbeshtetje sociale qe ofron shteti per individet e familjet ne veshtiresi ekonomike apo me aftesi te kufizuara. Aktet ligjore kryeore jane: Ligji 7710 date 18.05.1993, VKM nr. 113 date 31.03.2002. Udhezimi nr. 927/4 date 31.05.2002, VKM 277 date 18.06.1997. Ne to eshte percaktuar e drejta e perfitimit, kriteret e perfitimit, masa, procedura dhe dokumentacioni i nevojshem.

Gjithashtu eshte e regulluar me akte ligjore e nenligjore e drejta e perfitimit nga sherbimet sociale qe ofrohen si ne qendra publike ashtu dhe ne qendra jopublike, VKM 510 date 24.11.1997.

Se dyti: mosha e trete per Sh.S.Sh perben nje grupim social te targetuar. Ne hartimin e Strategjise Kombetare te Zhvillimit te Sherbimeve Sociale per periudhen 2002 – 2007, dokument tashme i





perfunduar, mosha e trete ishte nje nga 5 grupimet sociale te identifikuar i barabarte (me jetim, te rinjt, gruan dhe personat me aftesi te kufizuar) per nga nevoja per mbeshtetje.

Se treti: eshte zgjeruar gama e sherbimeve sociale ne favor te moshes se trete. Nga nje fillim me 5 institucione rezidenciale nacionale, ku theksojme asnje ne territorin e Qarkut Elbasan, sot konstatohen sherbime e qendra sherbimesh ditore te shperndara ne territorin e vendit. Qendrat rezidenciale sot ofrojne nje sherbim me te kualifikuar dhe konteks social. Ne funksion te qellimit te deinstitucionalizimit te azilanteve keto qendra kane pesuar ndryshime strukturore dhe funksionale. Ne to ndeshet figura e punonjesit social, e psikologut dhe hartohen e realizohen aktivitete me karakter social.

Ne Elbasan do te veconim Q.S. Balashe si nje nga qendrat model i konceptimit, funksionimit dhe standartit te sherbimit per te gjithe vendin. Nuk do te anashkaloja dhe sherbimet ditore, kryesisht sherbimet e mences, te ofruara nga shoqata te ndryshme ne periudha te ndyshme, si Kolpingu, "Ne dobi te gruas shqiptare" Dega Elbasan etj. Realiteti i Elbasanit sot i ofron moshes se trete nje tipologji e sherbim te kualifikuar. Ne kete realitet konstatojme se po konturohet edhe nje tipologji e re sherbimi, ajo e klubeve sociale, si qendra komunitare me konteks integrues te te moshuarve.

***Ardian Stafa***
***Drejtor i sherbimeve sociale shteterore***

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

## TERZA ETÀ UNA REALTÀ SOCIO – DINAMICA

Scrivere sulla terza età, direi che è difficile. Ciò si fa più difficile quando devi comunicare e trasmettere a persone che appartengono a gruppi di età, culture ed interessi diversi. La comunicazione tramite le storie di vita mi sembra interessante ed adeguata al punto tale da voler presentare una storia della terza età dal punto di vista dell'Ufficio Regionale dei Servizi Sociali Statali Elbasan.

Prima del 1990, nel contesto sociale Albanese, la terza età non era politica, non era gestione, raggruppamento, o statistica. iIl sistema precedente agli anni 1990, trattava la terza età, così come anche altri gruppi o fenomeni sociali, nel contesto filosofico della amministrazione burocratica e non poco ideologica. Il sistema offriva un sostegno agli anziani, tramite lo schema delle pensioni e del trattamento residenziale, quest'ultimo limitato agli anziani che non avevano familiari con i quali potevano vivere o convivere.

I cambiamenti politici degli anni '90 hanno affrontato la questione della terza età seguendo tre alternative. Prima di presentarle chiederei al lettore di ricordare e capire le dinamiche dei tempi in cui ci troviamo oggi.

*Prima alternativa*: usufruire dello schema delle pensioni. Questo schema offriva una somma di denaro mensile, che nel contesto economico del tempo, con la svalutazione continua e veloce della moneta e l'aumento dei prezzi, non copriva i bisogni minimi per vivere. In oltre questo schema rivelava non piccole differenze fra gli abitanti delle aree urbane e quelle rurali relative alle tipologie del lavoro.

*Seconda alternativa*: la sistemazione nei centri residenziali per anziani. Questa alternativa era abbastanza limitata. In tutto il paese erano aperti 5 centri residenziali nazionali, con capacità limitate. Il trattamento in questi centri consisteva nel dare pasti ed un posto letto.

*Terza alternativa*: (chiedo scusa al lettore) l'abbandono e la povertà della strada.

Nel maggio del 1993 il Parlamento Albanese ha approvato la prima legge con un sostanziale contenuto sociale, nel quale trovano sostegno e si assumono i diritti sociali dell'individuo. L'approvazione della legge nr. 7710 del 18.05.1993 ha aperto la strada alla realizzazione delle politiche sociali, alla creazione delle strutture amministrative, alla responsabilità e ai doveri dello stato albanese verso i gruppi sociali.

Leggi precedenti alla sopra citata, avevano tenuto conto del contesto sociale, ma non in maniera così approfondita.

Vorrei condividere con il lettore la mia stessa opinione sulla legge sulla privatizzazione delle abitazioni statali. Questa legge ha favorito e praticamente ha reso possibile la diminuzione del fenomeno dell'abbandono degli anziani. In realtà la mancanza dell'alloggio apparve come un fenomeno sociale non solo relativo alla terza età.

Senza timore possiamo dire che una causa dell'abbandono degli anziani, come fenomeno sociale, è stato in particolare il crollo economico e il fiorire delle ditte piramidali negli anni 1990 fino al 1993.

Dal 1993 fino al 2004 gli anziani non sono stati lasciati fuori dall'attenzione della politica e amministrazione della realtà sociale.

A questo proposito vorrei presentare i seguenti passi fatti:

Primo: esiste ed e' anche migliorato continuamente il quadro legale che riconosce agli anziani il diritto di usufruire dell'aiuto economico, come una delle forme di sostegno sociale che lo stato offre agli individui e alle famiglie in difficoltà economiche o con capacità limitate. Gli atti legali principali sono: Legge 7710 del 18.05.1993, DCM nr. 113 del 31.03.2002. Direttiva nr. 927/4 del 31.05.2002, DCM 277 del 18.06.1997. In essi e' stati definiti il diritto, i criteri, l'ammontare, la procedura e la documentazione necessaria per usufruire dell'aiuto economico.

In oltre e' stato definito con atti legali il diritto di usufruire dei servizi sociali che si offrono nei centri pubblici e non pubblici, DCM nr.510 del 24.11.1997.





Secondo: la terza età per il Servizio Sociale Statale rappresenta un raggruppamento sociale target. Nella elaborazione della Strategia Nazionale dello Sviluppo dei Servizi Sociali per il periodo 2002 – 2007, documento ormai finito, la terza età è uno dei 5 raggruppamenti sociali identificati, insieme agli orfani, giovani, donne e disabili, in qualità di gruppi bisognosi di particolare sostegno.

Terzo: e' stata ampliata la gamma dei servizi sociali a favore degli anziani. Da 5 istituzioni residenziali nazionali, di cui nessuno sul territorio della Regione di Elbasan, oggi constatiamo l'esistenza di servizi e centri diurni distribuiti su tutto il territorio nazionale. I centri residenziali oggi offrono un servizio più qualificato ed un miglior contesto sociale.

In funzione della deistituzionalizzazione degli anziani, questi centri hanno subito cambiamenti strutturali e funzionali. In essi si incontra la figura dell'operatore sociale, dello psicologo e si elaborano e si realizzano attività con carattere sociale.

Ad Elbasan, vorrei menzionare, il Centro Sociale Balashe come uno dei centri modello per la creazione, il funzionamento e gli standard del servizio, per tutto il paese. Non vorrei lasciare da parte anche i servizi diurni, in particolare i servizi di mensa offerti da diverse associazioni in diverse periodi, come nel caso della associazione Kolping "A favore della donna albanese" per Elbasan. La realtà di Elbasan oggi offre alla terza età una tipologia ed un servizio qualificato. In questa realtà constatiamo che si sta formando anche una nova tipologia di servizi, di club sociali, come centri comunitari con l'obiettivo di sostenere ed integrare gli anziani.

***Ardian Stafa***
***Direttore dei servizi sociali statali***

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

## QELLIMI I MBLEDHJES SE HISTORIVE TE JETES

Mbledhja e historive te jetes mbi «Deshmitaret e nje historie te harruar» ka si qellim qe te nxjerre ne pah ngjarjet e perjetuara te disa te moshuarve te qendres Balash ne menyre qe te mund ti bejme homazh shume protagonisteve anonime te cilet nepermjet kujtimeve te tyre na bejne qe te zbulojme nje vend i cili ka njohur vuajtjen dhe mjerimin por edhe deshiren per te jetuar dhe te enderruar. Keto histori na deshmojne mgi te gjitha, qe panvarsisht nga mosha, zemra e njeriut nuk ka rrudha.

Per te realizuar kerkimin qe kam koordinuar, eshte perdorur metodologjia biografike, pra modeli cilesor - historik i krijuar nga profesori Gerard Lutte, docent i psikologjise se zhvillimit ne Universitetin « La Sapienza » di Roma. Ky model e ve theksin mbi unikshmerine e personit nepermjet degjimit te historise mbi jeten e tij, ne te cilen i intervistuari flet per vete dhe per ngjarjet e perjetuara nga ai. Per kete motiv perdoret, teknika e intervistes se lire, ne te cilen tregimi zhvillohet si nje bashkebisedim spontan. «Kerkuesi» nderhyn vetem per te sqaruar disa pika ose per te kompletuar pjese te historise ende te pa thena. Eshte per tu theksuar se «kerkuesit», jane te njejtat operatore sociale te qendreste cilat kishin nje marredhenie te mire me te moshuarit.

Para se te fillonim intervistat, zhvilluam mbi metoden e kerkimit, nje kurs te shkurter pregatitjeje me operaret te cilat deshironin te benin kete pune, sepse kishte rendesi te madhe qe te gjitha te ndiqnin te njejten rruge kerkimi.

Me cdo te moshuar te zgjedhur, te ndihmuara dhe nga nje regjistrator me konsensusin e tyre paraprak, jane realizuar tre - kater takime me me shume se dy ore secila. Te moshuarit kane folur spontanisht, duke zgjedhur vete momentin e jetes se tyre per te filluar

tregimin. Hap pas hapi qe takimet vazhdonin, rregjistrimet degjoheshin, zbertheheshin dhe shkruheshin sipas nje liste se temave te perbashketa per te gjitha intervistat, keshtu ishte e mundur te kuptohej se cilat ishin pjeset qe mungonin duke i ndihmuar qe ti vendosnin historite sipas nje rendi kronologjik ne menyre qe cdo tregim te mund te ishte sa me koherent qe te jete e mundur dhe per ti dhene nje kuptim sa me te plote.

Cdo tregimi i eshte dhene nje titull i dale nga konteksti i cili pasqron ne menyre domethenese jeten e cdo te moshuari.

Ne leximin e ketyre historive duhet qe te mbahet parasysh qe kujtimet e jetes per te moshuarit, ashtu si per cdo njerin nga ne, mund te kene idealizma te frikes se pathene, te vuajtjeve te medha, te mbrojtjes, te cilat i kane ndihmuar per te jetuar dhe per te pasur vazhdimesine e kujtimeve.

**Lista e temave mbi te cilen eshte punuar eshte si me poshte:**

## DESHMITARET E HISTORISE SE HARRUAR (TITULLI PER TU MODIFIKUAR NEPERMJET HISTORIVE QE SHFAQEN)

Prezantim i ambientit ne te cilin eshte rritur i intervistuari/a
Vendi / qyteti i origjines dhe familja

- Qyteti apo fshati
- Babai
- Arsimi dhe punesimi i babait
- Nena
- Arsimi dhe punesimi i nenes
- Vellezerit / motrat
- Arsimimi dhe punesimi i vellezerve / motrave
- Raporti midis nenes dhe babait
- Tipi i edukimit familjar
- Besimi fetar
- Niveli social – ekonomik i familjes
- Perceptimi dhe pershkrimi i ambientit kulturor ne vendin e origjines





## NGJARJET E PERJETUARA GJATE HISTORISE SE KETIJ SHEKULL NE SHQIPERI

**Faza e pare historike**

- Çfare kujtoni nga femijeria juaj, nga familja juaj.... nga gjysherit
- Çfare kujtoni nga shkolla juaj, shoket, kush shkonte ne shkolle
- Si ishte jeta atehere ( punet qe beheshin, kushtet e varferise te vendit dhe /ose te vet familjes, çfare benit ne kohen e lire, pjesemarrja ne aktivitetet politike te ndonje anetari te familjes)
- Kujtime te para luftes. Çfare ju kane treguar ne familje rreth luftes se pare boterore (si e kane perjetuar). Kujtime te periudhes se monarkise (1928 – 1939).

**Faza e dyte historike ( perafersisht 1939-1948)**

- Kur nuk jeni ndjere me femije (ndryshimet e mundshme ne familje gjate rritjes suaj)
- Çfare kujton nga shkolla (kush shkonte, si ishte e organizuar, lloji i arsimimit qe merrej, marredheniet midis shokeve, marredheniet midis vajzave dhe djemve)
- Si ishte jeta atehere ( punet qe beheshin, situata sociale e vendit, koha e lire, angazhimet sociale, pjesemarrja ne aktivitetet politike: kush merrte pjese, çfare behej)
- Kujtimet nga pushtimi italian (1939-1943), gjerman (1943-1944) dhe problemet me kufijte e Shqiperise: si i kane perjetuar
- Kujtimet gjate luftes
- Kujtimet te hyrjes ne fuqi te E. Hoxhes ( dhe afrimiteti me Titon)

**Faza e trete historike (1948-1990 perafersisht)**

- Eksperienca te reja te perjetuara nga nje i moshuar (studime te ndryshme, punet, marredheniet me familjen, marredheniet sentimentale)
- Situata sociale dhe politike e vendit, kush merrte pjese, çfare behej, kushtet e jetes ne ate periudhe
- Si e ka perjetuar kete periudhe. Çfare bente ai / ajo
- Kujtime gjate regjimit te E. Hoxhes ( mbyllja e vendit me boten e jashtme, hapja sipas modelit sovjetik dhe kinez) mbyllja fetare
- Miqesite
- Koha e lire

## PERIUDHA AKTUALE (pas viteve '90)

- Çfare marredheniesh familjare dhe sociale
- Aktiviteti i perditshem: si e kaloni kohen
- Duke perjetuar humbjen, marredheniet me idene e vdekjes
- Shpresat dhe frikat
- Roli ne kuadrin familjar dhe social
- Situata sociale dhe politike e vendit sot, çfare ndjeni qe ka ndryshuar ne jeten tuaj si dhe ne ate te vendit
- Si jetohet ne kete periudhe pas E. Hoxhes dhe hapjes me jashte

**Nese keni femije te cilat jane emigrante**

- Arsyet
- Zgjedhja e qytetit / vendit te ri
- Si eshte marre ky vendim
- Si ndodhi nisja
- Si u perjetua nisja nga i / e intervistuari / a
- A keni bere projekte te perbashketa me djalin apo vajzen?
- Ndryshimet kulturore dhe sociale te cilat kane çuar drejt emigracionit djalin / vajzen

***Dr. Nora Habed***





## SCOPO DELLA RACCOLTA DELLE STORIE DI VITA

La raccolta di storie di vita sui "Testimoni di una storia dimenticata", ha lo scopo di far emergere il vissuto di alcuni anziani del centro di Balash perché si possa rendere omaggio a tanti protagonisti anonimi che attraverso la loro memoria ci fanno riscoprire un paese che ha conosciuto la sofferenza e la precarietà ma anche la voglia di vivere e di sognare. Queste storie ci testimoniano innanzitutto che, nonostante l'età, il cuore umano non ha rughe.

Per realizzare la ricerca che ho coordinato, si è utilizzata la metodologia biografica, cioè il modello qualitativo-storico creato dal prof. Gérard Lutte, docente di psicologia dello sviluppo all'Università La Sapienza di Roma. Questo modello pone l'accento sull'unicità della persona attraverso l'ascolto del racconto della sua vita, in cui l'intervistato parla di sé e del suo vissuto. Si utilizza per questo motivo, la tecnica dell'intervista libera, in cui la narrazione si sviluppa come una conversazione spontanea. Il "ricercatore" interviene soltanto per chiarire alcuni punti o per completare parti della storia ancora non dette. E' da segnalare che i "ricercatori", sono state le stesse operatrici del centro le quali avevano già un buon rapporto con gli anziani.

Prima di incominciare le interviste, abbiamo svolto sul metodo di ricerca, un breve corso di preparazione con le operatrici che si erano offerte a questo lavoro, perché aveva grande importanza che tutte seguissero lo stesso percorso d'indagine.

Con ogni anziano prescelto, aiutati da un registratore previo loro consenso, si sono realizzati tre-quattro incontri di oltre due ore ciascuno. Gli anziani hanno parlato spontaneamente, scegliendo il momento della propria vita da cui incominciare il racconto. A mano a mano che gli incontri procedevano, le registrazioni veniva sbobinate

e trascritte secondo una lista di temi comune a tutte le interviste, così è stato possibile capire quali erano le parti mancanti e si era anche facilitati a mettere le storie in un ordine cronologico perché ogni narrazione potesse essere il più coerente possibile e per dare a tutte un senso compiuto.

A ogni racconto si è dato un titolo emerso dal contesto della narrazione che rispecchiasse significativamente la vita di ogni anziano.

Nel ripercorrere queste storie bisogna tener presente che i ricordi di vita degli anziani, come di ognuno di noi, possono risentire di idealizzazioni, di paure non dette, di sofferenze sublimate, di difese, che li hanno aiutati a vivere e ad avere la continuità della memoria.

**La lista dei temi su cui si è lavoro è stata:**

## TESTIMONI DELLA STORIA DIMENTICATA (TITOLO DA MODIFICARE ATTRAVERSO LE STORIE CHE EMERGONO)

Presentazione dell'ambiente in cui è cresciuto l'intervistato/a
Paese/città d'origine e famiglia

Città o villaggio
Padre
Istruzione ed occupazione del padre
Madre
Istruzione ed occupazione della madre
Fratelli/sorelle
Istruzione ed occupazione fratelli/sorelle
Rapporti tra madre e padre
Tipo di educazione familiare
Religione
Livello socio-economico della famiglia
Percezione e descrizione dell'ambiente culturale del paese d'origine





## I PROPRI VISSUTI DURANTE LA STORIA, IN QUESTO SECOLO, DELL'ALBANIA

**Prima fase storica**

Cosa si ricorda della sua infanzia, della sua famiglia... dei nonni

Cosa si ricorda della sua scuola, dei compagni, chi ci andava a scuola

Come era la vita allora ( lavori che si facevano, condizioni di povertà del paese e/o della propria famiglia, cosa si faceva nel tempo libero, partecipazione in attività politiche di qualche membro della famiglia)

Ricordi prima della guerra . Cosa gli raccontavano in famiglia di come avevano vissuto la I guerra mondiale. Ricordi del periodo della monarchia (1928-1939)

**Seconda fase storica (1939-1948 approssimativamente)**

Quando non si è sentito più bambino (eventuali cambiamenti in famiglia durante la sua crescita)

Cosa si ricorda della scuola (chi ci andava, come era organizzata, tipo di istruzione che si riceveva , rapporto con i compagni, rapporto tra i ragazzi e le ragazze)

Come era la vita allora ( lavori che si facevano, situazione sociale del paese, tempo libero, impegni sociali, partecipazione in attività politiche: chi partecipava, cosa si faceva)

Ricordi della occupazione italiana (1939-1943), tedesca (1943-1944) e problemi con i confini dell'Albania: come li ha vissuti

Ricordi durante la guerra

Ricordi dell'ascesa al potere di Hoxa (e vicinanza a Tito)

**Terza fase storica (1948-1990 approssimativamente)**

esperienze nuove vissute da adulto (eventuali studi, lavori, rapporti con la famiglia, rapporti sentimentali)

situazione sociale e politica del paese, chi partecipava, cosa si faceva, condizioni di vita dell'epoca

come ha vissuto questo periodo . Cosa faceva lui/e

Ricordi durante il regime di Hoxa (chiusura del paese verso l'esterno, apertura al modello sovietico e alla via cinese), chiusura religiosa

Amicizie
Tempo libero

**PERIODO ATTUALE (dopo anni '90)**

Quali relazioni familiari e sociali
- attività quotidiane: come passa la sua giornata
vissuti di perdita, rapporto con l'idea della morte
speranze e paure
ruolo nell'ambito della famiglia e del sociale
situazione sociale e politica del paese oggi, cosa sente che ha cambiato nella sua vita e in quella del paese
come si vive in questa epoca dopo Hoxa e con l'apertura verso l'estero

**Se ha figli che sono emigrati**
Motivi
Scelta della nuova città/paese
Come è stata presa la decisione
Come è avvenuta la partenza
Come è stata vissuta la partenza dall'intervistato/a
Ci sono progetti comuni con il figlio/a?
Cambiamenti culturali e sociali che ha portato l'emigrazione del figlio/a

***Dott.ssa Nora Habed***





# Deshmimtaret e Historise se Kaluar

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

| | |
|---|---|
| *Intervistoi:* | *Elida Xherri* |
| Emri: | **Ali Balliu** |
| Datelindja: | Lindur ne Slabinje te Pogradecit me 12. 04.1926 |
| Emri i te atit: | Veiz Balliu |
| Profesioni i te atit: | Murator, pa arsim |
| Emri i te emes: | Zybe Balliu |
| Profesioni i te emes: | shtepiake, pa arsim |

## HISTORIA E JETES TIME

Kjo histori qe do t'ju tregoj mund te jete historia e shume njerezve te tjere si puna ime e cila ka kaluar ne disa faza te ndryshme historike.

Une kam lindur ne fshatin Slabinje te qytetit te Pogradecit ne 12.04.1926.Rrjedh nga nje familje fshataresh te cilet siguronin jetesen e tyre per te punuar token. Nuk mund te them qe ishim nje familje e varfer por as dhe nje e pasur. Prinderit e mi kane qene dy njerez te paarsimuar qe jetonin me mundin e tyre, por kjo nuk i pengonte qe te na jepnin ne nje edukate sa me te plote e sa me te mire. Ata kishin nje harmoni shume te mire midis tyre. Nuk me kujtohet asnjehere qe ata te kene bere fjale para syve te mi apo vellezerve dhe motres time. Ne pergjithesi te dy prinderit kane qene me temperament te qete. Babai ishte nje njeri i duruar dhe nuk nxitohesh asnjehere ne marrjen e vendimeve. Per te na bindur ne femijve ai gjithmone na fliste me te bute dhe argumonte arsyet e tij. Ndersa nena mund te them qe ishte nje simbol i nenave shqiptare per femijet. Ajo ishte e dhembshur, punetore e fjaleembel. Ajo gjate gjithe kohes merrej me punet e shtepise per te na siguruar ne femijeve nje ambjent sa me te qete dhe sa me te shendetshem. Familja ime perbehej nga prinderit dhe 6 femije, 5 djem dhe 1 vajze. Edhe ne femijet merreshim me bujqesi si prinderit tane derisa arritem ne nje moshe per te vazhduar arsimin dhe per te ndjekur rruget tona te jetes. Megjithese kushtet per t'u

arsimuar ishin te veshtira ne arritem te kryenim shkollen 5 – vjecare qe ekzistonte ne ate kohe. Keto shkolla 5 – vjecare ose sic quheshin ndryshe kurse kunder analfabetizmit u fomuan pas clirimit te Shqiperise, pasi para clirimit shkollat ishin shume te pakta per te mos thene qe nuk ekzistonin fare. Ne ato shkolla shkonin te gjithe pa perjashtim seksi, feje apo moshe. Kjo solli nje ndryshim te rendesishem ne jeten e vendit, si nga ana e edukimit ashtu dhe nga marredheniet social – kulturore te asaj kohe. Por keto ndryshime nuk erdhen aq lehte. Per te ardhur deri ne keto ndryshime popullit shqiptar i eshte dashur te luftoje e te beje shume perpjekje me kundershtaret e Shqiperise.

Nga femijeria ime nuk me kujtohen dhe aq shume gjera. Me kujtohen pak si mjergull. Kur isha i vogel shkoja tek gjysherit, ata me prisnin gjithmone me dashuri dhe kur kthehesha ne familjen time me lindte perseri deshira per te vizituar gjysherit. Ata ishin nje familje me te ardhura te pakta ashtu si dhe familja ime, por kjo gje nuk i pengonte ne shpirtbardhesine dhe zemergjeresine e tyre. Shumica e popullit ne ate kohe ishin te besimit mysliman. Megjithate kjo nuk kishte pasoja ne marredheniet midis popullsise te besimeve te ndryshme. Edhe familja ime ishte e fese myslimane, por kjo nuk na pengonte te ishim te dashur nga te gjithe, te mirpriteshim nga cdo familje dhe te kishim nje marredhenie shume te mire me fqinjet tane. Kjo gje gjendej ne cdo familje shqiptare. Njerezit ishin shume te preokupuar ndaj punes dhe fatit te vendit. Deri ne vitin 1946 ne familjen time nuk kishte varferi, jeta ishte e mire. Kjo vazhdoi deri ne vitin 1956, vit ky ku prona private u mblodh ne kooperative. Ne ate kohe une isha i punesuar ne polici dhe nuk kam marre pjese drejtperdrejte ne kohen e krijimit te kooperativave.

Luften e pare boterore si gjithe populli shqiptar edhe familja ime e perjetoi me ankth dhe me interes te madh. Ato pritnin me ankth cdo ngjarje qe ndodhte ne ate kohe. Pasi mbaroi lufta e pare boterore prinderit na tregonin ne femijeve ngjarje te ndryshme qe ata ne me te shumten e rasteve i kishin perjetuar vete. Na tregonin per luftime qe kishin ndodhur prane fshatit tone dhe me krenari te madhe tregonin per fitoret qe kishin arritur luftetaret tane ne mbrojtjen





e atdheut. Ata na tregonin edhe per kohen kur ne krye te Shqiperise u vu mbreti Zog. Ne kohen e Zogut ka pasur shume rregull. Ishte i pari qe krijoi shtetin shqiptar. Krijoi rregullat e para dhe kushtetuten si nje shtet. Populli e donte mbretin.

Pasi perfundoi regjimi i mbretit Zog ne Shqiperi u shfaq pushtuesi italian. Ne kohen e pushtimit italian populli shqiptar pati pervec te keqijave dhe avantazhe dhe fitime sepse ne ate kohe u hapen fronte pune si ne ndertimin e rrugeve si dhe ndihmoi ne luften shqiptaro – greke. Pasi mbaroi lufta me Italine ne Shqiperi u shfaq pushtuesi gjerman. Shqiptaret u ndane ne dy drejtime: partizanet dhe Balli Kombetar qe luftuan kunder pushtuesit gjerman. Gjate pushtimit gjerman dy frontet e luftes se shqiptareve u percane midis tyre dhe filluan te luftonin njeri – tjetrin. Kjo ndodhi per shkak te percarjes qe solli udheheqesi Enver Hoxha pas konferences se Mukjes. Ne kete kohe balli mbronte nacionalizmin pra nje Shqiperi te lire ashtu sic kishte qene tradita demokratike. Ndersa Enver Hoxha donte nje udheheqje dhe pushtet te forte mbi popullin. Keto ide Enver Hoxha i kishte fituar nga afrimiteti qe ai kishte me udheheqesin jugosllav Tito, sepse kete menyre udheheqjeje perdorte ai. Ne konferencen e Mukjes, ballistet dhe legalistet nenshkruan nje traktat ku flitej qe pas clirimit Shqiperia duhej te zgjidhte drejtuesit e vet me zgjedhje te lira demokratike. Kur ju paraqit ky pakt Enver Hoxhes ne konferencen e Labinotit bashke me te ishte dhe nje i derguar i Titos i cili kur lexoi paktin i tha Enver Hoxhes se ky pakt nuk i leverdiste Partise Komuniste. Pasi ne qofte se do te kryeshin zgjedhje te lira ne krye te udheheqjes do te viheshin nacionalistet.

Kjo periudhe ndryshimesh perkoi me dhe me ndryshimet e moshes time, kalimi nga femijeria ne nje moshe madhore. Si per cdo njeri edhe per mua ky kalim solli nje sere pergjegjesish dhe natyrisht edhe largimin nga familja ime. Kur u largova nga familja dhe shkova te punoja si polic atehere e kuptova se me te vertete femijeria kishte mbaruar dhe nuk mund te kthehej me. Ne kete periudhe ndryshova shume pasi mbi shpatullat e mija rane pergjejgesite tjera, pergjejesi per te cilat familja ime nuk mund te me ndihmonte. Keto pergjegjesi dalengadale u renduan kur krijova familjen time. Me te vertete krijimi

i familjes time me solli nje gezim shume te madh. Ky gezim u shtua me shume kur ne jete na erdhen femijet tane. Kjo martese nuk u arrit pas nje lidhje dashurore por dashuria ne te nuk mungoi qe ne fillimet e saj. Them qe nuk ishte rezultat i nje lidhje dashurore pasi gruan time nuk e njoha vete por me te me njohu nena ime. Por kjo gje nuk solli ndonje ndryshim ne lumterine tone. Kjo lumturi zgjati aq sa zgjati dhe jeta e gruas time. Me te vertete ajo nuk vdiq ne moshe shume te re por per mua ishte nje humbje e madhe. Kjo vertetoi edhe nje thenie te urte popullore qe sherben si nje mallkim "Te vdekte gruaja ne pleqeri".kjo thenie mund t duket e pakuptimte per nje moshe te re por mua kjo thenie mori kuptim dhe dhimbje te thelle ne shpirtin tim.

Ne shkolle sic thashe dhe me pare ne filluam te shkonim pas clirimit te vendit. Ne kete kohe mosha e vogel vazhdonte shkolle te rregullt diten, kurse ne te rriturit qe nuk dinim te shkruanim dhe te lexonim vazhduam ato kurset kunder analfabetizmit. Rinia ishte e angazhuar shume ne jeten sociale. Ajo merrte pjese aktive ne jeten politike te vendit dhe kishte nje guxim te papare. Ajo sulmonte, luftonte dhe nuk merrte parasysh vdekjen pasi per to Atdheu ishte gjithcka. Edhe une kam marre pjese ne disa beteja. Kemi luftuar diten e naten pa pyetur per veshtiresite. Ashtu si ne cdo beteje kishim te vrare e te plagosur. Me kujtohet fare mire se ne njeren nga betejat na u vra komandanti yne. Ishte nje humbje e madhe per tere kompanine tone. Mundimet e rinise dhe te popullit shqiptar ne lufte kunder pushtuesit u kurorezuan me clirimin e Shqiperise. I gjithe populli pati nje gezim te vecante per kete ngjarje. Por ky gezim nuk zgjati shume. Ai erdhi duke u zvogeluar dhe pas disa vitesh u kthye ne deshperim sepse para se te hynte ne fuqi Enver Hoxha i beri shume premtime popullit per liri, demokraci dhe mireqenie. Por te gjitha keto premtime mbeten ne leter, nuk u zbatuan kurre sepse Enver Hoxha krijoi kooperativat, nuk lejoi pronen private dhe gjendja ekonomike e popullit filloi te veshtiresohej. Pas clirimit Enver Hoxha filloi te eliminonte armiqte e tij. Sic beri me Titon me te cilin me pare kishte nje lidhje shume te forte, me Koci Xoxen etj. Shpesh akuzat ishin te pavend dhe te pabazuara ne faktet konkrete.





Pas clirimit kerkoheshin njerez per te punuar ne polici. Megjithe refuzimin e familjes une bera nje kerkese per t'u punesuar si polic. Dhe kjo deshire e imja u realizua. Gjate kesaj periudhe si shume te tjere edhe une kam punuar si vullnetar ne ndertimin e shume veprave te medha ne ate kohe si per shembull ne tharjen e kenetes te Maliqit, ne ndertimin e hekurudhes Durres – Tirane etj. Te rinjte punonin me gezim ne keto pune vullnetare, sepse ata ndjenin se kjo pune do te ndihmonte shume ne rindertimin e vendit. Asgje nuk i detyronte por ata punonin pa pushim dhe pa u ankuar per punen e lodhshme. Edhe ne jeten politike njerezit merrnin pjese me gezim. Shume njerez u bene anetare te Partise Komuniste. Nder ta ishte dhe vellai im bashke me nje kusheririn tim. Megjithese une nuk u bera anetare i kesaj partie, kjo nuk do te thote qe devotshmeria ime ndaj partise te ishte me e pakta se e te tjereve. Kjo devotshmeri nuk vinte per shkak te nje detyrimi apo obligimi por ishte nje detyrim moral per te gjithe.

Pas ardhjes ne fuqi te Enver Hoxhes filloi izolimi i vendit. Ne fillim u lidh me Bashkimin - Sovjetik dhe vazhdoi per nje periudhe kohe jo shume te gjate. Ne ate periudhe u ndermoren shume iniciativa ne emer te kesaj lidhjeje. Por dalengadale fuqia e kesaj lidhje u zvenit derisa u arrit ne nje pike ku keto marredhenie u nderprene perfundimisht. Me pas Shqiperia u lidh me qeverine kineze dhe filloi te perseritej po e njejta historisi me lidhjen me Bashkimin – Sovjetik. Edhe ne kete periudhe Shqiperia pati shume shkembime kulturore, teknike dhe interesash me kinezet. Pas nje periudhe kohe edhe kesaj lidhje i erdhi fundi dhe Shqiperia u vetizolua ne nje vend ku cdo vend i huaj ishte nje armik i mundshem i saj. Ajo nuk kishte lidhje me vendet e tjera dhe cdo gje kryhej sipas udhezimeve te Partise Komuniste. Qe ne fillimet e saj Partia Komuniste luftoi besimet fetare ne vend dhe praktikonte lajcizmin. Kjo lufte kunder besimeve pati dhe ndikimet e saj. Pepara se te fillonte kjo lufte familja ime i ndiqte ritet fetare si gjithe populli ne pergjithesi, por me gjithe deshiren qe kishte Partia Komuniste per ta shkulur besimin tek njerezit, kryerja e riteve fetare vazhdonte. Njerezit bashke me familjen time i ndiqnin ritet fetare ne fshehtesi sepse ata qe kapeshin duke kryer keto rite fetare denoheshin nga partia dhe familjet e tyre vuanin pasojat e

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

ketij denimi. Por me gjthe perpjekjet e saj Partia Komuniste nuk arriti ta shkulte plotesisht besimin tek njerezit. Kjo u duk me hapjen e demokracise kur popullsia ne pergjithesi filloi ti rikthehej riteve fetare, t'i ndiqte ato sipas feve perkatese. Ne pergjithesi miqesite krijoheshin duke u marre per baze besimi politik dhe besenikeria ndaj partise. Luftoheshin miqesite me njerezit te cilet kishin nje "njolle" ne historine e tyre familjare, dhe arrihej deri aty sa keta njerez perbuzeshin nga shoqeria. Por edhe kjo udheheqje mori fund dhe atehere populli me ne fund shprehu deshperimin dhe zemerimin qe i kishte pushtuar gjithe keta vjet.

Me se fundi populli shqiptar arriti te realizonte deshiren qe kishte enderruar ne gjithe keto vite. Ndryshoi mentaliteti ne marredheniet midis njerezve. Ato nuk kerkonin me lidhjet politike. Ata ishin me te lire per te shprehur mendimet e tyre, deshirat e tyre. Vendi pati zhvillime progresive, por ky lloj ndryshimi i menjehershem solli edhe pasoja negative per popullin shqiptar, pasi u krijua nje papunesi e madhe dhe njerezit rane ne varferi. Megjithese tregjet jane plot me mallra per t'u konsumuar nga njerezit, veshtiresia financiare i pengon njerezit qe t'i realizojne nevojat e tyre. Megjithate ka shume familje qe arrijne nivelin normal te jeteses.

Nder keto familje bej pjese dhe une. Ndonese te ardhurat e mia nuk i siguroj nga puna ime e drejtperdrejte pasi kam disa vite qe kam dale ne pension. Femijet e mi dhe pensioni qe marr nga shteti me sigurojne nje jetese normale. Me te vertete ka familje qe jane te varfera nga ana ekonomike. Liria, demokracia dhe mundesite qe u jepen individeve sot ne kete kohe e lehteson barren e tyre te varferise. Si te gjtha familjet shqiptare edhe une kam nje djale emigrant jashte shtetit. Arsyet e tij per te emigruar ishin kerkimi i nje jete me te mire dhe me kushte per nje ekonomi koherente. Pasi jetoi disa vjet ne demokracine shqiptare me se fundi dhe ai vendosi te nisej si mergimtar per ne shtetin fqinj, Itali.

Ai zgjodhi Italine pasi kultura e atjeshme dhe dashuria e njerezve te atij vendi ia lehtesojne barren emigranteve shqiptare. Une nuk isha dakort qe ai te emigronte pasi ketu mund te siguronte nje jetese normale. Por deshira e tij ishte me forte se deshira ime dhe keshtu ai





u nis fshehurazi drejt shtetit fqinj me nje nga ato anijet e vogla te cilat nuk te sigurojne as jeten sepse ka ndodhur ne shume raste qe njerezit e kane blere vdekjen me gjakun e tyre. Por zoti me deshi mua per te mos me dhene nje fatkeqesi te dyte pas asaj te gruas sime dhe deshi djalin tim sepse ai mberriti ne vendin e endrrave te tij dhe ku keto endrra ai i ktheu ne realitet. Tani edhe une jam i kenaqur me vendimin e tij pasi ai arriti te siguronte nje jete me te mire gje qe duhet ta kisha bere dhe une kur isha ne moshen e tij.

Nuk mendoj te shkoj dhe une tek ai pasi mosha dhe afrimiteti im me njerezit ketu nuk me lejojne ta bej kete gje. Mbi te gjtha ketu kam edhe femijet e tjere bashke me niperit dhe mbesat. Kater djemte e mi dhe vajza ime e vetme perbejne thelbin e jetes sime. Ata me falin kenaqesine dhe deshiren per te jetuar. Kjo gje me kompeson edhe per deshirat e mia rinore qe nuk u realizuan asnjehere.

| *Intervistoi* | *Aurora Malesija* |
|---|---|
| Emri i te intervistuares: | **Efterpi Dhimitruka** |
| Vendlindja: | Elbasan (28 nentor 1929) |
| Emri i te atit: | Mihal Dhimitruka (1883 - 1970), lindur ne Elbasan |
| Profesioni i te atit: | ka kryer shkollen 7 - vjecare. |
| Profesioni: | berber, por ka punuar edhe si guzhinier. |
| Emri i te emes: | Efrosina Dhimitruka (1880 - 1973), ka lindur ne Elbasan |
| Profesioni i te emes: | shtepiake, ka mbaruar vetem shkollen elementare; fliste greqisht te trasheguar nga i ati. |

## TE NDJESH DESHIREN PER TE JETUAR EDHE KUR JE I MOSHUAR

Efterpi ka lindur ne nje familje tipike elbasanase. Shtepia e saj ndodhej brenda ne kala, ne qendren e qytetit. Ajo ruan shume kujtime te bukura. I ati (Mihali) u njoh me te emen e Efterpit, (Efrosinen) ne saje te prinderve te tyre, sepse te dy baballaret e te rinjve ishin prifterinj orthodoks. Kjo qe nje e perbashket, e cila ndikoi shume ne lidhjen e tyre. U martuan kur ajo ishte 17 vjec dhe ai 27 vjec. Nga martesa e tyre, (prinderve) linden 6 femije ku Efterpi ishte e katerta per nga renditja e femijve:

1) Hirakli, ishte marangoz. Ka vdekur ne moshen 83 vjecare ne 2001 nga hemoragjia.

2) Violeta, e cila sot eshte 82 vjec dhe jeton ne Durres. Ka punuar si mesuese.

3) Donika, eshte 78 vjec, ka punuar ne statistike, tani pensioniste.

4) Efterpi, 74 vjec, ka punuar si ekonomiste ne Ministrine e Kultures.

5) Dhimitri, 67 vjec, jeton aktualisht ne Tirane.

6) Frederiku, 62 vjec, jeton ne Elbasan dhe vuan nga neuriti (probleme ne shikim).

**KUJTIMET E FEMIJERISE NA NDIHMOJNE TE RRITEMI**

"Te gjithe individet kujtojne momentet e bukura te jetes se tyre. Keshtu qe dhe une nuk bej perjashtim. Kam mall per ato vite qe nuk kthehen me".

"Shtepia ku kam lindur une binte ne sy per nga arkitektura e saj, pasi kishte 3 cardake me nje kopesht te madh perpara, gje e cila ishte karakteristike per te pasurit e asaj kohe. Babai im (Mihali) kishte pasuri te medha, te trasheguara si ullinj, vreshta rrushi dhe truallin ku ndodhet sot hotel "Skampa" (ne qender te qytetit). Ne shtepine tone kishte nje mireqenie te cilen s' mund t'a gjeje ne te gjitha familjet e asaj kohe. Babai gjithnje na blinte nga nje qengj per ta ngrene ne fundjave. Frutat e shumellojshme nuk na mungonin asnjehere. Veshjet tona ishin me te bukurat e te gjithe femijeve,sepse mamaja na qepte rroba te reja sa here per ditet e festave. Kurse babai im i kishte pike te dobet shetitjet ne ajer te paster.

Marredheniet midis nenes dhe babait tim, per mua ishin model , une i adhuroja. Meqe babai im ishte i edukuar me frymen fetare, ishte tolerant dhe i civilizuar. Ne rolin e kryetarit te familjes ai nuk ishte autoritar ne kuptimin e diktatorit apo perfaqesuesit te familjes patriakale. Ishte njeri i qete, i aresyeshem, largpames, dinte te ngrinte zerin aty ku duhej dhe per kete ai ndryshonte shume nga burrat e tjere. Raporti qe egzistonte mes tij dhe mamase time ishte i shkelqyer , ata nuk ziheshin asnjehere ne syte tane dhe kjo fale uretesise se nenes sime. Nuk ia kthente kurre fjalen. Per kete babai e adhuronte se tepermi dhe gjithmone e ledhatonte tek floket apo i prekte faqet".

Per mua edhe marredheniet qe egsistonin midis nesh femijeve dhe prinderve ishin te perkryera. Ne morem te gjitha normat morale te nje etike te persosur edhe pse prinderit nuk i kishim intelektuale. Kjo ndodhi per shkak te frymes fetare te trasheguar nga gjysherit e





mi te cilet na edukonin qe te silleshin mire, te mos genjenin, te mos vidhnin, te mos kishin zili te tjeret, pra me pak fjale te gjitha gjerat me te mira te kesaj jete. Atehere askush nga femijet nuk kishte te drejte te kundershtonte prinderit, sepse thyheshin normat e miresjelljes Kjo gje nuk ndodhi kurre ne familjen tone, sepse ne dinim t'i respektonim kerkesat e prinderve dhe prinderit na i plotesonin sa here deshirat qe ne kishim.

Shtepia jone ishte pothuajse simboli i djepit te dashurise". Kjo vihet re edhe ne marredheniet e sotme me vellain tim te vogel Frederiku, qe vuan nga syte eshte ndihmuar nga motrat dhe vellezerit e tij, te cilet i kane ndertuar shtepine dhe kane investuar para per te. Kjo marredhenie ka egzistuar qe nga femijeria . Cdo njeri nga ne qe blinte rroba te reja nuk shihej me zili, por me dashuri dhe na dukej sikur i kishim ne ato rroba. Kjo gje ka mbetur e rrenjosur edhe sot ne ditet e sotme".

Duket e pabesueshme gjithe kjo harmoni, por eshte e vertete, sepse ne u rritem nen nje edukacion religjoz dhe me prinder liberal. Babai im ka emigruar ne Amerike qe ne moshen 20 - vjecare dhe u kthye ne Shqiperi ne moshen 27 - vjecare. Kur ai u nis, iku me idene per te mos u kthyer me ne Shqiperi, por u rikthye sepse i ndodhi nje fatkeqesi. I vdiq vellai dhe njerezit e familjes e genjyen me nje pretekst te forte per te ardhur duke e njoftuar se kishte nenen te semure,duke ditur qe ai ishte shume i afeksionuar pas te emes. Babai im iku me dy shoke per ne Amerike, per t'i shpetuar deshires se te babait te vet per t'u bere prift dhe kuriozitetit.

Ai nuk donte te behej prift. Kishte pasion guzhinen dhe kur vajti ne "token e premtuar" ai e ushtroi kete profesion dhe mori gjithashtu nje zanat tjeter, ate te berberit. Babai im ishte nje nder te rinjte e pakte te Elbasanit qe arriti deri ne Amerike sepse shoket e tij apo elbasanasit nuk para shkonin ne kurbet per vet faktin e pozites gjeografike dhe nga ana e mentalitetit, pasi shumica ishin myslimane dhe nuk u lejohej te leviznin nga vendi, pasi mbeteshin grate vetem me femijet, pra behej fjale per fanatizem. Jugu i Shqiperise ishte me i predispozuar per te emigruar. Megjithate kohet kaluan dhe kur babai u kthye ne atdhe solli gjera te reja nga vendi i larget".

Ai ishte ndryshe nga te tjeret, e dashuronte punen. Ishte i lire ne te shprehur dhe ne te gjykuar sepse ne Amerike kishte punuar me njerez te kulturuar dhe domosdo do te merrte disa gjera. Nje tjeter avantazh per te ishte dhe te qenit orthodoks. Ai ishte shume i civilizuar qe ne ate kohe. Madje kjo u trashegua dhe ne plotesimin e deshirave tona, nderkohe qe ne Shqiperine e asaj kohe ishte familja patriakale dhe babai s' kishte te drejte te ishte i hapur me femijet e tij, por autoritar dhe vetem te jepte urdhra. Kurse ne familjen tone ndodhte ndryshe, babai na mbante shume afer, na degjonte me vemendje per problemet qe kishim, na qortonte ndonjehere vetem me shikime, pa na rrahur (nderkohe qe kjo mund te ndodhte). Ai na linte te degjonim muzike me gramafon qe ishte nje gje e rralle, madje une se bashku me motrat organizonim mbremje per fundjave ne shtepine tone bashke me shoqet tona. Gjithashtu shkonim dhe ne Shijon, vend ku ka punuar gjyshi im, dhe benim piknik.

Pervec kujtimeve te bukura ruaj edhe nje kujtim jo te kendshem. Eshte kujtimi kur u dogj shtepia ime. Ishte janar dhe une isha e vogel 4 - 5 vjec. Fatkeqesia ndodhi sepse kur shkuam te flinim dera e sobes nuk kishte qene e mbyllur mire dhe nga pakujdesia rane disa copa prushi dhe shtepia mori flake. U ngritem me rroba gjumi te tmerruar, nuk u besonim syve qe nga gjithe ajo shtepi e bukur nuk mbeti asgje. Ndjeme nje keqardhje te madhe, por qene fqinjet ata qe na qendruan prane dhe na strehuan ne shtepite e tyre ne ate nate te ftohte dimri".

Me pas une vajta ne Durres, ku gjendej motra e madhe e martuar. Ajo e kishte burrin drejtor te shkolles, ku une me vone do te studioja. Une mesoja dhe kisha rezultate te mira sepse mundohesha te justifikoja pranine e drejtorit apo influencen e tij ne opinionin e te tjereve. Pastaj u ktheva ne Elbasan per te kryer gjimnazin. Nga ajo periudhe kam kujtime shume te bukura" - Kam pasur dy shoqe te ngushta Elvira dhe Eta. Ishim si motra. Kohen e lire e kaloja me to duke luajtur me top ose duke shetitur. Mesonim bashke ne shtepite e njera - tjetres. Nga kujtesa une isha me e forte. Njehere e lexoja mesimin dhe i fiksoja gjerat e rendesishme. Me pas i mbaja me muhabet mikeshat e mia dhe i lija pa studiuar. Gjithashtu une isha me shakaxhesha nga natyra kisha nje ndjenje te holle humori. Ne





oren e mesimit une i beja shoqet per te qeshur, i ngacmoja dhe qendroja serioze. Atehere mesuesi i nxirrte jashte te dyja shoqet e mia dhe iu thoshte se duhet te merrnin shembull nga une. Gjimnazin nuk arrita ta perfundoja deri ne fund sepse kur une isha ne vit te trete doli nje lajmerim per nje kurs ekonomie, i cili ishte i barasvlefshem me universitetin. E mbarova kete kurs me rezultate te mira dhe u emerova ekonomiste ne Komitetin e Partise.

**- Si ishte jeta ne ate kohe kur ju ishit e re?**

Qendron per nje moment dhe tregon:

- Ishte nje jete e qete dhe jo si kjo e sotmja. Punet qe benim ne ate kohe ishin pune zejtarie, pune dore, sepse nuk kishte gjera luksoze dhe teknologji te avancuara, pasi i tille ishte ambjenti i qytetit. Banoreve iu nevojiteshin vegla pune, ene balte, samare, gjyma, qe ishin gjerat me imediate per jeten e atehershme. Ne familjen tone nuk ka pasur nje varferi te theksuar. Ne benin nje jete tejet normale".

«Nga kujtimet e familjes ruaj nje kujtim te periudhes se luftes, pasi nuk i mbaj mend mire dhe ne qytet, pra ne Elbasan nuk ka patur shume trazira. Kujtoj vetem zhurmat e avionave dhe krismat e pushkeve. Gjithashtu kujtoj oshetimat e bombave, te cilat me rrengjethnin mishin».

«Ndersa nga periudha e monarkise kam nje kujtim te vecante. Jeta qe behej atehere ishte nje jete qe Shqiperia s'do ta kete mundesine t'a perjetoje. Cdo gje ishte e lire ne treg. Kishte me shume liri ne menyren e te konceptuarit te jetes. Madje ne kete periudhe ndodhi dhe nje gje shume e madhe qe e coi drejt civilizimit popullin shqiptar. Ishte heqja e ferexheve gje qe e kishim trasheguar nga myslimanizmi dhe ne te njejten kohe e kishte izoluar figuren e gruas ne marredheniet social - kulturore - politike. Me pak fjale kete periudhe mund te pershkruaje si kohe e arte».

**JETA NA THERRET VETEM ATEHERE KUR JEMI TE RRITUR**

«Vjen nje dite dhe te gjithe e kuptojme qe dicka ka ndryshuar brenda nesh. Krijohet nje sensacion i vecante dhe gjerat nuk mund t'i shohim dot si me pare dhe pak nga pak ne e kuptojme se jemi

rritur. Keshtu dhe une nuk e ndjeva veten me femije qe ne momentin kur mbarova shkollen 8 - vjecare.

Lashe menjane te gjitha capkenlleqet e femijerise. Nuk do te isha me ai femija lozonjar dhe per me teper do te me mungonin lojrat qe ne zhvillonim ne ate kohe si psh «loja kala « qe eshte me 3 - 4 veta qe ulin kurrizin rresht pas njeri - tjetrit dhe te tjeret qe hidhen duke kaluar me radhe (loje tipike shqiptare). Gjithashtu do te me mungonte loja e futbollit, ku une isha e shkathet dhe beja gola. Djemte e lagjes me donin si moter dhe me zgjidhnin ne skuader. Kujtoj se nuk do te vidhnim me mushmolla te kopshti i komshijes. Une beja gjithmone roje dhe ruaja shoket e mi kur hynin te vidhnin se mos vinte njeri. Ata mbushnin trikot me mushmolla dhe kur do kalonin tek shtegu une ua rrezoja dhe i mblidhja per vete».

«Tani une nuk do te beja me gjera te tilla sepse isha rritur dhe isha futur ne gjimnaz. Per nje vajze te kesaj moshe, keto gjera nuk jane serioze. Une duhet te merrja pergjegjesite e mia dhe te studjoja per te zgjedhur nje profesion ne jete, i cili do te jete ajo i ekonomistes, ne moshen 18 - vjec. Eshte nje moshe teper e re per te mbajtur gjithe kete pergjegjesi, pasi une punoja ne komitet. Nuk ishte nevoja per para qe te punoja kaq heret, por deshira per te eur perpara. Sigurisht qe edhe parate hynin ne pune se i vinin ne ndihme mua dhe familjes sime por ajo qe ishte paresore ishte deshira per te ecur perpara».

Me pas une vajta te punoja si ekonomiste ne Ministrine e Kultures duke zene nje pozicion te rendesishem. Nga ana e familjes per te vazhduar me tej nuk pata asnje pengese, pasi isha larg shtepise ne Tirane, madje ata me mbeshteten. Ne familjen time te gjithe e donin kulturen, arsimin, te bukuren prandaj nuk ndodhen asnjehere keqkuptime apo grindje ne zgjedhjen qe bene femijet ne jeten e tyre.

Jeta ime mori nje rrjedhe te ndryshme nga ajo qe kisha jetuar ne femijeri. Une u realizova ne profesionin tim dhe i perkisja asaj pjese te shoqerise qe ishte e privilegjuar ne Shqiperi. Kisha nje mireqenie jetese. Kam pasur gjithcka nga jeta, pervec femijeve. Kam jetuar si mbretereshe, kam pasur nje shtepi me 9 dhoma gje qe ishte rralle ne ate kohe. Kam pasur telefon, banje me vaske, gramafon, dritaret me grila, shtepine te mobiluar dhe te gjitha keto gjera qe permenda ishin





te rralla per kohen e Enver Hoxhes. E kujtoj me nostalgji se ishte nje shtepi plot komoditete, gje qe do ta kishin zili edhe sot. Kesaj jete luksoze per ate kohe nuk i munguan aktivitetet dhe shoqeria. Kisha shume shoqe, gra me emer ne shoqeri. Ato ishin mjeke te njohura dhe kishin pozicion social. Bashke me mikeshat e mia benim xhiro neper Tirane me makina, gje qe ishte shume e rralle sepse ne ate kohe 20 makinat e vogla taksi qe qarkullonin ne kryeqytet diheshin se ishin te ministrave apo te Partise. Nuk kishte makina private si sot. Ishte nje privilegj. Bashke me burrin tim, Aleko, beja xhiro me motorr. Madje ne qeme te paret qe bleme nje motorr "Vespa" dhe njiheshim ne Tirane.

Pushimet i kalonim ne hotel "Adriatik". Aty shkonin vetem turistet e huaj dhe njerezit e "elites " shqiptare. Benim plazh dhe me pas xhiro me bicikleta. Kam pasur nje biciklete te markes "bianchi sportiva italiani" te cilen ma vodhen nje dite kur e kisha lene te kycur para pallatit te kultures. Sic duket e kishin ngritur peshe dhe e kishin marre ngaqe ishte e bukur dhe e vecante. Por gjithe kjo jete komode dhe e vecante e ka nje shpjegim. Burrri im punonte shef ne administraten e fakultetit te Mjekesise. Ai gezonte nje personalitet dhe status te vecante. Ishte nga Bilishti i Korces. Ishte mjaft i pashem dhe mjaft kavalier. Dinte te sillej me femrat dhe i vleresonte ato.

Ne asnjehere nuk patem mosmarreveshje. Cdo gje e zgjidhnim me gjakftohtesi dhe tolerance. Edhe pse kishim nje diference moshore prej 10 - vjetesh ai nuk me la kurre te kuptoja se isha e vogel ne krahasim me te. Dashuria me bashkeshortin tim ka qene dashuri me shikim te pare. Jemi njohur nepermjet kunatit tim (burrit te motres). Sigurisht qe ne momentin e pare lindi simpatia per njeri - tjetrin. Duke u njohur pak nga pak sepse gjerat ishin ndryshe ne ate kohe, ne vendosem te martoheshim, dhe me pelqimin e familjeve tona. U martuam ne 1953, kur une isha 23 vjec dhe burri im 35 vjec. Ishte nje martese e mrekullueshme ku nuk munguan as dashuria dhe as parate. Burri im ka 20 - vjet qe ka vdekur nga azma dhe une e ndjeje shume mungesen e tij, pasi nuk kam femije. Kjo eshte nje nder arsyet qe une s'jam martuar serish, sepse bashkeshorti im ishte burri im ideal dhe ai kishte te gjitha gjerat qe nje burrre tjeter nuk mund t'i kishte. Kam mbetur shume e lidhur pas kujtimit te burrit".

Intervistuesi pyet:

**-C'kujtime ruani nga koha e mardhenieve shqiptaro - jugosllave gjate kohes se regjimit stalinist te Enver Hoxhes?**

- Po te pergjigjem shkurtimisht:

- "Enver Hoxha i preu marredheniet me te gjithe, sepse donte te ishte vete i pari dhe gjeti menyra nga me te ndryshme per t'u prishur dhe me ata pak miq qe kishim. Edhe pse une kam jetuar mire ne ate kohe kam perseri disa verejtje per sistemin. Nuk me pelqen te rikthehet ajo kohe, pasi ka pasur koncepte te ndrydhura si per rinine, ashtu dhe per njerezit e thjeshte. Mjafton te kujtojme festivalin e 11 ku te gjithe kengetaret e rinj qe kishin floke te gjate dhe shfaqen tendenca drejt muzikes moderne u burgosen. Pra njerezit nuk ishin te lire ne te gjykuar dhe ne te vepruar. Kjo liri u kushtezua dhe ne aspektin religjoz. Te gjitha kultet fetare u prishen si kisha dhe xhamia. E gjithe kjo per arsyen e vetme se ato mund te sherbenin si burim informacioni ne lidhje me boten e jashtme dhe Enver Hoxha nuk donte qe asnjeri te kishte lidhje me kapitalizmin. Madje une si mbese e gjysherve prifterinj ruaj shume kujtime. Ne momentin kur gjithcka u kthye ne TABU ne perjetuam nje dhembje te madhe. Megjithate nuk u dorezuam. Te gjitha ikonat dhe shenjtoret e tjere i fshehem ne bodrum dhe ndiznim qirinj fshehurazi per te mos na diktuar te tjeret, sepse po te ndodhte dicka e tille ne do te quheshim armiq te popullit dhe do te persekutoheshim. Per kete arsye ndodhi dhe dicka me daten e lindjes time. Une kam lindur me 23 prill 1929, dite pashke, por u rregjistrova 6 muaj me vonese, ne nentor. Ditlindja ime natyrale nuk mund te festohej hapur sepse perkonte me dite pashke dhe mund te keq interpretohej per regjimin, kurse sot une i festoj te dyja. Ate qe perkon me diten e pashkes e festoj njeherazi me festen e fese sime, kurse ate te nentorit ma festojne njerezit e aferm bashke me mua".

## E SOTMJA ESHTE PER TE JETUAR DHE PER TE VLERESUAR JETEN

Aktualisht une jam nje e moshuar dhe kam nje paraqitje te mire fizike. Kam nje shendet per t'u pasur zili. Nuk me ka mposhtur pleqeria. E gjitha kjo fale optimizmit qe kam per jeten. Edhe pse tani





jam e vetmuar pa femije,jam e arsyeshme cdo gje qe me ndodh e perballoj nuk demoralizohem,sepse keto jane gjera te jetes dhe nuk mund t'i shmangim dot. Mua me pelqen te jetoj derisa te jem mire fizikisht qe te kujdesem per veten dhe te mos jem nje peshe per te tjeret. Dua te jetoj me kembe e me duar dhe me pas le te vdes. Nuk kam frike nga vdekja sepse eshte dicka njerezore dhe na perket neve. Megjithate do te me vije keq per njerezit qe do te le pas si motrat, vellezerit, niperit e mbesat te cilet kujdesen shume per mua. Ne cdo moment me jane gjendur prane. Me marrin per fundjave ne shtepite e tyre. Kam nje nip qe ka nje hotel ne Llixha dhe aty kam dhomen time qe nipi ma ka lene ne dizpozicion per pushime".

«Koha e sotme per mua eshte nje epoke pasi edhe pse e paket ne vite (12 vjet) e ndryshoi jeten ne shume drejtime. Tani jemi te lire te bejme c'te duam, pa paragjykuar te tjeret. Cdo ndryshim e kemi pritur me kureshtje se cfare do te ndodhe. Te gjitha dukurite si ato pozitive dhe ato negative jane pjese e ketij realiteti. Sa per politiken dua te them vetem dicka pa u perhapur shume. Te gjithe pushtetaret e sotem duhet t'ia lene vendin te rinjve,per te cilet ka me shume nevoje ky vend per ta cuar perpara Shqiperine me perspektivat e nje Europe perendimore.

| *Intervistoi* | *Nadire Sinani* |
|---|---|
| Emri i te intervistuarit: | **Nevruz Xhelali** |
| Vendlindja: | Lin te Pogradecit (15 shkurt 1927) |
| Emri i te atit: | Xhelal Xhelali |
| Profesini i te atit: | analfabet, ka punuar si bari |
| Emri i te emes: | Naxhie Xhelali |
| Profesioni i te emes: | analfabete, shtepiake |

## KESHTU KAM JETUAR

Ka nje moter te vertete, Mevluden, dhe dy motra (Sanie dhe Inxhie) dhe dy vellezer (Zenel dhe Seat) femije te mamase me xhaxhain.

Motrat dhe vellezerit kishin 5 klase shkolle. Vellai i madh beri shkollen e kufirit per 1 vit dhe u be nenoficer kufiri. Babai vdiq shume heret . Nevruzi nuk e ka njohur, por e ema i ka treguar se kane pasur marredhenie shume te mira. Persa i perket besimit ishin myslimane. Familja e tij ishte shume e varfer.

Kujtimi qe Nevruzi ka per fshatin e tij eshte se ishte shume i bukur, buze liqenit, me shtepi jo fort te vjetra sepse burrat e fshatit ishin muratore dhe i ndertonin vete. Ne fshat gjysma e njerezve ishin myslimane dhe pjesa tjeter katolike. Marredheniet midis dy feve ishin te mira por nuk lidhnin krushqi midis tyre.

## KUJTIMET E FEMIJERISE

### "FEMIJERIA IME, ESHTE NJE LULE QE MBIN MIDIS FERRAVE DHE KERKON TE SHOHE DIELLIN"

"Kam lindur ne nje familje te varfer. Familja ime perbehej nga nena, babai, gjyshi, gjyshja, nje moter me e vogel dhe dy xhaxhallare. Une nuk e kam njohur babane sepse ka vdekur shume i ri ne moshen 22 vjecare dhe une kam qene vetem dy vjec. .Une kisha njohur

xhaxhane si baba. Pra nena ime ishte martuar me pas me xhaxhane tim dhe pati me te kater femije: dy djem dhe dy vajza. E kujtoj me shume dhimbje ate moment kur kam marre vesh te verteten (i mbushen syte me lot). Isha 7 vjec, duke luajtur me femijet ne oborr pashe se ata kishin marre buke me vete e po e hanin dhe une vrapova ne shtepi per t'i kerkuar buke nenes. Kur hyra brenda pashe nenen qe kishte rene siper nje senduku dhe po qante, paloste ca rroba, i shikonte, i rregullonte e qante me denese".

"Perse qan? - e pyeta dhe iu hodha ne qafe".

"Pasi hezitoi pak, fshiu lotet e mu pergjigj: - Keto jane rrobat e babait tend. Ja kepucet, kemisha, corapet, te gjitha jane ketu...".

"Mbeta i shtangur ne vend dhe mezi arrita te belbezoja: - po pse une nuk e kam babain? - "Jo. Babai yt ka vdekur, ai qe ti njeh per baba eshte xhaxhai yt".

"Une fillova te qaja me te madhe, mora nje shami nga senduku qe e kishte mbajtur babai dhe e lidha rreth qafes. E mbajta gati 1 vit ashtu te lidhur pas qafe si shenje respekti ndaj babait".

- Si ka qene babai yt? - e pyeta.

"Per babane me ka treguar mamaja. Ajo ruante kujtimet me te mira per te. Ishte nje njeri i mire, punetor, i dashur. Ai e donte shume mamane sepse e kishte zgjedhur vete. Shtepia e saj ndodhej prane kasolles ku babai mbante bagetite. Keshtu babai e pa dhe e pelqeu, u fejuan dhe me pas u martuan. Por dashuria e tyre u thye shpejt se babai vdiq. Ai punoi per disa kohe si punetor ne Tirane dhe ne Beograd, mori nje ftohje te rende dhe u semur. Erdhi ne shtepi mjaft i semure - me ka thene nena. Diten qe erdhi makina e kishte lene ne rruge dhe kishte shkuar gjyshi per ta marre me kale sepse ai nuk ecte dot. Keshtu jetoi gati nje vit i semure derisa vdiq. Megjithe perpjekjet qe bene te afermit per ta sheruar nuk ia dolen dot. Ne Pogradec ne ate kohe kishte vetem nje mjek qe ishte shurdh dhe qe e therritnin doktor - shurdhi. Ai nuk kishte fare ilace vetem disa aspirina keshtu ishte e pamundur te sherohej babai. E kishin derguar ne Struge por ishte teper vone. Nena me ka treguar se kur do te vdiste me la amanet:

- Ki kujdes femijet, behu e forte.

Me pas nena u martua me vellane e babait. Ishte nje martese e





padeshiruar si nga nena ashtu dhe nga xhaxhai, i cili kishte qene i fejuar me nje vajze ne fshat. Kur u bera 9 vjec, e pyeta nje here nenen se perse ishte martuar me xhaxhane?

Ajo qau dhe me tha: - per ty bir, per ty i vura perde te zeze syve, u turperova. Po te martohesha me tjeter njeri nuk do t'mi pranonte femijet dhe ju do te rritesht pa mua ne shtepine e babes tuaj. Une doja te punoja e t'ju rrisja vete ne shtepine e burrit sipas amanetit te tij".

«Por edhe xhaxhai nuk e deshironte nje martese te tille. Ate e detyruan gjysherit sepse e pelqenin nusen qe kishin ne shtepi. Ishte e urte e punetore dhe donin ta mbanin nuse shtepie. Keshtu pas nje viti pranuan te martoheshin».

**Si kane qene marredheniet midis tyre?**

«Me sa mbaj mend une nuk kane pasur marredhenie te mira. Xhaxhai kishte 3 klase shkolle punonte ne ara ose bari. Nenen nuk e donte madje dhe e ka rrahur. Ishte shume i heshtur dhe indiferent ndaj problemeve. Shpesh gjyshi e kritikonte duke i thene:

- Pse rri ashtu si matuf, perse nuk flet?

Ai mbeti i turperuar ne fshat per veprimin qe beri duke marre per grua, nusen e vellait. Nena e respektonte por me shume e bente nga frika, ajo ishte e zgjuar dhe na donte shume".

**Si sillej xhaxhai me femijet?**

Mua dhe motren nuk na donte, ishte mjaft i ftohte dhe shpesh na fliste shume ashper. Nena i kundervihej gjithmone duke i thene:

- Mos i fol femijve se per ta kam sakrifikuar jeten time. Xhaxhai, femijet e tij i donte me shume, une fillova ta urrej".

**C'kujton nga gjysherit?**

"Gjyshi ishte zemermire. Na donte te gjitheve, nuk bente dallime. Me zemer na donte por nuk na perkedhelte kurre. Ishte nje njeri shume i forte s'qante kurre. Nena me kishte treguar se gjyshi nuk kishte qare as kur i kishin vdekurr 2 djemte. Pasi ne familjen tone kishte ndodhur nje tragjedi e verteete. Kur vdiq babai im mbas 6

ditesh vdiq djali tjeter i cili kishte shkuar te punonte ne Beograd. Ne shtepi erdhi lajmi qe vdiq por ne nuk e morem vesh kurre se si vdiq e ku e ka varrin. Ai ishte 18 vjec kur ka vdekur. Gjyshi me ka treguar se kishte qene 6 vjet ushtar ne Turqi ishte dalluar ne lufte per trimeri dhe e kishin graduar ombash. Gjyshin e mbaj mend qe punonte ne are me parmende e qe fjalen e tij e zbatonin te gjithe. E respektonim shume por dhe ai kujdesej per ne. Gjyshja ishte koprace. Mbaj mend qe edhe kokrra e kripes i dhimbsej. Ajo merrej me punet e shtepise, gatuante. Gjyshja na donte e na perkedhelte shpesh, na merrte ne preher e na peshperiste fjale te embla. Nje here me kujtohet dicka shume e trishtuar ne lidhje me gjyshen. Une e kisha vene koken ne preherin e saj e po dremisja. Ndjej qe po me lageshin faqet, hap syte e shoh ghyshen qe qante me denese. - Perse qan ti gjyshe? - i thashe - ajo me shtrengoi fort ne kraharor e me tha:

- Po kujtoj djemte qe si kam me.

Nuk ishte hera e pare kjo qe pashe gjyshen duke qare, gjersa vdiq ajo qante gjithmone per djemte e vdekur".

## NENA IME, PERSONI ME I DASHUR NE JETEN TIME

Si ishte nena c'kujton nga marredheniet me te?

"Nena ime ishte shume e mire. Ne fshatin tone grate punojne nga mengjesi deri ne mbremje. Nena ngrihej heret dhe shkonte te bente dru. Kishte nje sopate qe e quanin "sopata e nenes" e mbante gjithmone me vete. Nena punonte edhe ne are, mbillte, korrte, prashiste, ajo e mbante shtepine me gjyshin. Nena vinte ne mbremje ne shtepi me nje mall te madh per ne femijet. E mbaj mend kur vinte e veshur me rrobat e krahines, me fustan te gjate, te bardhe, me brez te kuq ne mes, me jelek ngjyre vishnje, me shami te kuqe. Dukej shume e bukur. Ne i dilnim me vrap perpara dhe kush ta takonte i pari ajo i jepte per te ngrene dicka qe nuk e kishte ngrene vet dhe e ruante ne brez per femijet. Nena ishte e zgjuar dhe e shkathet. Rridhte nga nje familje e mire. Kishte nje vella e nje moter. Babai i saj ishte njeri i nderuar ne fshat dhe ekonomikisht ishin mire. Kur nena ishte martuar me xhaxhain te afermit e miqesia ishin zemeruar, por ajo gjithcka e kishte bere per ne. Kishte nje te mete, deshperohej shume, nuk ishte optimiste".





**Si e shikon kete veprim te nenes?**

„Nuk e gjykoj te drejte megjithate une e kam dashur dhe e dua sepse ajo eshte nena ime dhe gjithka e ka bere per te miren tone".

**Po ti a do ta beje nje gje te tille per femijet e tu?**

"Jo, femijet duhen dashur por jo te cenoj nderin".

Si ishin marredheniet motra - vellezer?

"Kur ishim te vegjel grindeshim shume. Madje femijet qe nena kishte me xhaxhain nuk i donim fare. Kur filluam te rriteshim e kuptuam se ata nuk kishin faj dhe kujdeseshin per njeri - tjetrin. Filluam te ndjenim dashuri, dhembsuri gje qe u rrit me shume kur na vdiq nena. Nena vdiq ne prill te 1952 ne moshen 47 vjec. Une dhe motra ishim te martuar. Motra u martua ne Rrajce te Prrenjasit. Une ndodhesha ne Vlore si komisar divizioni dhe kisha dhe nje cupe te vogel. Para se vdiste, nena ishte tek une, ndenji 1 muaj. Gezohej qe une isha i martuar dhe me femije, qe kisha nje pune dhe nje jete te qete. Ne ate kohe nena mbante nje maraz te madh se vajza e madhe qe kishte me xhaxhain, Sania ishte rrembyer, kishte ikur nga shtepia me nje djale qe dashuronte, ai ishte oficer kufiri. Te gjithe e vuanim kete gje, nuk na erdhi mire kur e morem vesh sepse ne ate kohe kjo gje konsiderohej turp i madh. Keshtu ne shtepine e gjysherve kishin mbetur xhaxhai, 2 djemte e nje vajze".

"Djali i madh kur vdiq nena ishte 9 vjec pra Zeneli, djali i vogel ishte vetem 5 vjec, Seati, motra e mbetur ne shtepi ishte 12 vjec Inxhia. Keshtu kur vdiq nena barra e shtepise i ra motres 12 vjecare e cila duhej te kujdesej per te atin 39 vjecar e per dy vellezerit e vegjel. Xhaxhai dhe nena jetuan bashke 20 vjet nga 1932 deri me 1952. Me nenen pesova nje humbje te madhe por ishte koha kur marredheniet me motrat e vellezerit u forcuan me shume. Me dhimbseshin tek i shikoja te vegjel dhe jo ne gjendje te mire. Ne ate kohe vendosa te le gruan time atje ne fshat per tu sherbyer xhaxhait dhe femijve. Por xhaxhai nuk deshi sepse e shikonte si rendese nga ana ekonomike. I kam ndihmuar gjithmone me ushqime, veshje, para. Sa here kane pasur nevoje i kam ndihmuar. Te gjithe bene 5 klase shkolle. Zeneli beri edhe shkollen e kufirit per 1 vit dhe punoi si nenofiicer kufiri.

Me pas vazzhdoi edhe nje kurs per guzhinier.dhe u be shef kuzhine ne klubin e Koranit ne Lin ku vazhdn ta ushtroje dhe sot ate profesion".

"Djali i vogel u be kapter ushtrie. Ndersa motrat mbeten me 5 klase shkolle. Te gjithe femijet jane martuar me lajmesi pervec te madhes qe u rrembye. Nga koha e femijerise i vetmi gezim ishte kur shkonim te shtepia e gjysherve te nenes. Ata na donin shume sidomos gjyshja, na bente shume gjera te mira per te ngrene. Ajo ishte shume bujare dhe femijet e donin shume".

## SHKOLLA IME. NJE COPEZ DIELL PER TE CARE ERRESIREN

**Cfare kujtoni nga shkolla?**

- Shkollen e kam filluar me 1933, kur isha 6 vjec. Kisha nje deshire te madhe per te mesuar dhe kete nuk ma ka ushqyer asnjeri. Vete vendosa te mesoj, kisha nje etje te madhe per dije. Keshtu hyra ne shkolle. Ajo ishte nje godine e ndertuar nga burrat e fshatit. Ne klase kishim 5 vajza, 4 prej te cilave ishin te fese ortodokse. Ne ate kohe jo te gjithe femijet shkonin ne shkolle. Ishin te privilegjuar femijet qe shkonin sepse pjesa tjeter pengohej nga prinderit. Ata donin t'i mbanin ne shtepi femijet per te punuar, per te ruajtur bagetine. Une e ndieja veten me fat qe nuk me penguan per te shkuar ne shkolle. Fillova keshtu shkollen por ne kushte shume te veshtira. Ne shtepine time nuk kisha mundesine te mesoja sepse kishim vetem nje dhome. Aty hanim e flinim. Keshtu per te mesuar une gjeta nje vend ne fshat, ishte nje grope dhe une ngrihesha heret e shkoja atje per te mesuar. Ne shkolle kisha rezultate shume te mira. Me kujtohet nje here kur mesuesi pyeti tere klasen: - Kush ka luftuar me Romaket? - Nuk u pergjigj asnjeri une u ngrita dhe i thashe:

- Teuta e Ilirise.

Mesuesi me falenderoi. Mesuesit ishin mjaft te nderuar ne ate koohe, i respektonin te gjithe, por edhe ata ishin te edukuar, te sjellshem, na donin e punonin shume per te na mesuar. Mbaj mend se nje here mesuesi u nxeh se nuk kishim mesuar dhe na tha se nuk do te shkonim per dreke ne shtepi. Nderkohe nje nxenes u ngrit e iku





me vrap. Te nesermen kur mesuesi e pyeti: - perse ike ashtu - ai u pergjigj: -Kisha uri zoti mesues.

Ne ate kohe mesuesit i rrihnin nxenesit qe nuk mesonin e kishin te drejte. Mbaj mend qe dy nxenes nuk kishin mesuar nje dite dhe i sollen vete thuprat qe t'i rrihte mesuesi. Ate periudhe kam vuajtur shume. Ne dimer me hynte bora ne kembe se i kisha opingat te cara. Kur ktheheshim ne shtepi i fusnim kembet ne hi per t'i ngrohur. Nga shkolla kujtoj dhe mobilizimin per provimet, sidomos per provimet e klases se peste. Diten kur do te merrnim diplomen u mblodh i gjithe fshati, u mbajt nje konference. Kujtoj qe nje shoku im me tha ate dite: - Nevruz ku do tejesh si sot nje jave?

- Me bagetite u pergjigja e ne veten time dicka u thye.

Me erdhi keq qe mbaroi shkolla. Shkollen e mbarova me 1939, keshtu mbaj mend edhe pushtimin e Shqiperise nga Italia. Ate dite e mbaj mend shume mire. Ishim ne klase kur degjuam topat qe binin, disa femi filluan te qajne, disa bertitnin. Dolem me vrap nga shkolla ashtu te trembur u nisem drejt shtepise. Rruges takuam xha Sotirin ai ishte shume i deshperuar e na tha: - Eh more djem s'ka me Shqiperi. - Ishte 7 prill 1939. Ne Pogradec erdhen ushtaret italiane. Njerezit i kishin frike por ato nuk i trazonin. Mbaj mend nje here isha ne cezem. Fshati ishte prane rruges kryesore dhe aty erdhi nje ushtar italian. Grate nuk u afruan por qendronin larg. Atehere ai me tha: - perse nuk vijne ato, une nuk i ha. Vitet e shkolles i kujtoj me nostalgji, kisha dhe nje shok te ngushte Dhimitraq Zafiri quhej, e donim shume njeri – tjetrin. Pas shkolle shkonim me bagetite. Nga shkolla mbaj mend edhe dicka tjeter. Kisha mjaft simpati per nje vajze qe e kisha ne klase quhej Leka. Ajo ishte ne klasen e trete dhe une ne te pesten. Me pelqente shume por nuk munda t'i shpreh dashurine time, me vinte turp. Te dyve na kishin vdekur baballaret dhe une ndieja dhembshuri per te. I tregova nenes per kete vajze dhe ajo dergoi fjale ne shtepine e vajzes por iu pergjigjen qe e kane te fejuar. Kur u rrita e qortova veten pse nuk ia shpreha dashurine asaj vajze. Ndersa nje shoku Arseni u dashurua me Vasiliken ne shkolle, ata u martuan dhe jetojne sot ne Tirane. Keshtu shkolla mbaroi dhe

une ruaj kujtimet me te mira per shoket. Kam shkuar mire me te gjithe, isha i urte, i sjellshem e jo grindavec. Pas shkolle fillova te ruaj bagetine.

**Si ishte jeta atehere? C'ju kane treguar per monarkine?**

Per sa i perket kohes se monarkise gjyshi me ka treguar pak gjera por edhe une nuk mbaj mend se kam qene i vogel. Gjyshi me ka treguar se kishte punuar ne Rumani. Nga fshati kishin ikur edhe burra te tjere per te punuar. Keshtu nje here iken tre burra e nuk u kthyen me , mbeten grate me femijet ne shtepi. Xhaxhai i babait tim ka shkuar ne luften e pare boterore por nuk u kthye me, gjithashtu edhe nje xhaxha tjeter shkoi ne vend te djalit ne lufte e nuk u kthye. Kishte shume burra ne fshat qe shkonin e nuk ktheheshin kurre me nga kurbeti.

Fshati yne ne krahasim me fshatrat e tjere ishte me mire sepse burrat e fshatit ishin muratore e punonin shume. Ne fshat kishte nje kishe e nje xhami sepse fshati ishte i ndare ne myslimane e ne te krishtere. Aktivitetet kulturore te fshatit behashin ne kishe. Mbaj mend se kur lindi djali i Zogut u be nje feste e madhe me kenge e valle. Me kujtohet nje incident gjate asaj dite festimesh. Nje djale i vogel i gjuajti me gur nje daulleje e cila u ca. E ndoqen xhandaret per ta kapur por nuk e zune dot. Agallare nuk ka pasur ne fshatin tone. Ne kohen e mbretit Zog varferi kishte por kishte pak njerez neper shtepira e keshtu me pak bageti e toke ia dilje te jetoje disi.

Ilace nuk kishte. Njerezit vuanin nga kjo gje. Kishte rend dhe qetesi. Shkolla organizonte shfaqje ku merrte pjese i gjithe fshati. Aktivitetet i organizonin mesuesit. Mbaj mend mesuesin Qemal Kocilja bashke me te shoqen Fanin qe punonin shume me nxenesit. Ato kishin mbaruar shkollen "Normale" ne Elbasan e ishin mjaft te respektuar ne fshat. Martesa e tyre perbente nje rast te rralle sepse ishin njeri mysliman e gruaja kristiane. Ne ato kohe kjo ishte e rralle. Njezerit e feve te ndryshme respektonin njeri – tjetrin por nuk shkonin me tej se ky respekt reciprok per njeri – tjetrin.

Nga ajo periudhe dita me e bukur per mua ishte dita e Veres. Ishte nje feste qe e festonte i gjithe fshati me 14 Mars. Nje dite me pas





shkonim per te mbledhur lule te gjithe femijet vraponim neper lendina. Lulet qe mblidhnim i hidhte nena ne uje e ne mengjesin e dites se Veres na bente banje me ujin e luleve, qe te beheshim te bukur e te shendetshem si lulet. Na lidhte verorka ne duar per te pasur nje vere sa me te lumtur e me shendet. Verorkat beheshin me nje fije te bardhe e nje te kuqe. Ne mengjesin e dites se Veres ndiznim zjarre luanim me njeri – tjetrin, shkonim ne cdo shtepi e na jepnin kulace qe i kishin bere zonjat e shtepise.

Ne ate kohe dasmat beheshin shume te bukura. Dasma fillonte disa dite me pare, vinin komshinjte dhe grumbullonin dru per te gatuar diten e dasmes, blenin ushqimet, kendonin cdo mbremje, i kendonin djalit, nuses. Te enjten merrnin nusen. Mbaj mend qe nje dite ne fshat jane bere 6 dasma. Fshati oshetinte nga fyejte e nga gajdet.

**C'kujton nga marredheniet e dasmes?**

Nusja vinte me kale e duvak te kuq. Duvaku ishte nje cope e kuqe qe e mbulonin koken e nuses por copa ishte e holle me qellim qe nusja te shikonte e te mos e shikonin te tjeret. Babai i djalit ose daja shkonte krushk i pare, shkonin 7 – 9 ose 11 kuaj per te marre nusen, gjithmone numer tek. Krushku i pare kur shkonte ne shtepine e nuses jepte parate per parukieren qe e kishte zbukuruar nusen (quheshin parate e kollajxhiut). Nusja kishte nje kale me senduqe per pajen. Ajo qendronte e parafundit ne kolonen e krushqeve, ndersa ne fund qendronte krushku i pare qe te kujdesej per nusen. Me kujtohet kur kam derguar motren time Mevlude, nuse. E kemi cuar me kale, dajoja e mbante nga krahu i djathte, nje kusheriri yne mbante kalin dhe e terhiqte perpara. Kur mberritem ne shtepine e burrit, nena e djalit mori ne duar nje cun te vogel dhe ia vuri nuses ne preher me qellim qe te linde djale. Nga kali e zbrite daja dhe tek dera i kishin vene nje gjym, nusja e goditi me kembe e derdhi dhe hyri ne shtepi me kemben e djadhte. E derguan ne dhomen e grave dhe atje i hoqen duvakun qe ta shikonin njerezit. Filluan te kendojne grate e te hedhin valle. Te nesermen kur do te iknin ne qe shoqeronim nusen, hyme ne dhomen e miqve dhe aty erdhi nusja per te na nderuar. Qendronte ne kembe

pa levizur. Ne vitet e mevonshme zakonet ndryshuan. Nusja vinte e i puthte doren miqve, apo u bente kafen e mengjesit.

**RINIA IME NJE RINI E DJEGUR**

Kur mbarova shkollen e ndjeva veten te rritur. Ruaja 150 dele te fshatit e me jepnin 3 lek per dele. Keshtu fillova te kontribuoja ne ekonomine e shtepise. Marredheniet me xhaxhain nuk i kisha te mira. Ai me ngarkonte shume pune te renda. Keshtu une fillova te qendroja gjithnje e me larg shtepise, qendroja ne kasollen e bagetive. Ne ate kohe cdo shtepi kishte bageti qe varionin nga 7 bageti deri ne 100 bageti per shtepi, varej nga gjendja ekonomike. Nuk kisha kohe te lire, pasi te gjthe punonin ne ara, ose shkonin me bageti.

**Si ishte pozicioni i gruas ne familje?**

Grate nuk respektoheshin, perdoreshin si sherbetore. Mbaj mend nenen time qe lodhej shume. Kur ishim te vegjel ne mbremje mblidheshim rreth vatres dhe kur vinte ora e darkes gjyshja i thoshte nenes: - Nuse ngreu merr legenin te lajne njerezit duart. Nena shtronte sofren, pasi uleshin te gjithe ulej dhe ajo. Me njeren doren hante me tjetren mbante kandilin, ose pishen e ndezur per te ndricuar. Me pas ngrinte sofren, fshinte, shtronte per te fjetur, mbulonte zjarrin me hi e pastaj flinte. Flinim te gjithe ne nje dhome sepse nje dhome kishim. Madje nena me ka treguar se kur u martua ka fjetur ne hanin e bagetive naten e pare te marteses. E me pas ka fjetur me te gjithe njerezit e tjere menje dhome. Per grate nuk kishte kohe te lire vetem pune.

Keshtu kaluan ditet e ne moshen 12 vjecare shkova dhe punova per 3 muaj ne Tirane si punetor ndertimi. Ishte koha e pushtimit italian. Ne pune kishim nje kryeinxhinier italian. Une sapo kisha mbaruar shkollen e isha i ndrojtur. Diten e pushtimit isha ne shkolle dhe e perjetova shume keq sic e kam pershkruar me lart. Kisha krijuar nje pershtypje te keqe per italianet. I urreja. Por kur punoja atje me italianet i shikoja si shoke. Ata silleshin mire, ishin njerez te dashur u beme shume miq sidomos me kryeinxhinierin. Keshtu vazhdova te ruaja delet ne fshat derisa dola partizan. Partizan kam dale ne





moshen 14 vjecare. Nderkohe italianet ishin te larguar e ne ishim pushtuar nga nazistet gjermane. Partizan kam dale ne 15 shkurt 1944.

**ATDHEDASHURIA E DESHIRA PER LIRI NA BURRERUAN PARA KOHE**

Me kujtohet se isha bari me delet, degjoja shpesh krismat e armeve, behej lufte ne malet aty prane. Me lindi deshira te shkoj ne lufte te luftoja edhe une per te shporrur pushtuesin qe na kishte zaptuar. Ne ate kohe ne fshat behej dhe shume propagande nga mesuesi i fshatit Jordan Bici. Ai e mblidhte fshatin e i fliste per luften, per partizanet, per ndihmen qe duhej tu jepnim atyre me veshje dhe ushqime. Une u influencova mjaft edhe nga kusheriri im nga Mokra, Kurti Dyrbaku, i cili ishte anetar i keshillit nacional – clirimtar. Ne ate kohe neper fshatra ishin krijuar keshillat nacional – clirimtare qe ndihmonin levizjen clirimtare. Keshilli siguronte ne fshat ushqime e veshembathje e ua dergonte partizaneve. Keshtu kur shkoja per vizite ne shtepine e kusheririt ai me fliste shpesh per luften dhe me jepte ndonje leter per ta cuar ne ndonje vend te caktuar. Pa dashur une isha bere pjese e kesaj levizje per clirim. Ne mendje kisha vetem nje mendim te dilja partizan. Keshtu tentova nje here te dilja partizan dhe ia lashe bagetine shokut tim te ngushte. U pershendeta me te dhe u nisa. Pasi kisha ikur une kishte ardhur nena per te me sjelle buke. Pasi nuk me pa aty kishte pyetur shokun tim se ku isha une. Ai i ishte pergjigjur se kisha ikur ne mal dhe se i kisha lene atij bagetite per t'i ruajtur. Nena ime kishte ndjekur rrugen nga ika une dhe kur doli maje kodres me pa se largu tek i ngjitesha malit. Me thirri e ma beri me dore te kthehesha. Qendrova per nje cast dhe vendosa te kthehem, e gjeta nenen te ulur ne toke e te mbytur nga lotet.

Kjo ishte hera e pare qe une u nisa per te dale partizan pasi heren e dyte e realizova kete deshire. Mbaj mend shume diten kur dola partizan. Isha ne mal me dele. Duke ndenjur nen nje peme ulur degjova disa te shtena qe me pas u pasuan nga gjemime topash. U ngrita menjehere ne kembe, po luftohej shume prane vendit ku isha une. Zemra me rrahu fort. Ishte nje rast mjaft i mire per te shkuar te

pertizanet, ata ishin afer. Ne ate moment shoh se po vinte drejt meje motra ime. Ishte nje rast i mire per te ikur. Ia lashe asaj delet dhe i thashe se do te kthehesha shpejt. Shkova ne shtepi dhe takova nenen, i thashe se e kisha vendosur te dilja partizan, ajo nuk foli por shtroi sofren, dhe me vuri perpara buke dhe veze te skuqura me gjalpe. Nisa te ha por ngaqe me dhimbsej nena me ngeci buka ne fyt, u ngrita nga sofra dhe perqafova nenen. E putha fort e i thashe te mos merzitej, se edhe une si shume shoke te tjere e urreja zaptuesin dhe do te luftoja perkrah tyre deri ne fund, se e ndieja veten me shume se kurre shqiptar e doja te luftoja per Shqiperine. Nena me puthi e me tha: - Udhe te mbare bir, u kthefsh me fitore. U nisa per te partizanet. Vendin e dija ku ndodheshin, ishin ne malin e Katjelit. Eca disa ore dhe rruges takova nje partizan, ai me tregoi me saktesi rrugen qe duhej te ndiqja. Kur u afrova prane vendit ku qendronin partizanet ato me pane e u alarmuan sepse une isha me pushke e kujtuan mos isha spiun. Pushken e kisha te shtepise e mbaja me vete per te ruajtur delet nga egersirat. Perpara me doli komandanti i cili me tha:

- Kush je ti ? C' kerkon ketu?

- Dua te dal partizan iu pergjigja, kerkoj te flas me komandant Pasho Kullolli.

Atehere ai me mori e me dergoi tek komandant Pasho, i cili me caktoi ne skuadren e pare me komandant Vait Selca. Pasho Kullolli ishte komandant kompanie e une e njihja me pare prandaj kerkova te flas me te. Pasi me caktuan skuadren po binte mbremja dhe me te hyre nata u dha urdher te niseshim per sulm.

- Si e perjetove kete moment, ishte hera e pare qe luftoje?

E mbaj mend si tani ate moment. Komandant Vaiti me tha nese kisha luftuar ndonjehere? – Jo iu pergjigja une.

- Epo mire sonte do te sulmojme ne Qafe Thane, ti do te qendrosh prane meje.

Filloi lufta mua me dukej sikur te gjithe plumbat binin siper meje. Qelloja me shume nga frika. Luftuam rreth 4 ore. Ne kete perpjekje u plagosen 2 partizane e u vra nje. Thoshin se partizanit qe u vra i ishin mbaruar fisheket e ai kishte filluar te gjuante me gur drejt gjermaneve. Me pas u inkuadrova partizan ne batalionin e Reshit Collakut te krahines

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



se Mokres. Beja pjese ne skuadren e pare te kompanise se pare te ketij batalioni. Me kujtohet fare mire kur me caktuan ndihmes mitralier. Ate dite kishim marre urdher per sulm, do te zinim pozicionet e armikut. Mitralier ishte Izet Dyrmishi, ndersa mua me caktuan ndihmesin e tij per trimeri qe kisha treguar ne beteje. Mitralozi im u vendos ne koder ndersa armiku ndodhej ne rrugen kryesore dhe e mbante te bllokuar ate. U dha shenja per sulm me thirrjen " Para partizan" dhe u degjuan me pas bresheri fishekesh, granatash, bombaj. Me kujtohet fare mire se nje djale i vogel rreth 15 vjec, qe ishte partizan i ri u hutua nga zhurma e madhe e filloi te qaje. U degjua zeri i komandantit tek i thoshte: - Ulu, ulu – dhe vajti e mori prane vetes. Sulmi vazhdoi per nje kohe te gjate, sulmonte nje skuader, pastaj tjetra e keshtu me rradhe deri ne dreke. Gjermanet nuk po dorezoheshin. Bataljoni kishte kater kompani, nderkohe kompanite e tjera me urdher te komandantit te bataljonit Zyko Kolivaci ishin terhequr. Kompania ime me komandant Pashon nuk u terhoq. Ai kembenguli te vazhdonin luften. Filloi perseri lufta, nderkohe vjen nje predhe prane kokes tek isha shtrire barkas. Me dhembet shtrenguar prita qe te plaste por ishte fati im i mire qe ajo nuk plasi pasi ra ne vend te bute. Me ne fund vjen nje urdher tjeter dhe kompania ime u terhoq. Komandantit iu terhoq verejtje qe nuk e kishte zbatuar urdhrnin e pare. Komandanti i kompanise Pasho Kullolli na lajmeroi per krijimin e Brigades XX sulmuese qe do te krijohej ne malet e Dushanit ne Opar te Korces e ne do te shkonim atje per tu bere pjestare te kesaj brigade qe do te krijohej. Udhetuam dy dite dhe dy nete dhe u mblodhem ne fshatin Protopape te Oparit. Atje ishte nje lendine e madhe me dy cezma dhe siper saj shtrihej nje pyll me dardha. Aty erdhen dhe bataljone te tjera me partizane, disa ishin partizane te rinj nga Korca te cilet dhane nje shfaqje per ne.

**Si e siguronit ushqimin?**

Ushqimin na e jepte populli. Ne cdo kompani caktohej nje furnitor. Ky partizan shkonte ne fshat dhe mblidhte ushqime. Takonte anetaret e keshillit nacional – clirimtar dhe ata ia siguronin buken e ushqimet. Pasi ndejtem disa dite atje me 9 shtator 1944 u formua Brigada e XX sulmuese.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

Ishte nje dite e bukur shtatori. Te gjithe u grumbulluam ne nje lendine dhe krijuam nje tribune me mjete rrethanore. Doli komandanti i Brigades se XX sulmuese dhe na foli: - Shoke partizan, Brigada u formua, do te shkojme ne lufte, kini kujdes armiku eshte i eger, i pabese, keshtu granatat, bombat e fisheket mos i coni dem por hidhini mbi trupat e tyre. Me pas komisari i Brigades XX, foli per rritjen e levizjes nacional – clirimtare. Tashme ishin formuar dhe po formoheshin divizione dhe brigada. Ai foli edhe per perparimet e ushtrise se kuqe sic quhej ndryshe ushtria ruse dhe per detyrat e partizaneve ne lufte. Fjala e tij zgjati rreth dy ore. Me pas shefi i shtabit lexoi urdhrin e marshimit dhe drejtimet e bataljoneve te brigades. Brigada e XX sulmuese kishte kater bataljone e rreth 1000 partizane. Une merrja pjese ne kompanine e dyte te bataljonit te katert te Brigades se XX sulmuese. Me te mbaruar ceremonia secilit batalioni iu caktua zona qe do te mbulonte. Batalionit tim u caktua ne rrethin e Pogradecit e te Prrenjasit. Diten e neserme morem urdher qe Brigada e XX sulmuese do te hidhet ne sulm ne zonen e Korces. Ishte shtator, bente shume vape. Ne bashkpunim me nje brigade tjeter i sulmuam gjermanet ne Cangoj. U ishim afruar shume gjermaneve por nuk po i zbrapsnim dot. Mbasdite sulmuam dhe nje here por perseri u thyem. Ishim te rraskapitur, pa uje, pa buke. Nderkohe duke ndenjur ne pozicione e pa shprese degjojme nje kenge qe thoshte:

Digjet bota punetore, bote e ngrate,
shpirt e zemer pikelluar, zorren e thate,
nje kasolle me kandil dike pret,
burrin malit ose djalin ate pret.

Kur e degjuam kete kenge morem force. Ajo na ngriti moralin lart, ishin shoket tane ata qe po kendonin. Nuk e harroj kurre ate moment kur pasi mbaroi kenga u degjua thirrja e komandantit "para partizane". Filloi nje lufte e papare, sulmi yne i ngjante nje rrebeshi te furishem, per pak kohe kishim hyre ne mes te gjermaneve. Ata u ndane ne pjese dhe keshtu u thyen. Ne kete beteje te ashper u vrane dy partizane nga batalioni tjeter. Pra kur mendonim se e kishim





humbur betejen ishte kenga ajo qe na dha force e na mposhti lodhjen e urine. Pas kesaj beteje vajtem ne fshatin Bollovade per te pushuar. Atje qendruam dy dite, lame edhe rrobat ne lumin e fshatit, grate qepnin, kishim 3 shoqe ne skuader. Mua me caktuan komandante skuadre per guximin e treguar ne sulmin ndaj gjermaneve. Nga keto dite pushimi kam nje kujtim te paharruar me nje nga shoqet e skuadres. Si tani e kujtoj, ndersa qendronim ulur per te pushuar, Pavlina me dergon nje leter ku me shprehte ndjenjat e saj. Ne partizanet kishim rregulla te forta, persa i perket marredhenieve me njeri – tjetrin. Keshtu nuk lejohej te kishe te dashur por ne qofte se te pelqente ndonje vajze duhej ta deklaroje tek komandanti e te shpallje fejesen me te. Nuk lejoheshin gjerat ilegale sepse demtohej morali i luftes. Pasi mora letren e lexova dhe shkova tek Pavlina e i thashe:

- C'eshte kjo leter shoqja Pavlina?
- Une shpreha ate qe ndieja – mu pergjigj ajo.

E kritikova veprimin e saj duke i thene se ne kishim dale per te luftuar e jo per tu fejuar. Shkaku i nje pergjigje te tille ishte jo vetem sepse une isha pak fanatik nga natyra por sepse une isha i fejuar me nje vajze ne fshat qe ne moshen 11 vjecare. Te nesermen kur u mblodh skuadra Pavlina erdhi ne rrjesht pa kapele.

- Ku e ke kapelen – i thashe.
- Ma mori komisari – mu pergjigj.
- Shko e merre e pastaj rreshtohu ne rrjesht me shoket – i thashe.

Ajo shkoi e mori e erdhi. Me pas u fejua me komisarin sepse dhe ai e dashuronte. Komisari me pyeti se si sillej, si luftonte dhe une i thashe fjalet me te mira.

**Si u ndjeve kur sjo u fejua me komisarin?**

Me thene te drejten nuk me erdhi mire, edhe mua me pelqente, ishte e zgjuar dhe e bukur.

Si trajtoheshin grate partizane, a respektoheshin ato?

Vajzat partizane respektohehin shume. Midis vajzave dhe djemve partizane kishte marredhenie shume te mira qe bazoheshin ne respektin reciprok. Mbaj mend qe erdhi nje urdher nga shtabi i pergjithshem qe per shoqet partizane te tregohet mjaft kujdes, te

fejohen me partizane dhe fejesat duheshin deklaruar e jo te beheshin fshehur. Me kujtohet nje ngjarje shume tronditese qe beri buje ne ate kohe. Ne nje batalion tjeter nje partizane nga Gjirokastra dashurohet me nje partizan nga Vlora. Ishte nje dashuri e fshehte por i diktuan dhe lajmeruan shtabin e pergjithshem. Nderkohe komandanti i brigades bashke me zevendesin e tij organizuan nje mbledhje te te gjithe brigades. E therriten partizanen para brigades. Ajo ishte shume e bukur dhe rrobat ushtarake me gjerdanin e fishekeve i kishin hije. I thane se kishte shkelur ligjin e luftes, ajo ishte dhe anetare e komitetit qendror te rinise. Ajo e mori persiper fajin dhe keshtu e pushkutuan para gjithe brigades. Nderkohe qe ajo u pushkatua korrieri po vinte me nje leter nga shtabi i pergjithshem ku atje thuhej qe ajo te mos pushkatohej, por te transferohej prane ketij shtabi. Por tashme ishte shume vone. Kjo ngjarje i tronditi te gjithe, por lufta kishte ligje te cilat duheshin zbatuar. Komandantit per kete veprim te nxituar iu terhoq verejtje. Me pas partizani qe ishte i dashuruar me partizanen e vrare duke mos e perballuar humbjen e te dashures, ne nje sulm me armikun u hodh ne bresherine e plumbave e u vra.

**A ishte i eger pushtuesi gjerman?**

Gjermanet kane bere shume menxyra ne popull. Keshtu mbaj mend qe ne shtator te vitit 1944 batalioni yne kaloi ne zonen e Gores. Aty kishte ardhur nje ekspedite gjermane dhe bente plackitje neper fshatra. Duke kaluar ne fshatin Desmir pame se kishin vrare 2 djem dhe gjetem nenen e tyre duke i qare. U ndalem dhe u futem ne pozicione luftimi, pasi partizanet e Gores po luftonin me gjermanet ne u erdhem ne ndihme. Gjate sulmit me beri pershtypje nje fshatar qe po leronte token. Nga kodra ku isha vendosur une shihja shume mire se c'behej. Gjermane ia vrane qete fshatarit, ai rrembeu sopaten e u fut ne grope te mbuluar me gure. pas pak minutash atje vete nje gjerman e vendos mitralozin sepse nuk e kishte pare fshatarin e fshehur ne grope. Kur gjermani filloi te gjuante me mitraloz, fshatari del dhe e vret me sopate. Ia mori mitralozin gjermanit dhe qe atehere u be mitralier ne skuadren tone gjersa u vra. Me vone me urdher te komandes se batalionit shkeputemi nje toge e shkojme te ruajme





kufirin ne fshatin Lubanisht qe te mos i lejonim gjermanet te vinin nga Ohri. Qendruam gati nje muaj dhe u ndeshem 2 here me gjermanet dhe balliste bullgare. Keshtu nuk i lame te futeshin ne Pogradec. Me pas toga jone u bashkua me batalionin ne Qafe – Thane dhe zume kufirin shqiptaro – maqedonas ne fshatin Remes afer Struges. Ate nate per here te pare shkova ne shtepi. Pas nje sulmi komandanti me tha: " sot shko ne shtepi, shko ti perpara, lajmero keshillin se ne oren 10 do te vijme edhe ne". U gezova dhe e falenderova. Shkova takova nenen. Nuk kam per ta harruar kurre. Ajo me perqafoi e s'ngopej duke me pare. Duke biseduar me nenen po me mbylleshin syte por vjen korrieri e me therret. Nenes i mbeti merak qe nuk fjeta pak. U pershendeta me nenen e u largova. Te nesermen komandanti me dergoi per te cuar nje leter ne batalionin qe ndodhej ne Remes. U nisa bashke me nje shok e nje bashkefshatar. Tek ecnim rruges pame gjermanet. Ata po ecnin gjate rruges ne u fshehem ne nje are me miser e pritem sa u larguan. Shkuam ne fshatin Remes dhe ia dorezuam letren komandantit i cili sapo lexoi letren dha urdher per sulm. Keshtu filloi lufta ne ndihme kishim edhe partizanet maqedonas. U vendos qe do te sulmonim ne dhe maqedonasit do te na mbronin krahet. Komandanti zgjodhi disa partizan trima qe sulmuan me granata e bomba ne fillim. Lufta qe e ashper, gjermanet po thyheshin mirepo maqedonasit e kishin braktisur frontin ishin terhequr, dhe gjermanet na dolen nga prapa kraheve, vrane komandantin e mitralozit te rende. Keshtu e humbem betejen e u terhoqem ne pyll. Tek qendronim ashtu te shtrire per te pushuar degjojme rojen qe thote se po vinte ne civil. Ishte ne djale 15 – 16 vjec, i ishin mbushur opingat me gjak. Ishte nje pamje mjaft rrengjethese. Ai tha se ne fshatin maqedonas Ladorisht gjermanet kishin pushkatuar 90 burra e djem nga fshati. Ai kishte qene midis tyre por ngaqe ishte i vogel i kishin rene trupat e te tjereve siper e keshtu kishte mbetur gjalle por ishte i plagosur. Te nesermen e asaj dite pasi u terhoqem gjate gjithe nates ne token shqiptare sulmuam gjermanet ne Prrenjas. Ne kete perpjekje u vra nje shoqe partizane e u plagos nje fshatar nga Mokra i cili ishte miku im. Mbasdite u vendosem ne fshat. Mua me caktuan roje me mitraloz ne nje varreze

pasi atje dukej e gjithe zona perreth se ishte koder. Duke ndenjur shoh se po vinte drejt meje nje djale me dhen. Mua mu kujtua koha kur isha bari, kisha shume nostalgji per delet, e keshtu duke pare djalin e duke kujtuar ate kohe isha humbur ne mendime dhe nuk i pashe gjermanet qe po vinin drejt nesh ne formacione luftimi. Nga keto mendime me shkundi zeri i djalit qe me therret: " gjermanet, gjermanet". Me ti pare ata hapa zjarr. Partizanet ishin ne fshat s'dija c'te beja. Ne kete moment shoh komandantin e toges qe ma beri me kapele per t'u terhequr, une hyra ne fshat dhe gjermanet sulmuan me ashper. Predhat binin shtepite, u futa ne nje shtepi dhe pashe se po piqej buka. Zonja e kishte lene ne zjarr e kishte ikur. Kudo shihej njerez qe iknin me vrap, braktisnin shtepite dhe shkonin drejt nje gryke mali. Ata vraponin e therritnin: "partizane mos na lini ne dore te gjermaneve". Atehere komandanti urdheroi qe asnje partizan te mos levizte, te qendronim ne llogore. Populli u terhoq ne pyll, ne pritem gjermanet. Na zuri nata duke luftuar. Aty vjen nje djale i vogel dhe thote se disa gjermane jane futur ne nje shtepi dhe po terrizojne njerezit. Komandanti caktoi 5 partizane per te vajtur ne ate shtepi. Gjermanet atje kishin rrahur dhe perdhunuar nusen e cila ishte vetem me femijet pasi burrin e kishte partizan. Partizanet i vrane gjermanet te cilet kishin terrorizuar dhe dhunuar femijet. Gjermanet u thyen e u terhoqen. Ne fund te shtatorit shkuam ne Qukes, aty do te kalonte divizioni i gjermaneve dhe ne duhej ta asgjesonim. Ne i pame tek po vinin me dy motorcikleta dhe tre makina me materiale. Komandanti na tha se kush donte te dilte vullnetar per t'i asgjesuar ata. Dolen disa vullnetare nder ta dola dhe une. Ne nuk mund te shkonim te gjithe atje sepse kjo ishte pararoja e armikut, divizioni gjerman vinte mbrapa me autokolona. Zbritem poshte nga kodra e zume nje kthese, u rame motocikletave. Por kur po u afroheshin makinat une tentova te hipi ne njeren prej tyre, nje plumb me kapi ne kapele, une u ktheva mbrapsht dhe u hodha granada. Gjermanet u vrane, makinat u dogjen. Morem materialet dhe u terhoqem.

Nderkohe ishte bere nate. Njeri nga shoket ishte plagosur. Ai me tha te shkoja perpara dhe ai do te rrinte ne mes te ferrave dhe kur te vinim ta merrnim ai do te na bente shenje, pasi gjermanet po





vazhdonin te sulmonin. Ne vajtem tek partizanet e tjere dhe i thame komandantit per shokun, vajtem tre veta per ta marre naten, por nuk po e gjenim dot, pasi e kerkuam shume e gjetem. I kishte dale shume gjak dhe e cuam ne spital. Me pas na lajmeruan qe buze Shkumbinit ne Qukes po vinte nje batalion gjerman. Duhej te mos i lejonim. Koha ishte e keqe, binte shi. I rrethuam gjermanet dhe i kerkuam te dorezoheshin. Gjermanet thoshin se ka dhene urdher Hitleri qe ai qe dorezohet do t'i pushkatohen njerezit ne familje, keshtu me mire vritemi vete, sesa te me vriten njerezit. Gjermanet kishin nje kapterr austriak ne batalion i cili ishte veteriner dhe merrej me mushkat. Une e pashe ne nje ferre kujtova se kishte vdekur i hodha nje gur ai ngriti koken e me tha: "gud patizan austriako". E morem dhe e dorezuam ne komande. E mbajtem, ai na perkthente gjermanishten. Duke luftuar me gjermanet ne Qukes na zuri nata. Gjermanet kishin zakon qe ne mengjes sulmonin dhe naten terhiqeshin ne grupe. Me caktuan patrulle me nje shok. Ndersa po ecja pak perpara, kthehem e nuk e shoh shokun. Kur kthehem shoh qe ai kacafytej me nje roje gjermane te ne patrulle. U afrova dhe gjermani ngaqe ishte i madh e kishte ngritur peshe shokun tim dhe ngado qe e drejtoja une pushken ai kthente shokun. Me ne fund e vrava dhe u kthyem tek shoket. Te nesermen kur u hodhem per te asgjesuar te fundit qe kishin mbetur, ata qe na shikonin mbyteshin ne lum e nuk dorezoheshin. Erdhi urdhri te kontrollonim vendin per te mbledhur materiale, pushke, automobile, revole. Gjetem nje oficer gjerman te vrare i cili kishte nje unaze te bukur por s'ia hoqa dot. Nuk kishim frike nga te vdekurit, nuk kisha frike kur vrisja sepse kisha urrejtjen dhe nese nuk i vrisja do te me vrisnin. Te vdekurit i mblidhnim dhe i groposnim ose i hidhnim ne lum qe te mos hapej ndonje epidemi. Me kujtohet qe gjate luftimeve ne Librazhd gjetem nje partizan pa koke. Nje nga ne tha: "e njoh une". I zbuloi kraharorin dhe nen sqetull i gjeti dy krahe te vegjel, i kishte si shenje dhe ishte nga fshati i tij. Lumin e Rrapunit e kaluam duke u kapur per dore, por na u mbyt nje shoqe sepse u shkeput. Ishte nentor, pasi kaluam lumin u hodhem ne Elbasan. Rame ne perpjekje ne Xibrake dhe me 11 nentor u clirua Elbasani.

Keshtu erdhi clirimi. Nga Krasta e Elbasanit udhetuam kater dite e kater nete per ne Korce, pasi greket kerkonin Korcen dhe Gjirokastren dhe vajtem ne kufi. Ne kufi u ndeshem me bandat balliste shqiptare qe iknin nga Shqiperia. Ne nje perpjekje me nje bande me jane vrare 14 shoke midis tyre komandanti i batalionit, komisari, komandanti i toges dhe nje shoku im.

Komanda me ngarkoi t'i mblidhja trupat dhe une i mblodha dhe i sistemova rreze nje kodre. Ishte maj. Me ka mbetur merak se kur u be pervjetori i te vrareve, familjaret kerkonin varret e ne nuk i dinim sepse i mori kapteri. Me pas ne nentor te 1947 shkova ne Garden e Republikes, pastaj shkova ne shkollen e oficerave ne 1 prill te 1949. Per nje vit u bera komisar. Me caktuan komisar kompanie ne divizionin e V ne Gjirokaster.

**" NJERIU ESHTE NJE PRODUKT I AMBIENTIT NE TE CILIN JETON DHE LODER E FATIT "**

Pasi u clirua Shqiperia me 29 nentor 1944, mua me ka bere pershtypje entuziasmi i popullit dhe dashuria qe kishte ai per Enver Hoxha. Populli e adhuronte ate, sepse fitoren ia dedikonte atij. Si sot me kujtohet ankthi me te cilen populli priste zgjedhjen e kryetarit te shtetit. Me 2 dhjetor 1945 u bene zgjedhjet per Asamblene Kushtetuese. Pra populli duhej te votonte ose pro frontit ose kunder tij pro per legalitetin, ballistet. Me kujtohet se ishin vendosur ne sallen e zgjedhjeve 2 kuti: nje e zeze, nje e kuqe. E kuqja perfaqesonte frontin popullor, e zeza ballin. Njerezit votonin me kokrra prej gome. Fitoi fronti popullor u zgjodh Asambleja Kushtetueseqe kishte atributet qe ka sot kuvendi popullor. Me pas Asambleja zgjodhi kryetarin e shtetit. Si sot e mbaj mend ankthin me te cilin populli priste zgjedhjen e kryetarit. Diskutohej per Omer Nishanin dhe Enver Hoxhen. Te gjithe deshironin te fitonte Enveri dhe kur u mor vesh lajmi ishte ishte nje entuziasem i vertete.

**Si ishte Enveri?**

Njeri shume i larte. Kam sherbyer per 2 vjet ne shtepine e tij si roje dhe kam pershtypjet me te mira. Nje here kujtoj qe ndersa une po beja sherbimin e radhes ai me ofroi disa gurabie per te ngrene

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



pasi kishte dale jashte ne kopesht e po pinte cajin me biskota. Me fliste shpesh sikur ishim shok prej vitesh me dukej. Kur vdiq Enveri pati nje pikellim te madh. Ne momentet e vdekjes ai e ka kerkuar Ramiz Aline e i ka thene: "te kesh kujdes popullin". Enver Hoxha ka qene atdhetar dhe njeri i dashur.

**Cfare kujton nga vitet e para pas clirimit?**

Pasi u clirua Shqiperia me 29 nentor 1944 une u caktova ne kufi. Pikerisht ne kete periudhe ndodhi dicka e rendesishme qe ndryshoi jeten time. Ishte gusht i vitit 1946. Ne kufi me vjen lajmi se e fejuara ime kishte vajtur ne shtepine time. Nuk e prisja nje gje te tille. Nuk e di a jua kam treguar historine e fejeses time? Nese jo po ua tregoj. Kjo ndodhi shume vite me pare, kur une isha vetem 10 vjec. Nje dite nena ime shkon ne krua per te mbushur uje dhe takon atje nje grua tjeter nga fshati e cila kishte nje vajze qe quhej Lavdie dhe ishte 7 vjece. Duke biseduar te dyja grate, nena ime i thote:

**- A do te ma japesh vajzen tende nuse per djalin?**

Kaq mjaftoi dhe gjyshi me xhaxhain shkuan ne shtepine e vajzes e lidhen fjalen e i dhane babait te vajzes 14 napolona flori e 50 kg grure.(qesh). Ne ate kohe moj bije nusja blihej, kishte nje cmim. Keshtu u fejuam por nuk ndenjem asnjehere bashke. Lavdia sa here me shikonte mua largohej. Ne ate kohe nuk lejohej qe te fejuarit te takoheshin apo te rrinin bashke para se te martoheshin. Shkaku qe ajo shkoi ne shtepine time ishte se daja i saj kerkoi ta fejonte ne nje vend tjeter, pasi fejesa jone ishte zgjatur shume dhe ai me kete arsye donte te fitonte para te tjera. Vajza e merr vesh planin e dajes dhe iken nje nate nga shtepia e saj e shkon ne shtepine time. Keshtu me te marre vesh lajmin shkova ne shtepi atje beme nje darke te vogel e u martuam. Me pas ne nentor te 1947 shkova ne Garde te Republikes e nga garda vazhdova shkollen e oficereve per nje vit me 1949 dhe u bera komisar.

**Si ishte gruaja jote, a ishte ajo qe kishe enderruar?**

Gruaja ime ishte e urte, e heshtur por nuk kishte formimin qe une doja. Une do te doja nje grua me te zgjuar e me te denje per mua. (rri i menduar).

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

Perse mendohesh ke ndonje gje per te treguar? Heziton pak, qesh pastaj ze e rrefen. Ishte koha kur isha ne shkolle ne Tirane studioja per oficer dhe u njoha me nje vajze Dhora quhej ishte nga Korca. Ajo ishte e zgjuar, e shkathet, e simpatike. Me pelqente shume por dhe ajo kishte simpati per mua. Ishte nje moment i veshtire sepse per here te pare kisha nje nje dileme te madhe ne vetvete, te qendroja me gruan apo te ndahesha prej saj e te lidhesha me Dhoren. Une isha ne nje moshe madhore tashme rreth 22 vjec dhe dija te vleresoja nje grua. Dhora me pershtatej shume, ishte ne nivelin qe une kerkoja une ndersa nusja qe kisha ne shtepi ishte e zgjedhur nga nena. Por nuk bera asgje, fati deshi qe une te qendroja me te.

**- A e ke pyetur nenen ndonjehere per kete fejese?**

Po dhe me ka thene se tille ishte koha atehere dhe se nuk e dinte se une do te te behesha komisar.

**NE KOHEN E DIKTATURES JETA IME ISHTE E QETE**

Ne periudhen e regjimit te Enver Hoxhes kam jetuar shume mire. Kam rritur 4 femije i shkollova e i martova. Ekonomikisht isha mire. Ne ate rregjim njerezit jetonin te qete, ishin te varfer por te qete. Kishin shtepi, pune...

**Cilet ishin aleatet e regjimit te Enver Hoxhes?**

Miqte tane ishin Jugosllavia me Titon, Bashkimi Sovjetik dhe kinezet. Por dhe ata e tradhetuan. Kujtoj prishjen me Titon. Ai kerkonte ta bente Shqiperine republiken e shtate. Tito u shpall armik. E keshtu erdhi me radhe prishja ne Bashkimin Sovjetik e me Kinen.

**Si e keni perjetuar kete mbyllje me boten?**

Izolimin e kuptonim si nje bllokade qe na benin revizonistet. Ne ate kohe mbaj mend qe behej kudo propagande kunder bllokadave revizioniste. Parrulla ishte: "Bar do te hajme por doren s'do t'ia shtrijme armikut" apo slogani "te mbeshtemi ne forcat tona". Edhe une me oficeret e tjere ishim pjese e kesaj propagande ne ushtri e ne popull.





**Si e keni perjetuar mbylljen fetare?**

Ne ate periudhe ekzistonte parrulla: " Feja opium per popullin" keshtu u hap nje fushate per prishjen e kishave e te xhamive. Ne fillim te moshuarve u vinte keq per kete qe po ndodhte. Mbaj mend ne Durres, rinia e Durresit kerkonte nje vend per te organizuar festat rinore. Rita Marko sekretare e pare e rrethit te Durresit konsultohet per kete problem me Enver Hoxhen dhe pergjigja e tij ishte: "Te behet sic do rinia". Kishat dhe xhamiat kishin luajtur nje rol negativ edhe gjate luftes, ishin bere depo armesh per ballistet. Ndersa drejtuesit e tyre ishin agjente si psh. Dervishi i Teqes.

**A e pelqeje ate rregjim?**

E pelqeja shume dhe do te doja te vinte prape. Ne ate periudhe jeta ime me lejonte qe te levizja nga nje qytet ne tjetrin bashke me familjen. Keshtu per 8 vjet une qendrova ne Gjirokaster, 7 vjet ne Korce, 3 vjet ne Sazan, 3 vjet ne Vithkuq, 2 vjet ne Pogradec me pas ne Cerrik e ne fund ne Elbasan.

**A ishte e kenaqur familja jote me kete jete?**

Po ishte nuk kundershtonin pastaj edhe ata e kuptonin se kjo ishte nje detyre e jo se vendosja une. Atehere motoja ishte: "ku ka nevoje Atdheu".

**Si ishte e organizuar jeta e ushtarakut atehere?**

Punonim mjaft, benim agjitacion e propagande shikonim kushtet ku jetonin ushtaret, i mesonim gjate kohes se lire dhe ia kalonim shume mire. Shkonim ne kinema, teater, organizonim mbremje ne shtepine e oficerave gjithmone me vete merrja familjen. Me kujtohet nje ngjarje ne nje nga keto mbremjet qe organizonim. Ishim mbledhur te gjithe dhe po vallezonim. Drejt meje vjen gruaja e nje oficeri tjeter e me fton per te vallezuar. Gruaja ime pasi u ngrita une te vallezoja u be xheloze e filloi te qaje. Mbase e ndiente veten mjaft inferiore dhe behej shpesh xheloze per mua. Por ate qe nuk pelqeja ne ate rregjim ishte se fshati kishte shume diferenze ne pune.

**Si ishin marredheniet me femijet?**

Kam shkuar mire megjithese me quanin fanatik. Une u kerkoja rregull e disipline, te ishin te sjellshem kudo.

Nderhyje ne veshjen e tyre, ne krehjen e flokeve?

Sigurisht, kerkoja nje paraqitje sipas normave te kohes. Megjithese i kerkoja keto, kam qene i komunikueshem me femijet, kam pasur relacione te mira. Me donin i doja.

**A ke nderhyre ne zgjedhjen e bashkeshorteve te femijve?**

Sigurisht, dhe mendoj se kam bere mire sepse djemte jane te kenaqur me nuset e tyre.

**Nuk mendon se ke bere gabimin e nenes tende?**

Qesh dhe thote. Jam i kenaqur qe djemte ia kalojne mire me nuset e tyre dhe kjo ka rendesi. Vajzat qe kam i kam te mira me shikojne here pas here dhe ato ia kalojne mire me familjet e tyre.

**PLEQERIA TE NDRYSHON JETEN POR DUHET PERBALLUAR**

Ne vitin 1994 më vdiq gruaja. E ndjeva humbjen e saj sepse mu prish shtepia. Ajo e mbante te lidhur familjen. Keshtu me humbjen e saj pesova nje tronditje por e perballova si dicka qe nje dite do te ndodhte.

**A ke frike nga vdekja?**

Jo, ajo eshte pjese e jetes. Jam i qete ne kete pike dhe gjate gjithe jetes me kane karakterizuar sigurite, urtesia.

Si i perjetove ndryshimet qe u bene ne vendin tone?

Me thene te drejten nuk me pelqejne keto ndryshime, nuk i shijoj, ndoshta per shkak te moshes. Kane ndryshuar shume gjera, politika, komunikimi mes njerezve, me pare kishin nje ideologji, ndersa tani njerezit zihen per partite, zihet vellai me vellane, shoku me shokun. Ka ndryshuar veshja, menyra e jeteses.

**Keni femije qe kane emigruar?**

Kam dy djem emigrante. Djali i madh eshte emigrant ne Greqi

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



ndersa i vogli ndodhet ne Itali. Ne fillim iken djemte pastaj moren grate, femijet. Une nuk doja qe ata te iknin, por ata u tronditen nga ndryshimet qe ndodhen, pasi ishin pranuar ne Parti, ishin komuniste, keshtu qe vendosen te iknin. Tashme jane integruar ne jeten qe bejne atje, jane te kenaqur e nuk duan te kthehen.

**Si e kalon kohen?**

Jetoj vetem. Merzitem shume ne shtepi sidomos kur shikoj bashkemoshataret e mi me niper dhe mbesa neper duar. Por me hapjen e Qendres Sociale Balashe me eshte zbutur merzitja dhe monotonia e jetes. Vij me deshire ne Qender, kam miq, ju kam juve qe jeni shume te mire me ne. Mbasdite dal me miqte dhe shoket e mi.

**Cilat jane projektet tuaja per te ardhmen?**

Dua te shkoj tek djali i vogel ne Itali. Shpresoj te me realizohet kjo deshire te jetoj me niperit dhe mbesat e mia...

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

| *Intervistoi* | *Aurora Malesija* |
|---|---|
| Emri i te intervistuarit: | **Nikolla Trojanov** |
| Vendlindja: | Liqenas te Pogradecit me 1927 |
| Emri i te atit: | Kerstin Trojanov |
| Profesioni i te atit: | Ka lindur me 1911 dhe ka vdekur me 1961 ne Liqenas ( Pustec ). Ka kryer vetem 2 vjet shkolle pasi i tille ishte sistemi arsimor per arsye te izolimit nga pala greke. |
| Emri i te emes: | Fanie Trojanov |
| Profesioni i te emes: | Ka vdekur ne moshen 78 – vjecare. Edhe kjo ka lindur ne Liqenas. Eshte e paarsimuar, pasi i kane vdekur prinderit dhe e kane lene shume te vogel. Ishte vajze e vetme. Pa motra dhe vellezer. |

## ATDHEUN DHE GJUHEN NUK DUHET TI HARROJME

### NE FEMIJERI MESOVA SE NJE BURRE NUK DUHET TE DOREZOHET PERPARA VESHTIRESIVE

Babai im sipas dokumentave eshte martuar qe ne moshen 17 – vjeçare me nenen time Fanie. Martesa e tyre nuk ishte martese me dashuri, por me mbleseri. Te dy te rinjte i kishin shtepite afer dhe shkak per kete lidhje u be i ati i nenes sime, domethene gjyshi im. I vetmi qe nuk ishte pro kesaj martese ishte babai i babait tim. Ai nuk donte qe kjo lidhje te behej e mundur por me ne fund ai pranoi me bindjen e te tjereve. Nje tjeter shkak qe e bindi me teper ishte feja ortodokse qe kishin te dyja familjet. Keshtu me ne fund nena ime u martua me babain tim. Babai im vjen nga nje familje e varfer dhe kishte vetem nje moter (hallen time). Ai ka kryer vetem 2- vjet shkolle, pasi fshati jone ishte i izoluar nga pala greke dhe nuk kishte shume mundesi per te vazhduar me tej.

Babai im ka jetuar ne shtepine e nenes sime e cila ishte vajze e vetme. Nuk ka pasur shtepi me vete qe te quhej e tija. Gjyshi im ( babai i nenes) ka qene njeri teper i zoti. Ai ishte marangoz, suvaxhi, thurte rrjeta peshkimi. Ishte tip i palodhur. Te gjitha keto profesione ai i kishte pervetesuar nga nevoja per para. Punonte shume dhe na mbante ne me ato qe fitonte. Kur vdiq ai, per ne qe nje goditje e rende. Keqardhja per humbjen e tij ishte e dyfishte: si njeri, ashtu edhe per gjendjen ekonomike ne te cilen na ndihmonte. Ai vdiq nga pleqeria. U paralizua dhe me pas nuk mundi te shpetonte nga semundja. Une e kam dashur shume dhe e ndjeja mungesen se tepermi. Ai ishte njeri per tu pasur zili. Ka qene punetor i madh nuk ndiente lodhje kurre dhe gjeja e pare qe binte ne sy ne karakterin e tij ishte optimizmi i pashtershem. Dua te tregoj nje rast kur na ngordhi nje ka. Gjedhet ishin pjese kryesore e pasurise per ate kohe dhe ishte diçka tragjike sepse me ane te tyre siguroje buken e gojes dhe ne te njejten kohe ato kushtonin shume shtrenjte ndaj nuk kishe mundesi t'i blije. Ne te gjithe u trishtuam, vetem gjyshi nuk na la te merziteshim. Ai na tha: "Do te blejme nje tjeter. Do te marrim para borxh dhe do ta zevendesojme". Me te vertete qe ashtu beri. Nuk u demoralizua. Mori para borxh dhe bleu nje tjeter.

Gjyshi im kishte nje organizem te shendetshem. Punonte tej mase, madje shtepine dhe plevicen e kishte ndertuar vete. "Me punen ai ishte lidhur qe i vogel" – thote Nikolla – sepse qe ne moshen 15 vjeçare ai ka emigruar ne Turqi. Atje ka punuar marangoz, murator dhe ka bere pune ne bujqesi. Ai ishte tip qe nuk i trembej punes. Gjyshi im vajti ne Turqi, por jo per te jetuar gjate. Ai punonte, mblidhte parate dhe kthehej ne shtepi. Pastaj emigronte serish. Lodheshin jashte mase, por ne fund te fundit ishte paraja qe ato merrnin e cila kompesonte lodhjen. Organizimi i emigrimit ishte ne grup. Beheshin nje grup i madh burrash dhe te rinjsh dhe e merrnin rrugen ne kembe. Shumica ishin beqar, sepse kishin me teper mundesi per te qene te pavarur. Me pak fjale dhe gjyshi im ishte nje nder ta qe do te sakrifikonte rinine e tij, pasi ne ishim shume te varfer, kishim pak toka. Kishte raste qe nuk kishim çfare te hanim. Ushqimet qe gatuheshin me teper ishin fasulet, gjelle me oriz, byreku, ndersa per mishin as qe nuk





behej fjale. Ate e gatuanim shume rralle. Ishim te varfer dhe nuk behej fjale per ushqime te tjera. Kjo varferi ishte edhe paksa e trasheguar sepse stergjyshi im u martua 2 here. Gruaja e dyte solli nje djale me vete dhe ishte nje grua qeflie e cila rendte pas parase dhe nuk pyeste per gjerat e rendesishme. Donte te hante, te pinte, te vishej dhe te bente qejf. Ajo harxhonte aq shume sa stergjyshi im u detyrua te shiste shtepine dhe tokat. Megjithate gjyshi im ishte njeri punetor dhe i zoti dhe arriti pak a shume ta ndreqte ekonomine. Ai punonte dhe na blinte gjera per te cilat gezoheshim se tepermi.

Na mbante shume afer. Na perkedhelte dhe ne flinim bashke me te. Une e doja shume dhe ai me donte pak me teper se niperit e tjere, ngaqe isha djali i madh. Na tregonte histori, perralla te ndryshme. Mbaj mend kur gjyshi na tregonte ndonje ndodhi nga lufta e pare boterore. Gjyshi tregonte se ne fshat u vendosen bullgaret dhe francezet. Ne nje koder ndodhej posta franceze dhe ne kodren perballe ajo bullgare. Bullgaret ishin shume mizore. Ka pasur raste kur ata ishin futur neper shtepi dhe kishin marre buken e te varferve, ndersa francezet ishin njerez shume te mire. Çdo gje e kishin ose ua jepnin fshatareve. Kishte gjera me bollek, madje ato pinin vere ne vend te ujit. Nga gjyshi mbaj mend vetem nje fjale. Ai na thoshte gjithmone: "Vendin dhe gjuhen nuk duhet ta harrojme. Po te jete e nevojshme duhet te japesh dhe jeten". Keto jane gjera qe gjyshi na e perseriste shpeshhere. Nga ky njeri kaq i mire edhe nena ime mori nje pjese te karakterit te tij. Ajo ishte punetore dhe e palodhur. Nga ana intelektuale ajo qendronte me lart se babai. Ka patur raste kur te dy prinderit e mi ziheshin ne syte tane. Per keto grindje une ia vija fajin nenes, por me kalimin e kohes, kur u rrita kuptova se ajo kishte pasur te drejte. Mbaj mend qe njehere kur disa nga burrat e fshatit vajten te punonin ne Elbasan, shkoi dhe babai im. Te gjithe sollen para dhe kuaj me vete, kurse im ate nuk solli asgje. Nena filloi te bertiste dhe une aty e kuptova qe babai im nuk ishte i pafajshem.

Fillova te mendoja se si nena ime ishte shume e larte dhe fisnike. Megjithate une nuk e shoh si armik tim ate pasi edhe ai ishte njeri shume i mire. Ai ishte teper punetor. Punonte si murator dhe ne bujqesi. Gjithashtu edhe ai na ka mesuar shume gjera per jeten si per

shembull: te punosh, te kursesh, te mos vjedhesh. "Duke pasur keto parime, vetem keshtu mund te besh nje jete te rregullt dhe pa probleme" – na thoshte babai gjithmone. Ai punonte shume dhe koha qe kalonim me te ishte e paket, por megjithate e gjente kohen per te na perkedhelur e per te na qendruar prane. Kishte raste kur ai tregohej shume i ashper. Me kujtohet si tani nje moment kur isha 12 vjeç dhe kisha vajtur per te prere dru. Isha i vogel dhe nuk dija t'i lidhja litaret e druve ne samarin e gomarit. U nisa per ne shtepi duke qare. Kur u futa brenda i tregova babait se ç'me kishte ndodhur. Ai me bertitit shume aq sa une u tremba. Kjo ishte nje qortim mjaft i rendesishem sepse me ato fjale te ashpra ai me tha: "Duhet te behesh kurajoz. Te behesh zot i vetes. Duhet te jesh i forte dhe mos ndalesh para asnje veshtiresie. Sot ndodhi kjo, por neser do te ndodhe diçka me e rende. Çfare do te besh ti do te qash?!". Aty une e kuptova qe me te vertete njeriu nuk duhet te jepet perpara veshtiresive. Me beri shume pershtypje ai qortim dhe u ndjeva fajtor.

## EDHE PSE ISHIM INTELIGJENT, ISHTE VARFERIA AJO QE NA MPOSHTE

Per fshatin tim ku kam lindur dhe jetuar kam se çfare te tregoj. Eshte nje peizazh shume i bukur. Fshati im ndodhet buze liqenit. Njerezit qe jetojne aty jane njerez shume te mire. Secili shikon punen e tij dhe nuk i bie ne qafe njeriu. Jane njerez zemerbardhe dhe e ndihmojne njeri – tjetrin kur kane nevoje. Pjesa me e madhe ka qene e pashkolluar per arsye ekonomiko – politike. Megjithese pjesa me e madhe nuk ka shkolle nje gje me ben pershtypje – thote Nikolla. Shumica e fshatareve ishin inteligjent nga vete natyra. Mund te tregoj nje rast ku ne nje gelqerore ishte brigadieri dhe i punesuari i cili peshonte gelqeren. Kur vajta njehere te merrja gelqere brigadieri nxorri lapsin per te bere llogarine se sa kushtonte, kurse vartesi qe nuk kishte shkolle e beri llogarine me pare se ai qe kishte arsimin e duhur. Keshtu qe si njerez ne ishim ne ishim inteligjent, por ishte varferia ajo e cila na mposhte.

Shtepia ku linda une ishte shume e vogel. Ajo ka pasur te njejten çati me haurin e kafsheve. Une kujtoja se ky model shtepie egzistonte

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



vetem ne fshatin tim, por kur u rrita dhe dola nga fshatrat e Korçes vura re se si ishte po ky model shtepie. Ne shtepine ku u rrita nuk kishte asgje, asnje mobilje. Ne ane te murit qendronte magja, e cila eshte si govate prej druri qe sherbente per te bere buken. Gjithashtu prane magjes qendronin hambaret te cilet imbushnim me grure dhe miser. Poshte ne dysheme nuk kishim shtruar qilim, por rrogoz i cili eshte tipik per shtepite e te varferve. Kishte raste qe mbeteshim pa buke dhe nena detyrohej te merrte miell hua te komshinjte. Vetedm 4 – 5 familje ishin ato qe siguronin miell per gjithe vitin dhe keto ishin me te pasurit. Me kujtohet qe pasaniket ishin te pashpirt. Ata nuk kishin meshire per ne. I shfrytezonin te varferit ne maksimum dhe kishte raste qe nuk u jepnin parate atyre qe iu punonin tokat. Ishte me te vertete nje torture çnjerezore.

Kur isha i vogel me pelqente te luaja. Lojrat qe frekuentonim ishin lojra te thjeshta dhe praktike. Kujtoj lojen e futbollit qe luanim me top prej lecke, kujtoj lojen me cingla e cila ishte nje loje me shkopa. Shkopin duhej ta hidhje shume lart dhe shoku duhet ta merrte pa mbaruar numerimi. Gjithmone ne do te luanim kur i mbaronim detyrat e shtepise. Gjithashtu une e ndihmoja nenen ne punet e shtepise, pasi isha djali i madh dhe i dilja krah asaj. Punet qe i beja ishin te thjeshta, por ishin nje ndihme e madhe per te. Une i laja enet, i mbushja uje, i fshija shtepine, mbyllja bagetine, vadisja zarzavatet te cilat na mbulonin nevojat vetem per stinen. Nje pjese tjeter te ketyre perimeve i benim turshi, te cilat na sherbenin si rezerva per dimer.

Ç' do gje mundoheshim t'a benim ne kushte shtepie madje edhe rrobat, pjesen me te madhe te tyre, nena na i endte ne vegel. Kjo ishte nje tradite e trasheguar per shkak te varferise. Ishte nevoja ajo qe e kishte mesuar mamane time te na bente veshjet e dimrit. Ishin raste te rralla ato kur blinim rroba ne pazarin e Korçes sepse nuk kishim para te mjaftueshme. Keto rroba i vishnim vetem per dite Pashke. Mbaj mend – thote Nikolla – qe kur blinim rrobat ose kur na i priste nena i kishim me nje mase me vallain e dyte i cili ishte pas meje. I vishnim rrobat njeheresh, por vellai i griste me shpejt se une dhe nena i thoshte gjithmone: "Merr shembull nga Nikolla qe eshte i

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

kujdesshem dhe nuk griset". Me vellain e dyte, Dhimitrin kam pasur marredhenie shume te mira. I tregoja gjithçka sepse kishim pothuajse nje moshe. Madje arrija deri aty sa beja dhe rolin e babait, pasi e shihja qe ishte shume e veshtire te harxhoje kot me kot per te ngrene dhe per tu veshur. Une iu beja propagande sepse e jetoja ekonomine e shtepise. Iu thoja te kursenin ne çdo drejtim sepse ishim shume femije. Ata me degjonin fjalen. Kjo vinte si rrjedhoje e autoritetit tim, por edhe si pasoje e fjales sime qe me dilte gjithmone. Une iu thoja qe per shembull qe kjo gje nuk duhet bere keshtu dhe me te vertete ashtu ndodhte siç thoja une. Ata mi degjonin keshillat.

Me kujtohet nje here kur Athinaja, motra ime, nuk e kreu porosine qe i thashe domethene te lante pjatat. U acarova jashte mase pasi ajo u tregua pak rebele, madje dhe e kam goditur. E godita sepse ne rradhe te pare ajo duhet t'a bente ate pune pa i thene njeri, me deshire dhe e dyta duhet t'a ndihmonte patjeter nenen. Kete veprim ajo e kishte bere disa here dhe kur e godita ajo nuk ma ktheu fjalen sepse e dinte qe ishte fajtore. Edhe pse isha djale kisha deshire qe gjerat e shtepise te ishin ne rregull dhe mbi te gjitha doja qe ato pak gjera qe kishim te ishin te pastra. Kur shkoja ne shkolle une arrija te beja dhe ndonje pune shtepie krahas mesimeve. Kam 8 – vjet shkolle, sepse partia nuk donte njerez te paarsimuar. E kam bere shkollen e nates kur isha ne pune si oficer. Shkolla qe kam bere kur kam qene femije ka qene 4 – vjeçare. Nuk kam qene nxenes shembullor. Kam pasur prirje ne histori, por nuk mesoja sepse isha dembel dhe s'kemi patur kushte mbi te gjitha. Pikesepari ne nuk kishim drita. I beja detyrat me kandil gje qe ishte e stermundimshme. Lapsat dhe fletoret i siguronim me veshtiresi pasi ato ishin te shtrenjta per xhepin. Une nuk kam qene nxenes i mire pasi nuk kisha dhe deshire te shkoja ne shkolle.

Kam pasur nje shok te ngushte te cilin e quanin Jorgji Tenko. I perkisnim te njejtit nivel ekonomik, madje ai ishte me i varfer se une sepse nuk kishte toka dhe jetonin vetem me krah pune. Megjithate ai ishte nxenes i mire dhe i urte. Mesonte me shume ne krahasim me mua dhe me ndihmonte sa here. Kujtoj diçka nga vitet e shkolles ne lidhje me Jorgjin. Ate e plagosi me thike djali i nje te pasuri dhe per

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



te nuk u mor asnje mase. Ishte nje grindje banale dhe askush nuk i doli krah Jorgjit per t'a perkrahur, perveç shokeve te ngushte.

Mesuesit e asaj kohe kane qene si prinder per ne. Ata kujdeseshin per ne si per femijet e tyre. Nje gjest bujarie ka treguar mesuesi im i fillores kur me vuri si kujdestar te klases dhe nxenesit me jepnin ndonje lek kur mblidhnim ato pak te ardhura per ndihme ndaj te varferve. Mesuesi e dinte qe ne shtepi ishin shume femije dhe me kete menyre vendosi te me ndihmonte. Ne klase kishim marredhenie te mira me njeri – tjetrin. E ndihmonim shoku – shokun sa here kishim nevoje per shembull kur na mbaronte boja e penes na e jepte shoku ose i jepnim ne kuti. Ne ishim te lidhur me njeri – tjetrin sepse pjesa me e madhe ishte e varfer dhe ia dinim problemet njeri tjetrit. Kushtet e shkolles ku mesonim ishin teper te veshtira. Shkolla kishte vetem 2 dhoma. Njera dhome sherbente si klase, kurse ne tjetren flinte mesuesi. Nje mesues mbulonte 4 klasa njeheresh. Klasat nuk ishin gje tjeter veçse 4 rreshta me karrige qe perfaqesonin secili nje klase. Mesimi zhvillohej brenda nje dhome. Kur mesuesi iu jepte te shkruanin diçka nxenesve te klases se pare apo te dyte, ai vinte te ne dhe na spjegonte mesimin. Keto ishin kushte te paperballueshme, por ne te njejten kohe ne kishim kushte te veshtira edhe ne shtepi. Kjo gje nuk na lejonte qe ne t'i perkushtoheshim tamam shkolles. Materiali mesimor i klases trete – katert ishte teper i ngarkuar, ndersa sistemi shkollor funksionone edhe paradite, edhe mbasdite. Te shtunen kishim mesim vetem paradite. Aktivitetet shkollore ishin te pakta.

Nuk kishim asnje lloj argetimi. Mbaj mend vetem pemet qe kemi mbjelle ne oborrin e kishes te organizuar nga ana e shkolles. Kjo veprimtari ka qene me karakter mesimor, per te mesuar se si mbillet nje peme. Per sa u perket aktiviteteve qe zhvilloheshin ne ate kohe mund te permend vetem festat fetare te cilat i festonim me muzike e valle ne mes te fshatit. Festa me preferuar ka qene ajo e Pashkeve, e cila zgjaste 3 – dite rresht dhe kercenim pa u lodhur duke thene qe te vazhdonte 1 jave. Vallet i luanim veç e veç. Djemte kishin vallen e tyre, vajzat veç, grate veç. Nje gje qe binte ne sy per kete dite ishin rrobat e reja dhe ushqimet qe ishin me bollek. "Na duhej te kursenim dite me pare per te mbledhur ushqimet e kesaj dite" – thote Nikolla.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

Nje feste tjeter fetareka qene dhe "Dita e ujit te bekuar". Kjo per ne ishte nje feste speciale. Ishim 10 familje qe shkonim shume me njeri – tjetrin. Per çdo vit e benim me rradhe organizimin e kesaj feste per shembull kete vit e kishte familja ime rradhen. Na duhej te ftonim 9 familje te tjera. Vitin tjeter e kishte nje familje tjeter qe na ftonte. Ishte nje gje shume e bukur, sepse beheshim gjithe ato veta dhe festonim gjithe naten duke kenduar. Ama duhet te them qe dhe harxhimet ishin shume te medha. Ishin pothuajse ushqimet e nje viti. Piqnim mish, benim embelsira, kishte vere dhe raki me bollek. Keto gjera ne nuk i kishim ne jeten e perditshme. Per kete feste kishte nje fare detyrimi. Duhej te plotesoje te gjithe deshirat e te ftuarve. Duhej t'u jepje per te ngrene çdo gje qe te kerkonin.

Ne periudhen e mbretit Zog njerezit vuanin shume ekonomisht. E gjitha kjo vinte ngaqe kishte shume pak njerez te pasur dhe shumica ishin te varfer. Paraja sigurohej me shume me veshtiresi dhe per kete arsye njerezit mundoheshin qe per çdo gje t'a benin ne kushte shtepie. Me kujtohet kur nena bente "petka" ne vend te makaronave (petka jane petet e thara qe zihen me veze dhe gatuhen si makaronat) apo rrobat qe na endte vete ajo ne vegel. Keshtu paraja per ate kohe ishte me pakice. Çmimet ishin te lira, por rrogat qe merreshin ishin shume te ulta dhe nuk mbuloheshin te gjitha nevojat. "Kishte nje krize te madhe ekonomike per ate kohe" – thote Nikolla – " asgje nuk mund te blije ne treg me ato rroga qesharake". Ka pasur raste kur njerezit e varfer qe nuk kishin krahe pune kane humbur shtepite dhe tokat e tyre pasi per te blere ushqimet nuk i jepnin parate ne dore por shenonin emrin ne fletore deri sa t'i gjenin ato. Kishte raste qe parate nuk mblidheshin per te shlyer borxhin dhe atehere ketyre njerezve iu konfiskoheshin tokat apo shtepite. "Ka qene nje periudhe vuajtjesh regjimi i Zogut" – thote Nikolla. Kur u arratis Zogu une kam qene 12 vjeç. Mbaj mend qe nje pjese e njerezve u shqetesuan domethene ata qe kishin pasuri kishin frike se mos u prekeshin interesat, kurse pjesa tjeter qe kishte vuajtur e priten me gezim sepse shpresonin te diçka e re qe mund te sherbente per mire ne te ardhmen. Dhe me te vertete qe gjithçka filloi te ndryshonte. Me te ardhur Italia gjerat filluan te levizin. Ne fshatin tone u hap pune, sepse burrat shkuan te punonin





ne portin e Durresit per te zbarkuar anijet qe sillnin mallra. Ata fitonin para dhe gjendja ekonomike sa vinte e permiresohej ne fshat. Madje ne zonen tone Durresin filluan ta quajne "Amerike" sepse kishte mjaft te ardhura. "Me ardhjen e Italise gjerat ndryshuan per mire ne disa zona te Shqiperise" – thote Nikollla. Ne fshatin tone pushtimi italian nuk u ndie shume, sepse ishim dhe si pozicion gjeografik i tille per te mos u sulmuar. Ishim zone e qete. Mbaj mend qe ne fshatin tone u vendos vetem nje poste kufitare italiane. Ushtaret italiane ishin njerez shume te mire, punetor, te qeshur madje ata punesuan shokun tim Jorgjin ( i cili ishte shume i varfer) qe tu mbushte uje dhe per ndonje sherbim tjeter. E paguanin dhe i jepnin per te ngrene e per te pire. Ne fillim ne nuk e dinim gjuhen, por filluam te merreshim vesh me shenja derisa mesuam te komunikonim me fjale. Ushtaret na tregonin per familjet e tyre, njerezit qe kishin lene ne Itali, madje njeri prej ketyre kishte 2 vjet qe nuk kishte shkuar ne shtepi dhe ndjente nje mall te jashtezakonshem. Ne i degjonim dhe ndienim keqardhje per ta. Gjithashtu te ata njerez na bente pershtypje dashuria per punen. Me kutjohet qe para postes rruga ishte shume e keqe me gropa. Ushtaret e rregulluan dhe e mbollen rreth e rrotull me lule. Ndihej nje ndryshim i madh ku vinin dore italianet. "Ikja e tyre shkaktoi nje keqardhje tek ne femijet qe ishim miqesuar me ta – thote Nikolla – sepse nuk do te na jepnin me buke dhe s'do te ishim me afer". Me gjermanet ishte diçka krejt ndryshe – thote Nikolla duke ndryshuar tonin e zerit dhe fytytra i merr nje pamje me serioze. Une isha 16 vjeç kur gjermanet shkelen ne token shqiptare. Kur ata u vendosen ne fshatin tone ne e ndjeme menjehere ndryshimin. Ata ishin njerez te ftohte, te serte, te rrepte ndryshe nga italianet. Ne nuk kishim me guximin per te vajtur nga reparti e te kerkonim buke siç benim me pare. Gjermanet ishin njerez fjalepak dhe nuk afroheshin. Nuk kishin zemer. Ata vrisnin dhe digjnin shtepite ne qofte se merrnin vesh se kishe lidhje me partizanet. Ishin shume te vendosur dhe nuk e llogaritnin vdekjen. I qellonin njerezit sikur te ishin shenjestra. Dua te them diçka qe me kujtohet nga femijeria ne lidhje me gjermanet si tipa – thote Nikolla duke buzeqeshur. Kur punoja si yzmeqar, ne shtepine e padronit tim erdhi nje gjerman me motorçiklete per te

blere veze. Aty kishte nja 3 – 4 partizane. Ata e pane dhe nuk reaguan fare. Ne ate moment une mendova se partizanet e kishin frike ate. Gjermanet kishin nje fytyre shume te eger dhe ishin te ftohte. Dua te kujtoj dhe nje episod tjeter qe me ka bere shume pershtypje – thote Nikolla dhe nxiton qe t'a tregoje sa me pare. Ishte e shtune dhe me duhej te kthehesha ne shtepi. Ne stacion prisja makinen bashke me disa djem te tjere. Prane nesh prisnin edhe disa vajza shume te bukura. Ne ate moment kalon nje kolone kembesorie gjermane. Ata kaluan shume prane vajzave por asnje nuk e ktheu koken pas qe te shikonte. Neve na beri shume pershtypje dhe i ndoqem me sy derisa u larguan. Aty e kuptova qe me te vertete ata ishin te rrepte, te disiplinuar dhe te forte per luften – perfundon kujtimin e tij i moshuari me sy bojeqielli dhe pak i kerrusur nga pleqeria. Ai tund koken dhe shton: "Ata ishin ushtare te vertete me patos luftarak dhe e meritonin fitoren per nga disiplina dhe edukata ushtarake".

## VARFERIA TE RRIT PARA KOHE

Momenti i pare qe nuk jam ndier femije ka qene momenti kur kam shkuar per te punuar ne nje fshat larg shtepise sime. Fshati quhej Pendavinj dhe ndodhet ne Korçe. Kam qene vetem 14 vjeç kur fillova pune si yzmeqar. Punoja gjithe diten dhe lodhesha shume, megjithate une e ndieja veten te madh dhe te rendesishem sepse do te kontribuoja per familjen. Per punen qe beja nuk paguhesha me para, por me drithera, per shembull per 6 muaj pune une merrja 4 kuintal miser. Kjo mase nuk ishte e mjaftueshme sepse ne ishim shume femije ne shtepi. Une u rrita para kohe. Madje çuditem edhe vete se si kam pasur gjithe ate guxim dhe nuk e njihja friken. Me te vertete qe kam qene shume i madh per moshen qe kisha. Kam qene optimist dhe kete e kam marre mga gjyshi. Gjithashtu me pelqente te jepja mendime ne debatet e te medhenjeve. Kjo ka bere qe une te jem dhe tip i forte e te mos kem frike nga asgje. Dua te tregoj nje histori te kendshme, por ne thelb ajo behet deshmi e karakterit qe po formoja – thote Nikolla dhe leviz pak nga vendi sikur do te mbushet me fryme djaloshare. Kam qene vetem 13 vjeç kur mgarkova gomarin me dru dhe e kam shpene ne Korçe ne oren 12 te nates krejt i vetem. Disa

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II



burra qe me njihnin u çuditen shume. Ata nuk i besonin syve. Ishte nevoja per para ajo qe me shtynte per te ecur perpara. Kam pasur nje guxim shume te madh. Edhe vete nuk e besoj dhe se kuptoj se nga me vinte gjithe kjo force. Por ama nuk kam vetem kujtime te tilla nga femijeria. Kam deshire te tregoj nje histori, nga e cila kam kuptuar se zoti vonon, por nuk harron. Drejtesia gjithmone duhet te shkoje ne vend. Megjithate kjo mund te kete qene rastesi dhe mua me eshte dukur sikur u shperbleva ne nje fare menyre. Historia ka qene keshtu: kishim vene leqe ne pyll bashke me shoket. Une vajta t'i shihja se mos kishin zene ndonje lepur. Roja qe ruante fushen aty prane dhe drute e prera ne pyll u ngrit sepse degjoi zhurme. Sa me pa ai me goditi. Me ka rrahur aq shume sa nuk qendroja dot ne kembe. Ai dyshonte se une mos kisha ardhur per te vjedhur. Roja e pa qe une s'kisha gje me vete dhe me nxori inatin me shqelma qe e ngrita nga vendi dhe i prisha rehatin. Me vone po ky person, roja, do te gjeje vdekjen pasi u fut ne organizatat partizane dhe donte te dezertonte, por shoket nuk e lane dhe ne grindje e siper e vrane pa dashje. Kur mora vesh vrasjen e tij me erdhi keq sepse ishte njeri mbi te gjitha, por me erdhi nder mend menjehere ajo ndodhia e pyllit dhe thashe si femije qe isha se zoti mori hak.

## JETA ESHTE SURPRIZE

Per regjimin socialist une kam shume kujtime te mira. Kam se çfare te tregoj per kete regjim – thote Nikolla kur e pyeta. Nga nje shtrese e varfer qe isha u rendita nder familjet e para te fshatit. Shtepia ime u be dykateshe dhe mbahej si shtepi model qe pushteti socialist i konsideronte si shembull per te thene se ja çfare eshte ne gjendje te beje partia. Nje familje te varfer e shnderroi ne nje familje te pasur. Madje ka ardhur dhe nje grup xhirimi. Kjo mireqenie erdhi si rrjedhoje e punes sime. Ne fillim punova si oficer. Atehere isha beqar. Leket me mjaftonin per vete dhe per shtepine. Kjo pune nuk zgjati shume sepse une kerkova doreheqjen per arsye se nuk isha shume i lire. Fillova nje pune tjeter ne Posten Telegraf – Telefoni te Korçes. Merresha me korrespodencen. Punen e sigurova nepermjet zyres se punes. Ne shtepi vija vetem nje here ne jave. Nuk me bente aq shume

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II

pershtypje largesia sepse une isha mesuar qe i vogel te punoja larg shtepise. Me pas nga puna ne P.T.T. kam kaluar pergjegjes sektori ne mirembajtjen e rrugeve. Ne kete periudhe kam pasur edhe nje pune te dyte ate te instruktorit paraushtarak. Si pergjegjes fitoja shume. Merrja 7 500 leke te vjetra ne muaj. Kjo ishte nje rroge e majme dhe me lejonte te hiqja kursime menjane. Me ato leke une bera shtepine dhe ishte merita ime qe punoja dhe jo e Partise. Partia me dha mundesine vetem te punesohesha. Flas me objektivitet dhe pa interes. Nga sistemi i Enver Hoxhes kam nje veretje. Nuk ishim te lire ne tu shprehur. Kishte cenim te fjales se lire. Madje kjo liri cenohej dhe tek njerezit qe ishin antare te partise. Askush nuk mund te thoshte ate qe mendonte. Keta njerez ishin intrigant dhe ne çdo moment mund te shpiknin ndonje gje per te implikuar. Une kam vete nje pervoje te tille me djalin tim te vogel. Ai ishte 18 vjeç dhe kishte deshira si çdo i ri. Ne fillim e futen ne kurth. E ftuan ne nje klub dhe duke pire me "miqte" filluan ta provokonin. Keta njerez intrigant i thoshin se nuk eshte jete kjo qe behet ne Shqiperi. E ardhmja eshte ne Maqedoni. Ata i krijuan nje fare besimi dhe e bene me qellim qe ai te fliste lirshem dhe me pas fjalet e tij thuheshin ndryshe ne mbledhjet e Partise. Djali im kujtonte se i kishte miq dhe shprehej pa problem por ishte thjesht nje loje dyfishte. Ate e mashtruan nje here dhe nga ky mashtrim ai beri 14 vjet burg. E gjitha filloi nga provokimi i nje agronomi. Djali ishte ne rruge dhe priste makinen. Ne dore kishte radion me bateri. Ai degjonte lajmet te Tirana. Kalon aty ky njeri i poshter dhe ia ndryshon stacionin. I thote me ze te larte: " Çoje te Shkupi. Ai stacion ka muzike shume te bukur. Ç'me degjon lajmet. Ti je i ri, duhet te kercesh, kendosh". Djali nuk e priste kete reagim dhe u çudit. Nderkohe agranomi kishte shkuar ne sigurim dhe kishte raportuar se: " djalin e Nikolles e gjeta duke degjuar muzike te huaj. Ai nuk e do Shqiperine". Keto lloj njerezish ishin njerez pa skrupuj. Ata ishin ne gjendje te shisnin dhe femijet e tyre ne qofte se behej fjale per partine. Kjo gatishmeri – thote Nikolla – vinte si pasoje per te mirat materiale dhe prestigjet qe siguroje nga ana e partise, por jo se ndieje nje dashuri te forte per te. Ne qofte se spiunonte dikush nje person qe kishte ide demokratike atehere ky spiun rritej ne detyre,

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



merrte teseren e partise. Me pak fjale i hapeshin te gjitha dyert dhe nuk vuante. Komunistet kishin gjetur disa stimuj te forte per t'i blere njerezit dhe kjo funksiononte me se miri. Ka qene me te vertete kohe e veshtire. Edhe pse ka difekte une nuk mund te le pa permendur edhe ato te mira qe kemi nga ai sistem. Dua te them qe elektrifikimi ishte nje arritje e madhe. E gjithe Shqiperia u ndriçua nga dritat elektrike. Arsimi u be i detyrueshem. Organet e shendetesise perkujdeseshin per te gjithe njerezit. Kishte aktivitete te shumta. Shkonim neper aksione. Tokat e papunuara ne i beme pjellore kishim nje menyre te mire organizimi me njeri – tjetrin. Ishim si motra dhe vellezer. Nuk kishim konkurence. Gjerat ecnin mire, domethene ne menyre siperfaqesore sepse ishim nje komb i varfer ne krahasim me te tjeret por propaganda ne vend behej sikur ne ishim populli me i lumtur, nderkohe qe nuk kishim kushtet minimale te jeteses si per shembull frigorifer, lavatriçe, TV color. Keto gjera per ne ishin luksoze. Vetem njerezit e partise dhe tek – tuk ndonje intelektual i kishte keto prestigje. Enver Hoxha ndiqte nje politike qe nuk pranonte ndihme nga askush. Me kujtohet kur u prish marreveshja me Titon. Ai kishte nenshkruar nje kontrate ku Shqiperia duhet te mbillte shumicen e siperfaqeve te tokave me luledielli dhe Tito do ta shkembente me drithera buke. Kjo marreveshje nuk perfundoi sepse u prishem me Titon. Kjo prishje me jugosllavine pati nje ndikim te dukshem ne jeten tone. Ne vend pati nje krize per buke, sepse fushat ishin mbjelle me luledielli. Nuk kishte kush t'i merrte. Gjithashtu u nderprene triskat te cilat ishin njesoj si per fshatin dhe qytetin, sepse kjo ishte nje metode qe vinte nga Jugosllavia. Nuk kishte me bollek ne ushqime. Filluam te njihnim nje sistem tjeter qe quhej sistemi reciprok. Do te coje ne dyqan gjera blegtorale apo bujqesore psh: veze, qumesht, djath dhe ne kembim te tyre mund te merrje veshmbathje.

Ky qe nje sistem qe ndikoi negativisht, sepse ne duhej te hiqnim nga goja per te blere gjerat qe na nevojiteshin. Kemi qene nje popull qe kemi vuajtur shume qe nga fillimi. Meqe me jepet mundesia dua te flas edhe per ndikimet qe patem ne jeten shoqerore nga heqja e fese. Njerezit filluan te shthuren. Pati vjedhje ne mase, sepse parimet thoshin te mos vjedhesh, te mos i biesh tjetrit me qafe sepse eshte

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

gjynah. Keto parime u zhduken dhe njerezit u bene si te eger. Festat fetare nuk festoheshin me. Kjo kishte te bente me zhvillimin kulturor te njerezve. Ata qe nuk besonin thonin qe jane gjera te kota, kurse besimtaret mundoheshin qe me qirinj dhe me lutje ne heshtje ti drejtoheshin Zotit per ti plotesuar deshirat.

## DASHURIA NUK NJEH PARAGJYKIME

Une jam martuar ne moshen 23 vjecare. Gruan e kisha 3 vjet me te vogel se vetja. U dashuruam me shikim te pare. Une punoja si pergjegjes i mirembajtjes se rrugeve ne ate kohe. Me ra puna nga fshati i gruas time Fanies. Fshati quhej Gollomboç. Kur e pashe per here te pare ndjeva emozione qe nuk i kisha provuar me pare. Ajo me pa dhe u skuq. Lindi simpatia e pare. Me pas ajo dilte sa here qe me shikonte. Filluam te takoheshim fshehurazi, sepse ishte shume e rrezikshme te dilje hapur ne ate kohe dhe mbi te gjitha ajo ishte e fejuar. Ajo ma tha menjehere dhe mua nuk me beri pershtypje sepse isha i sigurt per dashurine qe ajo ndiente per mua. Ajo ma kishte thene shume here qe nuk e donte te fejuarin, sepse ia kishin bere me mbleseri dhe nuk i kishte ato gjera qe i kisha une per shembull nuk ishte i gjate, nuk ishte inteligjent, nuk dinte te fliste bukur. Mua me pelqenin kete fjale kur i degjoja dhe ndjehesha mire. Gjithashtu ndjeheshim ne siklet sa here caktonim vendet e takimit. Mbaj mend qe prinderit e Fanies e diktuan dhe ajo me tha se do te takoheshim fshehurazi. Ajo gjente si pretekst kopshtin qe ndodhej larg shtepise. Shkonte sikur do ta vadiste dhe pastaj takoheshim fshehurazi. Nganjehere merreshim vesh dhe me letra. I shkruanim njeri – tjetrit ato qe ndienim. Me ne fund vendosa qe ta rrembeja. Lame nje dite dhe vajta ta merrja ne mes te nates. E shpura ne shtepi dhe asnje nga familja ime nuk ishte kunder, sepse ajo ishte zgjedhja ime. E kunderta ndodhi me familjen e Fanies. Ata nuk erdhen per nje vit e gjysem te shihnin vajzen e tyre – thote Nikolla. Femija i pare lindi pas kater vjet martese. Ne vendosem te jeteonim ne shtepine e gjyshit tim ( babai i babait) dhe jo ne shtepine ku u rrita une. E rindertova shtepine dhe e bera dykateshe. Fillova te kisha te ardhura te mira ekonomike. Fania ishte grua punitore dhe mjaft nikoqire. I edukoi femijet si vetja,





ata e donin me shume ate sepse une kisha nature autoritari. Ajo ishte grua e urte dhe nuk bente fjale kur une i bertisja ndonjehere. E ndihmoja ne punet e shtepise kur ajo shkonte ne pune dhe vonohej. I laja enet, i fshija shtepine, gatuaja. Kemi shkuar shume shume mire me njeri – tjetrin.

## KUR NISESH ESHTE SHPRESA PER NJE JETE ME TE MIRE

Hapja e shtetit tone me boten e huaj pati nje te mire dhe te keqe. U njohem me boten e huaj, por ama ne te njejten kohe ne na u larguan femijet. Ky sistem eshte sistem kapitalist dhe duhet te mbijetoje ai qe eshte i zoti. Kjo mundesi u krijua dhe per femijet tane. Ata moren rruget e largita per nje jete me te mire. Momenti kur u nisen ka qene shume i veshtire per mua – thote Nikolla. Mu duk sikur femijet nuk ishin me te mite. Me vinte sikur u shiten. Djali i vogel dhe vajza e madhe kane qene te paret qe donin te kalonin kufijte. Vajzen e kam te martuar ne Elbasan dhe ajo vendosi qe te ikte bashke me femijet ne Maqedoni. Kete deshire kishte dhe djali i vogel i cili u nis pak muaj me vone se vajza. Ishin vitet 90 – 91 ku hapja e kufijve qe thyrje e tabuve. Shkaqet qe i detyruan ishin veshtiresite ekonomike. Me kishin thene disa here qe do te iknin, por ikja e tyre ishte e menjehershme. Per mua qe nje goditje e forte, sepse kisha merak se mos u ndodhte ndonje gje. Ishte koha kur shume vete u vrane buze kufijve. Ata arriten ne Maqedoni, por nuk ishte ajo qe prisnin. Ata i futen ne kampet e Beogradit per nevoje sigurie. Benin ndonje pune qe ishte aty afer dhe parate i shpenzonin per nevojat e tyre. Vajza u kthye kurse djali i vogel kaloi per ne Greqi. Atehere une nuk dija asgje per te sepse nuk kishim telefona. Thuajse e konsideroja te vdekur. Prisja çdo moment qe te merrja ndonje lajm. Me ne fund nje dite erdhi nje leter rekomande. Ishte letra e tim biri. Ai me thoshte te mos behesha merak se ishte mire me shendet. Punonte ne portin e Selanikut. Ai ka qene lajmi me i bukur ne jeten time.

Tani ne u ambientuam pak a shume me emigracionin. Jo se nuk na ben pershtypje, por kemi me shume mundesi per te komunikuar dhe per te marre vesh se si jane femijet tane. Gjithashtu ne ndjehemi mire kur i shohim ata qe jetojne mire dhe jane te lumtur. Ata kane

perfituar shume nga integrami me vendet e huaja. Kane mendime me te perparuara se ne dhe mua kjo me pelqen. Ata jane te rinj dhe nuk duhet te ndryshojne nga rinia europiane.

**JETA DUHET JETUAR NE CDO MOMENT**

Per kete pjese te jetes qe me ka mbetur dua te them se e ndjej shume mungesen e gruas time. Ajo ka dy vjet qe ka vdekur. Mua me duket sikur e kam akoma prane. Ishte nje grua shume e mire dhe mbi te gjitha une e kisha marre me dashuri. Fania u semur dhe per kater vjet ka qendruar e paralizuar ne shtrat. Une i sherbeja bashke me femijet. Diten qe vdiq kam ndjere nje dhimbje shume te madhe. Mu duk sikur mu pergjysmua jeta. E ndjeja veten si nje njeri i gjymtuar qe ka vetem nje krah. Ndjenja e vetmise me trishton jashte mase. Nuk kam frike nga vdekja sa kam nga vetmia. Vdekja eshte nje gje qe do ti ndodhe kujdo. Sot ose neser te gjithe do te vdesim nje dite. Une kam frike se mos me ndodhe ndonje gje nga ato qe degjoj ne lajme. S dua te vdes vetem ne shtepi me dyer te mbyllura pa patur njeri prane. Une i kam femijet, por derisa te vijne ata une i kam mbyllur syte – thote Nikolla dhe hesht per nje moment. Sado qe kam keto mendime perseri une them qe jeta duhet jetuar ne çdo moment. Dua te falenderoj te gjithe personelin dhe italianet qe kane investuar per Qendren Balashe. Ketu une shtyj diten dhe kur e kam pushim te shtunen dhe te dielen ia ndiej se tepermi mungesen. Mezi pres te vije e hena. Ketu kam shume miq dhe nuk i ndiej oret se si kalojne. Bejme aktivitete te ndryshme qe na nxjerrin nga rutina.

Me qeshet me veten kur kujtoj qe nuk doja te vija ne fillim ketu ne qender. Me vinte turp nga njerezit dhe te afermit. Madje nje grua ne bashki qe e quajne Luçi ka bere te pamunduren per te me mbushur mendjen. Une nuk ia vura veshin dhe kur shkova per se dyti ne bashki per nje problem timin ajo me pyeti nese isha rregjistruar. Une e genjeva e i thashe po. Me pas erdha vete qe te shikoja qendren dhe me pelqeu shume. U miqesova me shoket dhe sa me vinte dhe me shtohej deshira per te mos u ndare nga ata.

Mendimi im per ditet e sotme qe jetojme dhe demokracine eshte pozitiv. Demokracia eshte mundesia per te provuar se kush eshte i





zoti te çaje ne jete. Eshte nje prove per njerezit se kush mbijeton. Shprehja e mendimeve eshte e lire dhe nuk te ndrydh askush. Thua ate qe pelqen gje qe ishte e palejueshme ne kohen e Enver Hoxhes. Ndersa per politikanet dua te shprehem se ata jane figura qe duhet te udheheqin popullin. Tek ne ndodh e kunderta. Ata nuk jane te denje per te drejtuar vendin sepse ne rradhe te pare mundohen te plotesojne nevojat personale dhe nuk shqetesohen shume per hallet tona. Ata behen te dashur dhe premtojne vetem ne prag fushatash.

| *Intervistoi* | *Blerta Zeneli* |
|---|---|
| Emri i te intervistuarit: | **Ramazan Cerriku** |
| Vendlindja: | Elbasan ( 5 janar 1934) |
| Emri i te atit: | Kamber Cerrriku |
| Profesioni i te atit: | punetor ngarkim – shkarkimi, ka kryer 4 klase shkolle. |
| Emri i te emes: | Fatime Cerriku |
| Profesioni i te emes: | shtepiake dhe pa arsim. |

*Familja ime ishte nje familje e varfer dhe e thjeshte elbasanllie. Ne kishim shtepine tek lagja "Sul Misiri". Familja ime perbehej nga 6 anetare, prinderit dhe kater djem. Vellai i madh Rrapushi ka mbaruar 4 klase shkolle dhe ka punuar ne Kombinatin e drurit. Pastaj i dyti isha une kam bere 7 klase shkolle dhe kam punuar gjate gjithe jetes derisa dola ne pension ne kombinatin e drurit por per veten do te flase me gjate me poshte. Vellai i trete quhet Shyqyr ka mbaruar 4 klase shkolle dhe ka punuar ne fabriken e cimentos. Vellai i vogel, Fatmiri ka vdekur ne moshen 12 – vjecare ne vitin 1952 nga hepatiti. Edhe pse ishim te varfer dhe jeta me ne eshte treguar shume mizore duke na ruajtur dhe duke na dhene fatkeqesi te ndryshme asnjehere mes nesh nuk ka munguar dashuria dhe respekti per njeri – tjetrin por perkundrazi keto gjera na kane bere me te forte per te jetuar jeten duke menduar dhe shpresuar se dite me te mira do te vijne.*

**FEMIJERIA IME**

Femijeria ime ka qene sa e pasur aq dhe e varfer. Vije nga nje familje e e varfer e cila gjithmone ka punuar me mund dhe djerse per te miren e anetareve te saj. Ndonese s'ishim te pasur prape ne kishim nje edukate qe na kishin dhene dy prinder punetore, te dashur, te ndershem dhe te respektuar nga te gjithe. Kur isha i vogel mbaj mend qe ishte koha e pushtimit italian dhe me pas gjerman dhe cdo

gje ishte e veshtire. Nga koha e mbretit Zog nuk me kujtohen shume gjera pasi une kam qene i vogel por nga ato qe kam degjuar nga prinderit dhe gjysherit mbaj mend se atehere prinderit e mi kane qene te varfer. Nje here kur vajta ne shtepine e gjyshes me kujtohet se ajo shpesh here fliste per kohen e monarkise. Vendi ishte i zhytur ne varferi totale pervec disa familjeve te cilat numeroheshin me gishta dhe qe dalloheshin nga popullsia e thjeshte per vete poziten e tyre ne shoqeri dhe per pasurine qe ata gezonin.

Edhe ne si shumica e popullsise ne ate kohe ishim shume te varfer tregonte ajo dhe duhej te punonim si une dhe gjyshi yt. Kudo kishte papunesi dhe ishte shume e veshtire te gjeje pune. Per burrat punet me te pershtatshme ishin ne are, punetor ngarkim – shkarkimi, muratore ose po te kishe ndonje zanat tjeter dhe te hapje ndonje dyqan te vogel kurse per femrat nuk lejoheshin te punonin jashte pasi kudo egzistonte fanatizmi por ato mund te punonin ne shtepine e te pasurve duke bere pune te ndryshme si per shembull te ishe sherbetore ne shtepine e tij qe do te thoshte te laje apo te pastroje etj ose te punoje duke qendisur pajen e vajzes se tij si dhe shume pune te tjera. Ne treg kishte mallra por qe kushtonin shume, pazari behej me napolona te cilat ishin para floriri qe perdoreshin ne ate kohe. Cmimet ishin shume te larta dhe vetem te pasurit mund ti blinin ato gjera pasi vetem ata gezonin nje mireqenie e cila mund tu siguronte nje jete shume me te mire se ajo qe bente pjesa tjeter e popullsise.

Kudo kishte lufte, te vrare dhe shkaterrime. Ne kete kohe ne femijet kishim frike te dilnim pasi kudo kishte ushtare te huaj, gjithashtu kishim frike dhe nga bombardimet. Madje dhe ne shkolle nuk shkonim pasi ishte shume e veshtire dhe shkolla ishte shume larg. Keshtu deri ne clirimin e Shqiperise nuk kam mundur te ndjeke shkollen. Gjate kesaj kohe une merresha me punet e shtepise. Ne kishim dhe nje kopesht te vogel perpara shtepise ne te cilin mbillnim perime te ndryshme te cilat me pas do te sherbenin sadopak ne ekonomine e familjes, dhe mua me pelqente shume te merresha me kopshtari dhe aty e ndjeja veten me te vertete shume mire. Gjate kohes tjeter luaja me shoket e lagjes. Mblidheshim te gjithe femijet duke formuar dy skuadra dhe luanim futboll me top prej lecke.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



Atehere topi prej plastike ishte nje luks per ne, ate mund ta kishin vetem djemte e te pasurve. Kjo ishte loja jone e preferuar. Une kam patur dhe nje shok te ngushte qe e quanin Qamil Sula. Ne banonim te dy ne te njejtin lagje, ishim komshinj, ishim shok dhe miq te ngushte. Kudo iknim bashke, cdo gje e benim bashke, si per shembull detyrat qe na jepte mesuesi, luanim te dy ne te njejtin skuader dhe ishim me te vertete miq special. Edhe kur filluam shkollen ne te dy iknim bashke dhe rrinim ne te njejten banke ku cdo gje e ndanim mes nesh. Nuk ishim nxenes te shkelqyer por mundoheshim te ishim te mire. Ruaj dhe nje kujtim tjeter nga koha e shkolles.

Ne pergjithesi ne ishim shume te urte dhe shihnim vetem punen tone dhe kur te tjeret fillonin te ziheshin ose te benin zhurme mesuesi perzinte te gjithe djemte e klases perfshire edhe ne sepse mendonte se edhe ne kishim kontribuar ne kete gje. Kete miqesi e kemi mbajtur per te gjithe jeten edhe kur u martuam ndonese cdo njeri prej nesh kishte problemet e veta ne familjet e tij. E kemi mbajtur kete miqesi sikur te kishim qene kusherinj derisa ai vdiq ne vitin 1995 nga kanceri. Per mua ishte nje humbje e madhe vdekja e tij sepse per cdo gje isha mesuar qe te konsultohesha me pare me te dhe pastaj ta diskutoja me te tjeret. Per mua ai ishte nje mbeshtetje e madhe gjate gjithe jetes sime.

**FAMILJA IME**

Babai im me ka lene ne nje moshe te vogel kur une isha vetem 11vjec ne nje periudhe shume te veshtire per familjen tone. Sepse sapo ishte cliruar Shqiperia dhe ne atehere me ne fund dolem nga ai pushtim i gjate dhe nga ajo skamje dhe donim te rindertonim jeten tone sa me pare dhe sa me mire. Ai vdiq ne vitin 1945, nje vit pas clirimit te vendit. Ndersa po punonte me shoket e vet ra ne gropen e gelqeres se pashuar. Ai ne ate kohe kishte filluar pune si murator pasi ishin hapur shume vende te reja pune dhe kerkoheshin njerez me zanate te ndryshme.

Vendi ishte per tu ndertuar dhe kerkohej force punetore e lire. Keshtu babai im u paraqit dhe filloi pune si murator se bashku me disa shoke te tjere por fati i keq beri qe ai te rreshqiste ne gropen e

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

gelqeres duke shkaktuar nje hidherim shume te madh ne familje dhe sidomos per nenen time e cila tani ngeli e vetme ne rritjen e 4 femijeve te saj. Per ne ishte nje tragjedi e vertete pasi ishte babai ai kujdesej per te gjithe ne. Ai punonte ku te mundte si per shembull punetor ngarkim – shkarkimi, ne ndertim etj. Punonte per mundohej qe te mos na mungonte asgje. Sa here qe vinte nga puna na sillte ndonje gje si rroba, ose karamele. Me kujtohet qe nuk na mjaftonin asnjehere leket dhe nena ime gjithmone ankohej per kete gje.

Ndonese nga ekonomia ishim shume te varfer por kjo nuk na pengonte te ishim te sjellshem e te dashur me te gjithe si ne familje ashtu dhe ne lagjen ku jetonim pasi te gjithe kishim te njejtat probleme, te njejtat halle. Mbaj mend qe babai sa here qe kthehej nga puna na puthte duke na pyetur sesi ia kishim kaluar dhe nese kishim bere gabime apo nese e kishim merzitur nenen. Babai e donte dhe e respektonte shume nenen time, mundohej te ishte i qete, i dashur me te dhe me ne edhe kur kthehej i lodhur nga puna edhe kur nuk punonte apo kur ishte i merzitur. Gjithmone e degjonte nenen time nenen time ne lidhje me problemet qe ajo kishte pasur gjate dites. Ndersa nga ne ai kerkonte disipline shpeshhere kur ikte ne pune na porosiste qe te mos ziheshim me te tjeret, te ishim te sjellshem, te degjonim nenen dhe ti bindeshim asaj per cdo gje. Babai dhe nena ime jane martuar me mbleseri.

Ata banonin te dy ne te njejten lagje ne periferi te qytetit. Keshtu nje daje e nenes time duke njohur babain tim mendoi se do te ishin nje cift shume i mire se bashku. Dhe keshtu nderhyri ne familjen e babait tim per te bere te mundur kete lidhje e cila perfundoi me martesen e te dyve dhe nga kjo martese linden 4 femije. Edhe pas vdekjes nena ime e kujtonte gjithmone me nostalgji dhe me lot ne sy ate periudhe qe kaloi me babain edhe pse fati nuk i la te kalonin nje jete me te gjate se bashku. Mbasi vdiq babai nena filloi te shkonte ne pune pasi s'kishte tjeter mundesi keshtu ajo u caktua te punonte ne kanalin "Naum Panxhi" i cili lidhte Elbasanin me Cerrikun dhe furnizonte kete te fundit me uje per vaditjen e tokave bujqesore qe gjendeshin perreth kesaj zone.

Ajo punoi vetem derisa dolem ne ne pune dhe filluam te jepnim





ndonje ndihme ne ekonomine e familjes. Gjysherit i kam dashur shume. Kur na merrte malli shpesh vinim dhe i vizitonim se bashku me prinderit dhe kenaqeshim shume. Ata kane qene njerez punetor dhe kane vuajtur pasi cdo gje e kane arritur me forcat e veta si te gjithe njerezit e ndershem e asaj kohe. Edhe pse ishin te varfer ata tregoheshin gjithmone bujare me femijet, gjyshja mundohej te na gatuante gjera sa me te mira ato pak dite qe rrinin dhe gjithmone na perkedhelte me dashuri.

## PERIUDHA E LUFTES DHE NDIHMA JONE PER PARTIZANET

Nga lufta me kujtohet se ne femijet kishim frike te dilnim ne rruge pai kishte luftime. Me 7 prill 1939 erdhi Italia fashiste. Ne kohen e italianeve ishte shume ndryshe pasi ata ishin njerez te mire dhe te sjellshem dhe neve na jepnin gjithmone per te ngrene si konserva apo ushqime te tjera te cilat i kishin sjelle nga Italia. Edhe pse e pushtuan vendin pasi mbreti Zog ua dha kete mundesi duke ua shitur atyre, ata nuk ishin per lufte.

Kur kapitulloi Italia dhe erdhen gjermanet shume nga ushtaret italiane u vrane, shume u larguan jashte vendit, shume te tjere u bashkuan me partizanet, disa te tjere u moren nga fshataret apo nga familje te ndryshme shqiptare dhe ku u bene njerez te shtepise dhe ndihmonin ne punet e ndryshme qe mund te kishin si ne are apo ne shtepi. Italianet ishin njerez shume qeflinj sidomos pas femrave te bukura dhe u pelqenin tu hidhnin fjale. Kurse gjermanet ishin shume te ndryshem, ishin shume te eger. Nuk mund tua ktheje dot fjalen pasi ata nuk ta benin te gjate, te vrisnin ne vend. Shpesh here vinin dhe benin kontrolle te ndryshme neper shtepira pasi kerkonin se mos kishin fshehur partizane.

Plackisnin kudo qe shkonin, merrnin cfare do lloj gjeje, kuaj, gomere, karroca dhe cdo gje qe ata mund ta konsideronin si te dyshimte, apo qe mund te sherbente per te ndihmuar partizanet. Nuk i ngacmonin kurre femrat dhe ishin te ashper, me ta nuk mund te bisedoje. Sa here qe partizanet sulmonin ose godisnin batalionet gjermane, gjithmone gjermanet hakmerreshin duke bere plackitje ne

popullsine e pafajshme duke rrahur njerez te pafajshem apo duke djegur shtepite e ndryshme ku ato dyshonin se mund te ishin shtepi komunistesh apo mund te fshinin komuniste apo i ndihmonin ato. Me kujtohet kur avionet angleze dhe te forcave aleate bombarduan uren e Shkumbinit pasi ne afersi te ures ishin garnizonet e ushtrise italiane. Nje kembe e ures u shemb dhe italianet vune shtetrrethim 24 ore. Dhe neve na u desh qe per 24 ore te mos dilnim nga shtepia. Kishim frike te dilnim pasi me pushtuesit nuk behej shaka vecanerisht ne kete moment shume kritik per ta. Ishin shume te terbuar.

Meqenese s'mund t'u benin gje atyre qe i bombarduan inatin filluan ta nxirrnin tek banoret e qytetit. Kudo neper qytet degjoheshin zerat e tyre qe therrissnin, makinat te cilat leviznin pa pushim ne te gjithe lagjen duke bere kontrolle dhe duke plackitur. Disa nga familjet te cilet i kishin bijte e tyre partizane i dogjen disa te tjere qe dyshoheshin se i ndihmonin drejtperdrejt partizanet i arrestuan dhe moren me vete ne burgjet e tyre ku i torturuan per te nxjerre ndonje emer. Disa vdiqen nga torturat qe pesuan disa te tjere u liruan pasi nuk treguan asgje. Pasi kapitulloi Italia erdhen gjermanet te cilet sic e thashe dhe me siper ishin te eger dhe te ngrysur ne fytyre.

Kam dhe nje kujtim tjeter nga lufta qe lidhet me babain tim. Babai im shpesh here u conte buke dhe ushqime me kuajt qe kishte, te cilat i kishte mbledhur neper qytet partizaneve ne mal. Keshtu ai u nis dhe ate dite me 3 kuajt e tij per te cuar porosine ne vendin e duhur i cili ishte ne afersi te Tiranes dhe i duhej te kthehej perseri ne shtepi. Mirepo nderkohe partizanet kishin sulmuar gjermanet dhe keta te fundit per t'u hakmarre cdo njeri qe i dilte perpara e kapnin dhe e merrnin me vete ne bazat e tyre ku e rrihnin. Keshtu ndodhi dhe me babain tim. Ai po kthehej nga partizanet dhe nuk kishte asgje ne kuajt. Gjermanet e kontrolluan por nuk gjeten asgje.

Ata e moren me vete duke i thene se ishte nje komunist dhe se ndihmonte partizanet duke u cuar buke dhe veshmbathje. Por fati deshi qe babai nuk kishte asgje te ngarkuar ne kuaj dhe ata nuk mund ta provonin dot nese ishte i tille. Keshtu ata e mbajten 24 ore ne qendren e tyre ku e kishin rrahur shume keq me kamzhik sidomos nga trupi. Ne menduam se e kishin vrare dhe u beme shume merak.





Por kur e pame mengjesin tjeter te kthehej u gezuam dhe me pas ai na tregoi se cfare i kishte ndodhur. E kishin rrahur shume keq, kurrizin e kishte te gjithin te nxire ndersa nga fytyra nuk e kishin rrahur aq shume. Mezi ecte. Ishte shnderruar ne nje tjeter njeri. Nena me pas i pregatiti kompresa me qepe dhe kripe dhe ia vendoste ne kurriz per te thithur gjakun e zi. Per 2 jave ai nuk levizi nga krevati dhe kurdohere ishte nena se bashku me ne qe i qendronim afer dhe e ndihmonim kur ai kerkonte ndonje gje ose kerkonte te levizte.

Mirepo gjermanet ne punen e tyre ndihmoheshin nga Balli Kombetar te cilet ishin shqiptare qe kishin tradhetuar vendin e tyre, njerezit e tyre dhe ishin bashkuar me pushtuesin ndaj ne i therrisnim ballista. Nuk e kuptoj se perse sot ata thone se kane ndihmuar levizjen clirimtare kur te gjithe e dine se ata kane qene tradhtare dhe i kane bere nje sere te keqia ketij vendi. Duke qene se ata ishin lindur dhe rritur ketu e njihnin te gjithe vendin dhe te gjithe njerezit. Me kujtohet se kryetar i ballisteve ketu ne Elbasan ka qene Lush Lleshanaku i cili u vra me pas me ardhjen e pushtetit te Enver Hoxhes ne uren e Paprit. Ky person se bashku me banden e tij jo vetem ndihmonte gjermanet ne spiunim e partizaneve por dhe perfitonin nga kjo miqesia me gjermanet duke bere plackitje, duke vjedhur dhe duke marre cdo gje qe u dilte perpara me justifikimin se u duhej gjermaneve per te luftuar kunder partizaneve.

Ndonese kjo gje nuk na pelqente nuk mund te benim asgje pasi ata te spiunonin tek gjermanet. Me kujtohet se vazhdimisht ne shtepine tone vinin partizanet te cilet caktoheshin nga shtabi i pergjithshem i luftes nacional clirimtare. Ky shtab u formua ne Labinot, nje fshat ne afersi te Elbasanit me 10 nentor 1943. Ne nuk dinim gje per kete mbledhje te rendesishme qe po behej. Vetem mbas disa ditesh e morem vesh se ishte krijuar ky shtab me ne krye Enver Hoxhen si komandant i pergjithshem i ketij shtabi. Ne kete mbledhje ai u zotua qe do te luftonin deri ne vdekje per clirimin e vendit dhe se i gjithe populli i madh dhe i vogel duhet te jepte ndihmen e tij ne kete lufte. Keshtu qe kerkohej mobilizimi i popullsise ne te gjithe vendin. Per kete gje partia shpesh here dergonte partizane ne familjet te cilat ishin pro luftes, pra ne familjet e besuara qe ndihmonin kete levizje.

Une kam qene femije dhe me kujtohet se per ne ishte nje gezim i madh ardhja e tyre ne shtepine tone. Ata na perqafonin sikur ne te ishim njerezit e tyre te afert. Ne i shikonim me respekt dhe na dukeshin njerez shume te medhenj te cilet kishin marre parasysh edhe vdekjen per te cliruar vendin nga pushtuesit. Ata benin kujdes qe te mos flisnin ne sy tone per gjera te rendesishme pasi ishim femije dhe mund te tregonim jashte ndonese prinderit na porosisnin sa here qe te benim kujdes pasi spiunet ishin kudo. Mbaj mend qe nje here ndersa ne ishim ne dhome ato po flisnim me babain se si mund ti shtonim rradhet e partizaneve se cfare mund te benim per te sensibilizuar popullsine pasi vetem keshtu mund te arrinim fitoren e shume deshiruar prej shekujsh. Ata ishin njerez te thjeshte te veshur me rroba te vjetra por me nje dashuri te madhe per vendin dhe per popullin e tyre.

Me ne fund me 11 nentor te 1944 u clirua Elabasani. Populli ishte shume i gezuar dhe doli neper rruge. Ata kendonin dhe brohorisnin me tabela neper duar duke ia dedikuar kete fitore udheheqesit te tyre Enver Hoxha. Kudo kishte shkaterrime dhe per te gjithe ne lindi detyra per rindertimin e qytetit. Megjithate gezimi me madh ishte kur me 29 nentor te 1944 u clirua e gjithe Shqiperia. Ishim me ne fund te lire dhe te lumtur.

## JETA DUHET TE JETOHET ASHTU SIC VJEN...

Menjehere pas clirimit per ne femijet u dha urdhri per te filluar shkollen dhe keshtu une se bashku me 2 vellezerit e mi filluam shkollen 4 – vjecare. E benim gjate dites dhe duhet te ishim te pregatitur cdo dite. Ndersa mbasdite ndihmonim nenen tone ne punet e shtepise ose ndihmonim duke bere ndonje gje te vogel per te ndihmuar te rriturit ne ndertimin e qytetit. Ndersa kur ishte vjeshte vilnim ullinjte, ose merreshim me vaditje apo prashitnim. Per te gjitha keto pune ne pagueshim. Jo te gjithe punonin, ne klasen time punoja une se bashku me disa shoke te tjere sepse vetem ne ishim nga ana ekonomike me keq dhe mundoheshim qe sadopak te lehtesonim hallet e femiljes sone. Me 1949 mbarova shkollen elementare. Pastaj fillova pune ne Kombinatin e drurit si punetore ngarkim – shkarkimi. Keshtu mund te ndihmoja nenen time ne permiresimin sadopak te ekonomise duke





kontribuar me rrogen time. Punoja shume gjate dites dhe beja te gjitha punet me te veshtira sepse doja te fitoja sa me shume leke. Shkoja gjithmone pas punes se veshtire sepse e dija qe atje ishin leket. Me 1952 ne familjen time ndodhi nje tragjedi. Vdiq vellai im i vogel Fatmiri ai nje dite u kthye nga shkolla dhe kishte temprature te larte. Mami kujtoj se ishte ftohje e thjeshte. Keshtu e kuroi me ato qe kishim ne shtepi por me vone e kuptoj se nuk ishte ftohje e lehte e coi tek doktori i cili i tha se ishte hepatit. Ne ishim te varfer e nuk mund te gjeje asnje ilac nga ato qe kishte pershkruar doktori. Vellai im vdiq duke i dhene dhembje te madhe sidomos nenes tone. Ajo me pas do ti kujtonte gjithmone babain dhe vecanerisht vellain. Me 1953 ika ushtar. Me caktuan ne Korce. Ne ate kohe ushtria zgjaste 3 vjet. Me thene te drejten me gezoi ky vendimi sepse do te isha afer nenes dhe mund te vija ta shikoja shume shpesh. Si rregull ushtrine e beje per tu pregatitur per ndonje sulm te mundshem qe mund te benin shtetet e tjera dhe atje te mesonin nje profesion. Keshtu une u bera radiofonist, detyre kjo qe do te me sherbente me pas ne zboret qe do te beja kur te kthehesha ne shtepi. Per mua ishte nje eksperience e bukur pasi me dha mundesine te mesoja shume gjera intresante. Ne ushtri u njoha me nje ushtar tjeter dhe me te u beme menjehere shoke te mire.

Ai banonte ne nje fshat afer Korces dhe keshtu nje dite me ftoi ne shtepine e tij. Prinderit e tij ishin me te vertete njerez te mrekullueshem. Atje une u njoha me gruan time te ardhshme Mevluden.

Ajo ne ate kohe ishte 15 vjec ndersa une 18. Ishte shume e bukur dhe mua me pelqente shume. Me thene te drejten ishte me e bukur se une. Pasi shkova disa here dhe e njoha mire shpreha deshiren per tu martuar me kete vajze. Isha bere tashme nje i shtepise keshtu qe ata me njihnin shume mire dhe me dhane menjehere nje pergjigje pozitive kur une kerkova doren e saj. Por une para se te shkoja ushtar kisha njohur nje vajze tjeter ketu ne Elbasan. Pasi dola disa here me ate me thane disa persona se ajo kishte qene e fejuar me perpara dhe se tani ishte ndare. Meqenese ajo nuk me kishte thene asgje une u ofendova shume dhe e lashe. Por fati e deshi qe une te njihja nje vajze tjeter shume te bukur, punetore, te dashur, te ndershme dhe te urte. Keshtu kur merrja ndonjehere leje nga komandanti shkoja ta takoja,

ndonjehere dilnim bashke por sigurisht te shoqeruar nga prinderit pasi atehere egzistonte fanatizmi.

Me 5 nentor te 1955 mbarova ushtrine dhe u fejova zyrtarisht me nusen time te ardhshme. Kur erdha ne Elbasan fillova te punoja perseri ne Kominatin e drurit si punetor ngarkim – shkarkimi. Gjate fundjaves shkoja ne Korce per te takuar Mevluden dhe kur nuk mundja i dergoja leter ose i beja telegram. Pastaj me 1958 u martova, une isha 24 vjec ndersa Mevludja ishte 21 vjec. Nga kjo martese linden tre femije, dy djem dhe nje vajze. Ajo pastaj filloi pune ne te njejtin vend si une. Gjate kesaj kohe une bera shkollen e nates 3 vjecare. Keshtu gjate dites punoja dhe naten shkoja ne shkolle. Mbasi mbarova punen me caktuan si makinist ne fabriken e prodhimit te fibres. Aty punova deri sa dola ne pension.

Punoja shume sepse tani duhej te mendoja dhe per familjen time te re. Me kujtohet se kur punoja ne fabriken e fibres na erdhi nje drejtor i ri qe quhej Qemal Marseli. Ai kishte qene ne te kaluaren sekretar i nje udheheqesi te larte te shtetit komunist por qe sic ndodhnin atehere prapaskenat e asaj kohe ate e kishin liruar nga detyra dhe e kishin derguar ne Elbasan si drejtor i fabrikes ku punoja une. Menjehere u beme shoke te mire dhe gjithmone gjate kohes se lire bisedonim se bashku. Keshtu ndodhi dhe nje dite kur une po rrija i merzitur i ulur ne nje stol. Ai me pa dhe me pyeti se cfare me kishte ndodhur. Une iu pergjigja se sapo kisha mbushur 50 vjet dhe se kisha shume frike nga vdekja. Ai me erdhi prane dhe me vendosi doren ne sup dhe u ul afer meje duke me thene se s'duhej ta mendoja kurre pasi nese une do ta mendoja si nje gje shume te afert nuk do ta kisha shume te gjate dhe kisha per te vdekur shume shpejt. Shikome mua - me tha duke u ngritur ne kembe – une kam shetitur ne gjithe boten pasi profesioni qe une kam patur me ka lejuar qe te shikoj shume gjera te bukura dhe jam shume me i madh se ty ne moshe dhe perseri nuk e mendoj vdekjen por mundohem te jetoj jeten ashtu sic me vjen me te mirat dhe te keqiat e saj.

Kete duhet te besh dhe ti me tha duke mu drejtuar mua qe tani me kishte ardhur disi ngjyra e fytyres. Me thene te drejten me goditen shume fjalet e ketij njeriu qe jetonte jeten duke pare dhe ne gjerat e





keqia anen pozitive te tyre. Fitova shume nga ky njeri dhe gjithmone e kujtoj me respekt. Nje gje tjeter qe do ta kujtoj me shume nostalgji nga koha e punes jane aksionet qe benim per cdo vit per te ndihmuar ne ndertimin e vendit, apo jepnim ndihmesen tone aty ku kishte me shume nevoje atdheu. Te gjitha ndermarrjet ishin te mobilizuara te benin nje gje te tille, ishte si nje fare rregulli. Megjithate per te gjithe ne qe merrnim pjese ishte nje gezim shume i madh ndonese punonim ne pune te ndryshme si hapja e tokave te reja, mbjellje, prashitje etj. Punonim shume dhe kishim nje moral shume te madh.

Mbas pune pergatisnim cadrat per te flejtur jashte ku ndiznim zjarre te medha dhe benim mbremje te ndryshme. Se bashku me ne vinin edhe muzikant te cilet mbremjeve na krijonin momente shume te kendshme defrimi. Lodhjen e dites nuk e ndjenim fare megjithese lodheshim shume. Ne keto aksione merrnin pjese te gjithe punetoret e ndemarrjes pa perjashtim edhe femrat madje une isha me i vjetri dhe perseri nuk e ndjeja kete gje pasi atje ishim sikur te kishim te njejten moshe. Aksioni konsiderihej si nje obligim per te gjithe popullsine. Me kujtohet se kam marre pjese ne aksione anembane vendit. Ne keto aksione ne ndaheshim ne brigada dhe me mbarimin e aksionit, brigada qe kishte punuar me shume i jepnin ne menyre simbolike per punen qe kishte bere "sulmues" apo flete lavderimi ku cilesohej se kjo nderrmarrje kishte qene shembullore ne kete akion. Me kujtohet se kur iknim ose kur ktheheshim nga aksioni me autobus ishim shume te entuziasmuar, kendonin kenge te ndryshme. Pervec aksioneve ne kohen e Enverit ne benim nje muaj ne vit zbor e cila kishte te bente me berjen e stervitjes ushtarake me qellim qe ti kishte njerezit e pregatitur ne rast sulmi.

Keto stervitje ne i benim ne zona malore te vendit ku imitonim nje terren lufte dhe ne duhet qe ta mundnim armikun. Ne keto stervitje merrnin pjese si femrat dhe meshkujt, visheshim te gjithe me rroba ushtarake. Kete stervitje ne e benim ne muaj te ndryshem te vitit. Flinim ne natyre neper tenda te ndara vec burrat dhe vec grate. Nje here kur po ktheheshim nga zbori dhe ishim shume te lodhur, une isha ne makinen e pare se bashku me disa shoke te tjere. Ne makine kishim edhe nje top te cilen e kishim perdorur gjate stervitjes. Ne po

bisedonim kur ndjeme se topi po rreshkiste. Ishte merite e shoferit qe frenoi ne moment pasi nese s'do ta kishte bere nje gje te tille ne do te kishim rene te gjithe ne humnere. Me thene te drejten u frikesuam shume nga kjo qe na ndodhi por ishte fati jone i mire qe shpetuam pa ndonje problem. Ne zbor une kisha rolin e shefit te nderlidhjes ku duhet te jepja te dhenat teknike qe me kishte dhene komandanti mbi vendndodhjen e armikut, nga pika e vrojtimit. Shpeshhere ka ndodhur qe ne aksionet apo ne zbor shume nga shoket ose shoqet tona jane dashuruar dhe sot jane te martuar dhe kane krijuar familjet e tyre.

Me 1965 hyra ne partine komuniste nderkohe qe im vella Rrapushi kishte 2 vjet qe ishte futur ne parti para meje. Te beje pjese ne parti ishte nje privilegj per te gjithe. Atje mund te hynin vetem personat e ndershem, punetore dhe besnik te partise. Cdo komunist kishte detyra per te respektuar si dhe parimet qe ishin te vendosura nga qendra. Nje nga parimet kryesore te te gjithe komunisteve ne mbare Shqiperine ishte te ishe i pari ne sakrifica dhe i fundit ne pretendime. Keshtu cdo te premte ne komunistet mblidheshim dhe duhet te benim nje mbledhje qe ne ate kohe quheshin "Forma e edukimit" ku lexonim librat e marksizem – leninizem ose librat e Enver Hoxhes ku nxirrnim mesime prej tyre te cilat duhej te zbatoheshin nga te gjithe ne apo pergatisnim materiale per problemet qe hasnim gjate javes. Si per shembull kur nuk realizohej plani i punes ne benim mbledhje per te sqaruar rrethanat se perse nuk u realizua ai dhe se ku calonte puna, kush e kishte fajin dhe se cfare mund te bente secili prej nesh per te plotesuar detyrat qe na kishte vene partia. Pasi ne ate kohe partia vendoste per cdo nderrmarrje nje plan te cilin duhej ta permbushje me cdo kusht dhe se kjo ishte nje detyrim per te gjithe ne, panvarsisht nese plani ishte i madh.

Ne ate kohe fjala e partise nuk diskutohej pasi partia kishte te drejte dhe veprimet apo mendimet ose sugjerimet e saj nuk ishin kurre te gabuara. Apo benim mbledhje per ndonje person i cili ishte dembel dhe nuk punonte me te njejtin ritem si te tjeret ku vinim ne dukje te metat e tij, ngriheshim te gjithe dhe kritikonim personin duke i kerkuar qe te kthente rruge dhe te ecte njesoj me shoket. Ne

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II



komunistet duhej te kritikonim cdo njeri panvaresisht nga pozita qe ai mund te kishte pasi ne qendronim shume me larte se cdo person tjeter i shoqerise dhe te gjithe ne e ndjenim veten shume pergjegjes per gjithcka qe ndodhte ne shoqerine tone.

Ne vitin 1973 me vdiq nena dhe ishte vetem 65 vjec. Per mua ishte nje humbje e madhe gjithmone me eshte dhembsur ajo pasi nuk pa asnjehere dite te lumtura ne jeten e saj. Kohet e fundit ajo kishte ardhur te jetonte se bashku me familjen ne shtepine time. Ajo na ndihmonte me ndonje pune shtepie ndonese nuk i kerkonim asgje vetem donim qe ajo te ishte e lumtur me niperit dhe mbesat e saj.

Per kete gje ajo ikte dhe qendronte disa kohe tek njeri pastaj kur e merrte malli per te tjeret i visitonte me rradhe. Keshtu ditet e fundit te jetes se saj ajo vendosi ti kalonte ne familjen time. Si nene e mire dhe e dhembsur qe ishte na pregatiste dreken me qellim qe kur te vinim nga puna une dhe ime shoqe ta gjenim gjellen gati. Nuk donte qe femijet e mi te shkonin ne kopesht ate kohe kur ajo vinte ne shtepi pasi i dukej se te tjeret nuk kujdeseshin sic duhej per to ashtu sic bente ajo.

Ajo i pregatiste atyre cdo gje ne menyre qe ata te kenaqeshin dhe ta mbanin mend si nje gjyshe e dashur dhe e mire. Nuk vuante nga ndonje semundje por une them se ate e breu humbja e te shoqit dhe e te birit ne nje moshe shume te re te cilat ajo do ti vuante dhe do ti kujtonte gjate gjithe jetes se saj. Me kujtohet se edhe kur kujdesej per femijet e mi asaj shpeshhere i rreshkisnin lote neper faqe, te cilet mundohej ti fshinte por qe une i kuptoja. Ndonjehere femijet me thoshin kur kthehesha nga puna se gjyshja kishte qare por une gjithmone beja sikur nuk i kuptoja ose u thosha se ajo qante se e kishin merzitur ata prandaj here tjeter duhej te tregoheshin me te mire dhe me te sjellshem me gjyshen duke u perpjekur qe te mos e merzisnin por gjithmone duhej ta degjonin dhe ta respektonin.

Kur ajo vdiq une ndodhesha ne Korce te vizitoja njerezit e gruas. I kisha thene dhe asaj se ne qofte kishte deshire mund te vinte me ne por ajo me tha se e ndiente veten te lodhur dhe se nuk do te shkonte tek asnjeri por ato dite do ti kalonte vetem ne shtepine time per tu shpelodhur pasi e ndjente veten shume te lodhur dhe do te perfitonte

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II

nga keto dite per tu qetesuar si dhe per te sistemuar ndonje gje te vogel ne shtepi. Une nuk e vrava mendjen shume dhe mendova se ajo me te vertete e ndjente veten te lodhur dhe u thashe vellezerve te mi per kete vendim te nenes dhe qe te vinin e te mos e linin vetem keto dite qe s'isha une. Ndonese nje ze brenda meje me thoshte te mos e lija vetem, megjithate nuk e degjova dhe vendosa te iki. Para se te niseshim ajo me perqafoi dhe me puthi fort mua dhe familjen time duke me thene se do ta merrte malli shume per ne. Ne ate moment pashe se syte i kishte te mbushur me lot. Me thene te drejten u preka shume nga ato lote qe pashe, megjithate mendova se i kishte lot malli, ndonese nuk e kisha pare ndonjehere qe te qante.

Mendoj se dhe ajo e ndiente se ato dite do te vdiste, pasi kurre me pare nuk kishte preferuar te rrinte vetem, madje them se ajo urrente te rrinte vetem, gjithmone donte qe te ishte e rrethuar nga njerez qe ajo i donte dhe qe e donin. Ndonese ne ndejtem vetem disa dite mua mu duken shume te gjata pasi e ndjeja se dicka nuk po shkonte sic duhej. Mbas tre ditesh kunati im me tha se me kerkonin urgjent ne telefon nga Elbasani por qe nuk e dinte se per cfare behej fjale. Kur me thane kete gje mendja me vajti menjehere tek ajo por nuk e dhashe veten per momentin. Ashtu i shqetesuar u nisa drejt postes, ndjeja se po me dridheshin kembet dhe dicka e forte po me shtrengonte ne gjoks. E kapa telefonin dhe aty mesova se cfare kishte ndodhur. Menjehere u ktheva se bashku me familjen time ne Elbasan. Me thane se i kishte pushuar zemra krejt papritur dhe se doktoret nuk kishin mundur te benin asgje, pasi vdekja kishte qene shume e shpejt. Mendoj se dhe ajo nuk do te kishte dashur qe te jetonte me pasi me ne fund na kishte pare te gjithe djemte e saj te rregulluar, me familje dhe me femije.

## E KALUARA DHE E SOTMJA

Persa i perket kohes se Enverit dua te them se ne ate kohe egzistonte disiplina e madhe. Une jam nje simpatizant i asaj kohe. Me pelqente ajo kohe pasi panvaresisht nga disa te meta qe mund te kishte njerezit duhet te shikojne dhe anet pozitive te asaj kohe. Keshtu per shembull vendin e nxorri nga lufta dhe eshte merite e tij

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II



rimekembja e vendit nga ai shkaterrim qe pesoi nga lufta, coi driten elektrike deri ne fshatin me te larget te Shqiperise, pune kishte mjafton te kishe mbaruar nje shkolle dhe te kishe deshiren per te punuar. Ua mori pasurine te pasurve dhe ua ndau te varferve ne menyre te barabarte po te njejten gje beri dhe me bagetine. Sipas meje jeta ishte me e mire atehere. Ndersa tani vendi po kalon nje situate te paqendrueshme politike dhe ekonomike. Nuk egsiston me ajo qetesi qe ishte ne ate kohe.

Njerezit mendojne vetem per para duke humbur keshtu virtytet e tyre te verterta. Atehere cmimet ishin te ulta, dhe te mjaftonin per te bere nje jete normale si te gjithe te tjeret, po te beje gabime te ndershkonin dhe njerezit i trembeshim shume kesaj gjeje,ndersa tani nuk ka ligje te forta ato jane shume te buta. Papunesia eshte e madhe edhe kur gjen nje pune private ajo nuk eshte pergjithmone dhe nuk te paguhen sigurimet te cilat jane shume te vlefshme per pleqerine. Po keshtu nje gje e mire qe kishte Enveri ishte se ne qofte se ishte i martuar ai te pajiste me shtepi. Pallate ndertoheshin per vit dhe nese nuk e merrje kete vit do ta merrje vitin tjeter. Ishte thjesht nje ceshtje kohe. Kurse tani eshte shume e veshtire per te blere nje apartament sado i thjeshte mund te jete ai. Edhe sikur te punosh per te gjithe jeten me nje rroge shteti nuk mund ta blesh dot, pasi rrogat jane shume te vogla kurse cmimet e apartamenteve sa vijne dhe po rriten.

Nje tjeter kujtim qe kam nga koha e Enver Hoxhes eshte se mbas disa vitesh qe kishte ardhur ne pushtet ai filloi te prishi kishat dhe xhamiat. Me thene te drejten une nuk besoj ne Zot por vetem tek fati dhe tek zotesia qe ka njeri per te bere dicka, per te punuar dhe per te jetuar. Asgje nuk vjen nese nuk punon nuk mund te sigurosh jeten vetem me fjale apo te rrish te presesh me syte nga qielli. Per mua ato jane genjeshtra dhe nuk besoj fare ne keto gjera. Ndoshta une gabohem duke u shprehur keshtu por ky eshte mendimi im. Keshtu mund te qelloj qe per shembull ti rastesisht te gjesh nje kulete plot me leke ne rruge por qe kjo nuk te siguron nje jetese normale ne qofte se nuk punon. Pastaj njeriu them une kenaqesine me te madhe e gjen duke gezuar frutet e punes se vet se bashku me familjen dhe me shoqerine e tij.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II

Sa per kohen e lire kur punoja me pelqente ta kaloja ne shtepine me familjen time. Mbasditeve zakonisht merresha me kopshtin perpara shtepise si dhe me pelqente te lexoja libra sidomos libra qe tregojne historine e popullit tone. Kam lexuar te gjitha librat qe ka shkruajtur Enver Hoxha. Ndonjehere ndihmoja gruan ne ndonje pune te shtepise ose dilnim se bashku me femijet nga parku apo shkonim per vizite tek te afermit etj. Ndersa tani kohen e lire e kaloj ketu ne qenden Balashe se bashku me shoket e mi. Vije ketu rreth ores 9.30 – 10.00 me pelqen te marr pjese ne te gjitha aktivitetet qe zhvillohen nga operatoret sociale te qendres. Pervec shoqerizimit me shoket duke bere biseda te ndryshme, luajme me shah, domino apo tombola. Une kam dhe oren e fiskultures ku se bashku me disa shoke te tjere lozim me top apo bejme ushtrime te ndryshme gjimnastikore per te mbajtur trupin ne forme. Koha kalon shume shpejt kur e kalon me shoqerine tende dhe me njerez qe te duan dhe te respektojne. Pastaj mbas ngrenies se drekes me makinat e qendres kthehem ne shtepi ku pushoj dhe mbasdite me pelqen ta kaloj me familjen time duke dale me gruan time dhe me niperit dhe mbesat e mia nga parku. Me behet qejfi qe eshte krijuar nje qender e tille pasi keshtu ne mund te shtyjme kohen dhe te thyejme monotonine e perditshme.

Une kam tre femije dy djem dhe nje vajze. Asnje nga femijet e mi nuk ka emigruar jashte vendit, ata mundohen te sigurojne jetesen ketu edhe pse nje gje e tille eshte mjaft e veshtire. Qe tre jane te martuar me familjet e tyre. Faktikisht djali i vogel ka pasur shume deshire qe te shkonte jashte shtetit mirepo ishte gruaja ime ajo qe s'pranoi pasi kishte shume frike se mos i vrisnin djalin.





| *Intervistoi* | *Nadire Sinani* |
|---|---|
| Emri i te intervistuares: | **Shuade Aliu** |
| Datelindja: | Korrik te 1928 ( Kuç te Gumenices ne Cameri sot territor grek) |
| Emri i te atit: | Hysen Xhemo |
| Profesioni i' te atit: | Pa shkolle, fermer. |
| Emri i te emes: | Hatixhe Xhemo |
| Profesioni i te emes: | Shtepiake, pa shkolle. |

## ÇAMERIA .....JETA IME

Kam lindur ne korrik te 1928 ne Kuç, lokalitet i Gumenices (sot territor grek). Babai im quhej Hysen Xhemo, pa shkolle, punonte ne tokat e veta, kishte toka, ullinj dhe peme frutore.

Nena ime quhej Hatixhe Xhemo pa shkolle, shtepiake.

Nena ime pati 12 femije. Por disa i vdiqen te vegjel, 1 vjeç, 2 vjeç. Ne qe mbetem ishim vetem 3, une dhe dy vellezer. Njeri quhet Xhemali Xhemo ka pasur 8 klase shkolle vdiq ne moshen 21 vjecare ne spitalin e Tiranes.

Vellai tjeter quhet Mezan Hyseni (ka ndryshuar mbiemrin) ka pese klase shkolle. Ka punuar saldator.

### FATI .... PERCAKTOI JETEN E FAMILJES TIME

-Si kane qene maredheniet mes nenes e babait?

Midis nenes dhe babait nuk ka pasur marredhenie te mira. Kjo ndoshta per faktin sepse ata kane bere nje mekat. Sipas besimit tone mysliman nuk lejohet martesa ne lidhje gjaku dhe nena ime ka marre per burre kusheririn e saj, djalin e dajes. Ndoshta ky ka qene ndershkimi per familjen tone duke qene se kane vdekur shume femije e kemi pasur nje jete shume te veshtire.

Famlja ime ishte e besimit mysliman, besim te cilin une e ruaj edhe sot dhe i perkushtohem. Familja ime ne Cameri ishte ne nje

gjendje te mire. Kishim toka, ullishte, peme frutore. I gjithe fshati ishte mbushur plot ullinj e peme frutore ishte mjaft i bukur e shume pjellore. Shtepite ishin te mira. Ne fshat nuk kishim spital, ne raste semundjesh shkonim ne Korfuz ose ne Janine, shkonim nga deti dhe e kishim shume shume afer, shkonim me traget. Ne fshat kishte vetem nje shkolle 8 vjeçare greke nuk kishte kinema. Ne fshat flitej shqip dhe greqisht sepse aty kishte lagje me shqiptare e grek. Ne flisnim vetem shqip.

## FEMIJERIA IME NJE IDIL I BUKUR MES NATYRES SE VENDLINDJES TIME

**C'kujtoni nga femijeria juaj?**

Mbaj mend ambientin rreth shtepise. Kishim rreth e qark shtepise fiq, para shtepise kishim bajame, kumbulla ne nje cep prane shtepise kishim furren ku piqej buka. Poshte shtepise kalonte rruga dhe ne ane te saj ishte ullishtja me ullinj te cilet ishin shume pjellore. Pronat e jona ndodheshin siper rruges dhe rreze malit kishim nje shtepi te vjeter me shume peme perreth. Ne fund te rruges ndodhej fshati Pirgj ku banonin me shume greke. Ky ishte ambienti ku une rendja kur isha e vogel. Kisha tre shoqe por ishin me te medha se une, dhe une luaja shume me to. Une jam mesuar qe e vogel te punoj. Keshtu ndihmoja per te mbledhur ullinj, ndihmoja nenen ne shtepi, qendisja. Nga femijeria mbaj mend shume mire babain.

**Si ishte ai?**

Ai ishte shume i mire. Neve na donte shume por nuk na perkedhelte. Me kujtohet dicka shume interesante. Motra me e vogel se une Meleja ishte shume e dashur. Ajo nuk nuk ulej te hante po te mos ishte babai aty. Ishte shume e dashur. Por ne moshen 5- vjeçare u semur rende, ilaçe nuk kishte dhe keshtu qe vdiq. Njerezit thoshin se ajo vdiq ngaqe ishte shume e mire, nuk kishte si te jetonte nje njeri si ajo. Une u deshperova shume. Keshtu mbetem vetem une me dy vellezerit. Nena e perjetoi shume keq humbjen e motres time, rrinte tere diten duke qare edhe babai po ashtu por nuk e jepte veten.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



Babai ishte njeri punetor shikonte punen e tij por fqinjet nuk e donin se ai kishte pasuri e shikonte punen e tij. Ishte shume bujar. Me kujtohet nje fakt. Ne ullishten tone babai tre ullinj ia kishte falur xhamise. Prodhimin e tyre e merrte xhamia. Nje here tek mblidhja ullinj afer tyre dhe po mblidhja kokrrat e rena poshte. Babai me pa dhe me tha: Mos i mblidh ata ullinj se i perkasin xhamise dhe vetem ata duhet t'i mbledhin.

**Si kane qene marredheniet mes babait e nenes?**

Me thene te drejten nuk kane qene te mira. Ai shpesh e rrihte megjithese ishte e urte.

**Perse e bente ai kete?**

Nuk e di por besoj se eshte çeshtje mentaliteti. Ne pergjithesi ne ate kohe burrat ne fshatin tim i rrihnin grate nuk i vleresonin apo i respektonin, por i konsideronin si prona te tyre me te cilen mund te benin ç'te donin.

## NENA...GJEJA ME E EMBEL E JETES TIME

**Po nena si ishte?**

Ishte shume e mire. Ishte e gjate, e bukur, punonte shume. Me kujtohet qe ajo vishte çitjane dhe mbante shami ne koke e lidhte ne koke dhe mbulonte pjesen me te madhe te fytyres. Mbaj mend qe nena ime nuk dilte per vizite, nuk shkonte as ne dasma as ne vdekje sepse ajo ishte e semure dhe Hoxha i fshatit i kishte bere hajmali qe i mbante perhere me vete dhe i kishte thene se nuk duhej te shikonte as nuse as te vdekur. Besonin shume ne ate kohe dhe keshtu nena ime nuk dilte nga shtepia por rrinte ne shtepi, gatuante, lante, pastronte, qepte rroba, kujdesej per ne. Mbaj mend qe nena kishte shume pula dhe kujdesej per to. Keshtu nje dite komshia prane qe ishte nje e afert e babait ia helmoi pulat nga inati. Ne pergjithesi çamet nuk shkonin mire me njeri – tjetrin, kishin zili per njeri – tjetrin, por kishte dhe familje shume te mira siç ishte familja e fqinjit tjeter qe kishim prane.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

Nena ime gatuante shume mire. Mbaj mend qe babai therte shpesh qingja. I piqnim ne furre. Nena gatuante dhe gjelle tradicionale çame si: qumeshtor; byrek, gatuante perime. Cdo gje gatuhej me vaj ulliri madje dhe per drite perdornim kandil me vaj ulliri. Kishte me bollek vaj, sepse ullishtat prodhonin shume. Nena ishte shume bujare, kur kalonin grate e fshatit aty ajo i ftonte ne shtepi e i shtronte per te ngrene, ishte e dashur. Gatuante embelsira te ndryshme por qe ne nuk i hanim pasi ishim shume tekanjoze ne te ngrene.

**Po familja e nenes nga kush perbehej?**

Familja e nenes time ishte nga i njejti fshat. Ajo kishte 3 motra. Njera quhej Hajruk, ishte e martuar po aty ne fshat. Motra tjeter quhej Shashe ishte e martuar ne nje fshat prane nesh. Motra e trete quhej Hena dhe vdiq pasi u martua. Nena ime nuk kishte vellezer. I ati i saj quhej Muho Tajpi. Gjyshja quhej Zula. Ishin nje familje ne nivel mesatar, punonin ne pronat e veta.

**Si i kujton ti gjysherit?**

Ishin shume te mire, une shkoja atje me nenen por nuk qendroja shume pasi nena kishte pune ne shtepi dhe me merrte me vete nuk me linte tek gjysherit. Ata me donin shume mua, me jepnin gjera te mira per te ngrene e me perkedhelnin, ruaj nje kujtim shume te mire per ta dhe them se nuk mund te gjej kurre njerez si ata. Mbaj mend qe kur kthehesha ne shtepi me nenen ne rruge na dilte halla e nenes e cila i mbushte duart plot me embelsira.

## JETA JONE, FRUT I MENTALITETIT DHE I ZAKONEVE TE KOHES

Gjendja ne pergjithesi e njerezve ishte e mire, kishte toka, ullinj, peme frutore, vreshta me rrush. Por kishte dhe familje te varfera qe punonin si yzmeqar te familjeve te pasura. U punonim tokat, u mblidhnin ullinjte, rrushin etj. Marredheniet me popullsine greke nuk ishin te mira. Ata jetonin ne lagje te vecanta por qe ishin afer fshatit tone, nuk benim krushqi me ta vetem pak raste ka pasur kur vajzat çame jane martuar ne familje greke. Ne fshatin tim te gjithe banoret





ishin myslimane dhe ne fshat gjendej nje xhami ku faleshin banoret e fshatit.

**Cilat ishin zakonet e kohes, si beheshin dasmat?**

Ne ate kohe fejesat beheshin me mbleseri. Te rinjte nuk lejoheshin qe te njiheshin bashke, ne qofte se deshironte babai dhe njerezit e tjere te shtepise nena, vellezerit, xhaxhallaret atehere behej fejesa pa e pyetur fare vajzen. Dasmat organizoheshin bukur. Zakonisht beheshin per dite te enjte te djali dhe te merkuren te vajza. Babai i dhenderit organizonte dasmen, ftoheshin shume njerez dhe gatuheshin gjelle tradicionale te Çamerise si byreke, mish jani, bakllava, revani, qumeshtor me pete etj. Tek dhendri dasma zakonisht organizohej ne dreke dhe buka shtrohej neper sofra. Uleshin veç burrat dhe veç grate dhe femijet. Grate kercenin e kendonin kenge e valle te krahines. I kendonin babait te dhendrit, nuses e djalit. Dhendri nuk shkonte per te marre nusen por njerezit e tjere te shtepise e te fisit. Kur vinte nusja ne shtepi e shoqeronte i vellai me disa njerez te tjere. Nusja vinte me kale dhe e mbuluar me duvak e veshur me fustan te kuq te gjate prej cope kadifeje. Nga kali zbriste i vellai dhe njerezit e burrit i hidhnin oriz me leke. Pasi i zbriste nga kali e fuste brenda ne shtepi dhe e ulte ne vendin e caktuar per nusen, e zbulonte, e perqafonte dhe largohej me njerezit e tjere qe kishte me vete. Me pas nusen e takonin te gjithe njerezit e burrit dhe fillonin e kendonin kenge per te.

Pastaj nusen e fusnin ne dhomen e saj dhe me pas fusnin edhe dhendrin. Para se te hyje dhendri ne dhome tek dera e dhomes rreshtoheshin burrat e fisit dhe duke kaluar dhendri per te hyre ne dhome e qellojne me shuplaka. Pasi qendron pak ne dhome, e sheh nusen ai del nga dhoma me nje tepsi me bakllava dhe ua jep atyre qe rrine te dera per te ngrene embelsiren.

Pasi mbaronte ceremonia te nesermen njerezit e dhendrit shkonin per vizite ne shtepine e nuses. Ndersa nusja shkonte pas dy javesh ose nje muaji te shtepia e saj e shoqeruar me nje nga njerezit e burrit por jo me burrin e saj. Zakonisht nuset i dergonin rralle ne shtepite e tyre nje here ne tre muaj ose 6 muaj dhe ajo qendronte nje jave ose

dy; sa te thonin njerezit e burrit. Nusja merrte me vete embelsira e shkonte me kale, kur kthehej e shoqeronin njerezit e vet. Dhendri shkonte rralle ne shtepine e nuses vetem atehere kur e urdheronte i ati. Zakonisht dhendri shkonte ne shtepine e nuses vetem pasi kishin lindur femije.

**Po ne qofte se nuk pelqeheshin djali e vajza a ndaheshin?**

Nuk ka ndodhur asnjehere kjo, me sa mbaj mend une edhe kur burrit nuk i pelqente nusja ai do ta mbante patjeter pasi perndryshe ishte turp i madh.

**Po ceremonite mortore si organizoheshin?**

Zakonisht edhe ceremonite mortore i organizonin njerezit e shtepise. I vdekuri qendronte te grate te cilat e qanin me fjale. Burrat rrinin ne nje dhome tjeter dhe u shperndahej kafe. Pasi u behej varrimi njerezit ktheheshin e hanin dreken e pregatitur. Me kujtohet qe kur kam qene e vogel vdiq djali i tezes. Ai se bashku me vellane e tij ishte ne ushtrine greke 7 vjet. I mbante greku per lufte sepse ushtria ne fshat ishte 2 vjet. Pasi erdhi nga ushtria ishte koha qe ne do te na perzinin greket. Ai nje dite i kishte thene nenes se tij duke veshtruar nga malet: " nene ne qofte se do te na perzene nga shtepia mos arrifsha te kaloj malin" dhe vertete dy dite me pas ai vdiq pasi ankohej gjithmone se i dhimbte koka. Une vajta kur vdiq ai por nena ime jo, sepse ajo nuk duhej te shikonte as te vdekur e as te nuse sepse semurej. Mbaj mend qe tezja qante gjithmone per djemte e saj kur ishin ushtar. Ajo vinte nje here ne dy dite te shtepia jone dhe kur nuk vinte nena merakosej dhe me thoshte mua: dil ne dritare e shiko mos po vjen tezja. Une rrija me ore te tera duke pare nga rruga e kur shikoja qe vinte i dilja perpara. Ajo vinte e ngarkuar plot me ushqime. Mbaj mend qe fliste gjithmone per djemte e saj ushtar e qante sepse nuk dinte gje per ta se si ishin. Kur vdiq njeri djale ajo u deshperua shume dhe tre dite pas vdekjes se djalit qe quhej Feta ne u shperngulem per ne Shqiperi.

Nga femijeria mbaj mend dhe nje ngjarje tjeter. Nje here nje djale kerkoi nje vajze per nuse por prinderit nuk e dhane. Atehere djali e rrembeu vajzen ne shtepine e tij. Pas disa ditesh i vellai i vajzes

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



shkoi prane shtepise se djalit dhe u fsheh derisa nga shtepia te dilte rrembyesi i motres per ta vrare. Po erresohej dhe nuk shikohej mire, kur u hap dera e shtepise doli i vellai i rrembyesit dhe ai e vrau dhe me pas u largua erdhi ne Shqiperi nga frika e gjakmarrjes. Une kam qene e vogel por e kam pare vendin e vrasjes, nuk me hiqet nga mendja vendi me gjak.

**Cilat festa festonit ne fshat?**

Mbaj mend qe feste madhe behej per Bajram. Babai na blinte rroba te reja sepse keshtu ishte tradita dhe ne gezoheshim. Gatuheshin gjera te mira. Ishte nje nga ditet me te bukura. Ne femijet mblidheshim te gjithe dhe shkonim neper shtepi, atje na mbushnin duart me embelsira. Edhe njerezit benin vizita te njeri – tjetri per te uruar festen e Bajramit. Ne darken e Bajramit binte lodra dhe degjohej ne te gjithe fshatin, burri qe i binte shkonte te Kalaja qe ndodhej permbi fshatin tone dhe atje i binte fort.

## SHKOLLA NJE EKSPERIENCE E PA JETUAR

**Ç'kujtime ke nga shkolla?**

Ne moshen 7 – vjeçare babai me dergoi ne shkolle. Ajo ishte shkolle greke dhe mesuesit flisnin greqisht, une nuk kuptoja asgje. Shkova diten e pare dhe te dyten me rrahu mesuesja keshtu qe une u frikesova dhe nuk shkova me atje. Pra une jam pa asnje klase shkolle dhe babai detyrohej te paguante shkollen pasi une nuk shkoja. Rregulli ishte qe po te mos vazhdoje paguaje taksa si detyrim. Gjate kohes une punoja pune shtepie. Qendisja me fije, laja rrobat, enet e shtepise sepse nena ishte e semure.

## EGERSIA GREKE,SHKAKU I KALVARIT TE VUAJTJEVE TONA

**Cila ishte situata ne vitet 40?**

Ne ate periudhe ne vitin 39 – 40 ne fshatrat tone hyri italiani. Mbaj mend qe kaluan dhe ne fshatin tim dhe hyne neper shtepira,

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

kapnin pula, piqnin mish por nuk vrane askend. Me pas u larguan. Ne moshen 15 – vjecare ne vitin 1943 greket filluan ta debonin popullsine çame nga trojet e veta. Keshtu u hapen fjale se ushtria greke po digjte fshatrat greke dhe vriste njerezit.

**Si shpjegohet kjo urrejtje e grekeve ndaj popullsise çame?**

Ne fakt gjate gjithe kohes se bashkejeteses greke – çame ka pasur konflikte. Asnjera pale nuk e donte palen tjeter, kishin nje hasmeri te lindur per njeri – tjetrin. Keshtu filloi fushata e perndjekjes se çameve nga trojet e tyre. Edhe fshati yne vendosi te largohej per ne Shqiperi. Ka qene viti 1943 dhe une kam qene 15 vjeçe kur u nisem. Ka qene dite e premte ne fund te muajit korrik. Ishim une, nena, babai dhe dy vellezerit 20 dhe 9 vjeç dhe nje vella tjeter i vogel i sapolindur, 3 muajsh. Morem me vete dy dhi per te mjelur qumeshtin per te ushqyer vellain e vogel. Mbaj mend qe te gjithe njerezit qanin dhe vajtonin per ate dite te zeze. Morem disa gjera te domosdoshme me vete dhe u nisem per rruge. Me vete morem dhe rrobat e mia te pregatitura per paje. Pasi ecem disa ore pame qe me vete nuk kishim miell per buke keshtu u detyrua vellai i madh te kthehej ne shtepi dhe mori miell. Kur erdhi na tregoi per fshatin. Atje nuk kishte asnjeri dhe nuk e harroj kur tha se tek shtepia i kishte dale perpara qeni i shtepise. Ai ishte shume i bukur dhe ne e donim te gjithe, vellai i kishte dhene diçka per e ngrene e kishte ikur se kishte frike mos e kapnin greket sepse ato ishin duke ardhur. Me pas morem vesh qe fshatit i kishin vene zjarrin dhe shtepia jone ishte djegur midis shtepive te tjera.

**Çfare pate gjate rruges per ne Shqiperi?**

Pasi ecem disa dite mberritem ne Filat. Atje u futem ne nje shtepi, ishte si han dhe ndenjem disa dite, me pas shkuam ne shtepine e nje jevgu. Por ai na u lut te iknim duke na thene: Nuk ju shoh dot kur t'ju vrase greku. Ju lutem largohuni. Sapo dolem ne nga dera e shtepise vdiq vellai i vogel 3 muajsh.mbaj mend qe nena qante shume, filluam dhe ne te qanim. Babai mori nje lopate dhe hapi nje varr te vogel ku varrosem foshnjen. Ishte diçka tragjike. Nuk kam per ta harruar ate moment. Nuk mjaftonte qe ne ishim te derrmuar, te





pikelluar nga gjithe ajo qe po ndodhte, por duhej qe te perjetonim edhe kete fatkeqesi te madhe. Menjehere pastaj u larguam nga frika e grekeve qe po afroheshin dhe sapo u larguam ne greket erdhen, keshtu jo shume kohe me pas degjuam te shtena armesh. Morem rrugen per ne Konispol. Kaluam nje lume shume te madh. Kishte shume familje çame bashke me ne, madje mbaj mend diçka shume te tmerrshme. Nje grua e lodhur e rraskapitur per tu liruar nga ngarkesa qe kishte pasi mbante ne duar edhe foshnjen e vogel edhe trasten me rroba, donte te hidhte boçen me rroba ne ujepor ne vend te saj hodhi foshnjen ne lume. Ne ajer u degjuan klithmat e foshnjes e me pas te nenes e cila gjysme e pergjumur e kuptoi se çfare kishte bere. Ishte nje nate puse e erret e cila mori me vete edhe klithmat e foshnjes e te nenes. Te gjithe u tronditem. Me pas arritem ne Qafe te Botes dhe kaluam kufirin ne Konispol. Nga Konispoli u nisem per ne Delvine. Brenda ne Konispol behej lufte e madhe, luftohej nga te gjitha anet. Morem vesh se ne fshat kishin ardhur gjermanet dhe behej nje lufte shume paleshe dhe nuk merrej vesh se ç'behej. Luftonin gjermanet, iltalianet e mbetur, greket, partizanet shqiptare, ballistet. Ishte nje zallamahi e vertete. Ne nga mali shikonim flaket qe ngriheshin nga zjarret e shperthimit te bombave. Morem rrugen per ne Delvine ku ndenjem atje 6 muaj. Qendruam neper hane, kishte shume pisllek dhe parazite. Nuk kishim ç'te hanim, mblidhnim barishte per te ngrne dhe i zienim. Dua te tregoj diçka te pazakonte qe kam pare. Kur shkonim me vajzat e tjera ne fshatrat perreth Delvines per te kerkuar buke, kemi pare italiane anes rruges qe vdisnin nga uria. Ishin te shumte, te shtrire anes rruges e renkonin nga uria.

## MBIJETESA JONE I DEDIKOHET MIKPRITJES SHQIPTARE

**Si ju priten banoret e Delvines?**

Ne pergjithesi ishin njerez te mire por edhe ato ishin ne kohe krize. Megjithate na jepnin per te ngrene kur shkonim per te kerkuar. Duhet te theksoj se ne ate periudhe ne fshatin Finiq te Delvines vdiqen shume çam nga uria, nga semundjet dhe vendi mbante ere te vdekurish.

**Perse nuk i varrosnin?**

I varrosnin por ngaqe vdisnin shume, varret i hapnin te cekta jo te thella e keshtu vendi mbante ere. Pastaj nga Delvina erdhem ne Vlore. Pa mberritur ne Vlore ne na ndodhi nje tjeter fatkeqesi, vdiq nena ime ne Qafe Llogara. Kishim gati 8 dite qe ecnim ishim te rraskapitur. Mbaj mend qe vellai me i vogel thoshte dua buke, dua uje. Kur mberritem ne Qafe Llogara mua dhe vellane e vogel na zuri gjumi. Plaçkat i kishim ngarkuar ne mushkat e disa çopenjeve qe i kishte paguar babai. Ne mengjes kur na doli gjumi vellai i madh shkoi te gjeje uje me ibrik ne dore per vellane tjeter te vogel. Kur na doli gjumi une kerkova nenen. Ku eshte nena - thashe. E kemi derguar ne Tirane – thane. Atehere une e parandjeva te keqen e fillova duke qare me te madhe ne pyllin me pisha, se mos e gjeja nenen. Por nuk pashe askend. Qaja me te madhe dhe njerezit kur u ktheva u munduan te me qetesonin. Kishim 8 dite pa buke dhe ishim te derrmuar. U nisem per ne Vlore, pa hyre atje u ulem, ndezem nje zjarr dhe babai kishte mbledhur ne nje shami pak miell misri, e beme ate si qull dhe e hengrem. Me vone disa plaka qe ishin me ne rruges per ne Vlore me treguan se si vdiq nena dhe e kishin futur ne nje trashe, nuk i kishin hapur varr. Kishte vdekur ne duart e vellait te madh. Ne Vlore vajtem te gazermat e ushtrise dhe qendruan 3 muaj, pothuajse pa buke, ç'na jepnin ndonje gje te vogel ushtaret sa per te mbajtur shpirtin gjalle. Ne Vlore mbaj mend qe kur shkonim tek puset aty afer per uje, puset ishin te shterura e te mbushura me kocka njerezish. Ishte koha kur po çlirohej Shqiperia dhe erdhen e na moren me makina dhe na sollen ne Elbasan ne vendin ku sot ngrihet spitali. Spitali atehere nuk ishte ndertuar, flinim jashte ne bar e mblidhnim lakra per te ngrene. Me pas na derguan ne lagjen "Manazgja" atje qendruam gati nje jave jashte. Mbaj mend qe nje here nje burre kaloi atý dhe na tha pasi na shihte perdite – Perse rrini ketu? S'kemi ku te vemi - u pergjigj babai – dhe ai na solli te nesermen makarona per te ngrene. Me pas me merr nje grua nga Gjirokastra e na dergon ne nje barake prane shtepise se saj. E pastruam ate barakee u futem brenda. Ne kete kohe vellai i madh mori nje ftohje te rende dhe e derguan ne spitalin e Tiranes. Ishte 21 vjeç dhe nga te ndenjurit jashte u





semur.qendroi 5 muaj atje i shtruar dhe vdiq pasi ishte shume rende, e varrosi vete spitali, une nuk e pashe me me sy qe nga dita kur iku ne spital. U deshperova tej mase, babai vetem qante per te. Ky ishte fati yne.

Ne kete kohe ngaqe nuk kishim me se te jetonim une dhe nje vajze tjeter çame hyme si sherbetore ne shtepine e Bim Mirakut. Ata nuk na paguanin vetem na jepnin per te ngrene. Pasi vdiq vellai une nuk shkova me atje. Me pas qeveria na dergoi ne Rrase te Beleshit ku fshataret na furnizonin me buke. Qendruam pak kohe me atje dhe u kthyem perseri ne Elbasan tek ura e Bakallit. Atje erdhi nje kusheri i babait dhe ai synonte te martohej me mua qe te kthehej ne Greqi dhe te fitonte pasurite qe une trashegoja. Por une nuk e doja dhe vendosem qe te largoheshim prej aty dhe u vendosem ne nje dhome me qera tek lagja "Manazgja".

**Si eshte e mundur qe kusheriri te ushqeje ndjenja te tilla ndaj tjetrit me lidhje gjaku?**

Ne popullsine çame ka mjaft raste qe jane bere martesa midis njerezve me lidhje gjaku. Si psh mamaja dhe babai im kishin lidhje gjaku midis tyre.

**Ç'karakteristika kishin burrat çame?**

Ne pergjithesi ishin mjaft punetore, te zgjuar por ishin shume fanatike, grate i mbanin te mbyllura dhe nuk i trajtonin mire, i konceptonin si diçka per pune e per sherbim.

## MARTESA IME ... NJE DESHIRE E BABAIT TIM

**Si e njohe bashkeshortin tend?**

Ishte koha kur ne jetonim ne "Manazgja" isha 18 vjeçe. Ishte dite Bajrami dhe une kisha pjekur mish. Jetoja me babain dhe vellain e vetem. Vetem ne kishim mbetur nga shtepia jone. Kur erdhi dreka qe do te hanim buke vjen tek shtepia jone kusheriri me nje djale te cilin kishin pasur komshi atje ne Kuç te Çamerise. Une i thashe vellait te shtronte buken dhe vete u fsheha sepse e kisha inat kusheririn dhe

kisha frike se mos me merrte me zor. Kur u ngriten e iken ai doli ne oborr dhe hodhi disa leke qe t'i merrrja une por vellai i mori dhe ia dha perseri. Pastaj ai u largua nga Elbasani dhe shkoi ne Fier ku dhe u martua. Ate dite une pashe djalin e komshiut qe kishim pasur ne Kuç te Çamerise dhe me ate u martova. Ai djale kishte nje histori te veçante. Ne kohen kur ne u shperngulem nga shtepite tona dhe qendruam ne Filat, familja e ketij djalit ishte me ne, por djali u kishte humbur nga syte dhe nuk po e gjenin. Prinderit e tij vendosen te ktheheshin ne shtepine e tyre dhe si sot e mbaj mend kur nena e tij i tha babait tim.- Po ta le amanet ne qofte se shikon djalin tim rruges kujdesu per te. Keshtu babai vendosi te na martoje bashke duke plotesuar edhe amanetin e saj. Pra u larguam nga lagja "Manazgja" dhe shkuam ne shtepine e burrit tim ne lagjen "Gurabardh".

**A bete dasem?**

Jo. Ne nuk kishim para per buke e jo me per dasem. Babai punonte kudo ku gjente pune sa per te blere miser per buke. Nuk u bera as nuse dhe pajen qe kisha bere ne fshatin tim ma vodhen rruges gjate shperngulje.

**Te erdhi keq per te?**

Me erdhi shume keq sepse ishin gjera te bukura, te shtrenjta qe i kishte pregatitur nena ime per mua. Keshtu u martova pa asnje gje.

**Te pyeti babai kur te martoi?**

Jo. Nuk me pyeti fare. Ai sapo e njohu djalin e komshiut kur erdhi te ne per Bajram bashke me kusheririn tim mendoi per amanetin e nenes se tij. Keshtu vendosi per kete martese.

**A te pelqeu ty bashkeshorti?**

Burri im quhej Isa Aliu. Ishte simpatik, mesatar, me sy larushe. Ai ishte i veshur si ushtarak punonte ne ushtri. Me mua sillej mire, me donte dhe me bleu rroba te reja. Keshtu fillova te kem dashuri per te. Ne krye te vitit me lindi nje djale qe vdiq pas 3 ditesh. Me pas na derguan ne Kavaje sepse ndertohej kanali i Bedenit dhe duheshin punetore. Atje





na strehuan ne çadra dhe qendruam nje vit. Me pas erdhem perseri ne Elbasan ku me lindi nje djale qe e quajta Fatmir. Jetonim ne kushte shume te veshtira. Ishte viti 1950 kur linda djalin, jetonim ne nje dhome te vjeter ne lagjen "Shenkoll". Jetoja me frike se mos binte tavani i dhomes e me vriste djalin. Komshijte aty prane me dhane nje djep per femijen dhe me sillninin here pas here ndonje gje per te ngrene pasi ishim shume te varfer. Babai e vellai i vetem qe me mbeti Mezani, shkuan ne Fier per te gjetur pune. Dhoma qe kishim ne ishte shume e keqe dhe tymin nuk e nxirrte jashte kur ndiznim zjarr. U detyruam e shkuam ne nje shtepi tjeter. Tek ne erdhi edhe vellai me babane. Pune nuk kishte dhe babai shkonte ne fshatrat perreth te kerkonte buke, mblidhte dru per dimer. Vetem burri im punonte por rroga e tij nuk na dilte pasi ishim 5 veta ne shtepi, vellai ishte i vogel per te punuar rreth 12 vjeç. Edhe aty ku jetonim ishim shume ngushte ne nje dhome hanim, flinim te gjithe. Ne kete kohe me vdiq edhe babai. E perjetova shume keq sepse me mbeti vetem vellai, me vinte keq edhe per vellane se mbeti jetim.

Me pas shkuam ne nje shtepi tjeter atje na dhane nje dhome ajo ishte shume e keqe, e papaster, pa dritare dhe me nje dere te keqe. E pastruam, e rregulluam pak dhe futem koken. Atje me linden 3 femije te tjere por me vdiqen, nuk kishte mjekim, nuk kisha zjarr. Keshtu une kam lindur 12 femije, 9 me kane vdekur 3 i kam gjalle.

Zemra ime,nje zemer e vrare nga vdekjet e femijeve qe nuk ua di as varret.

**Perse vdiqen femijet e tu?**

Nuk kisha me se ti ushqeja, nuk kisha me se ti ngrohja. Edhe kur semureshin nuk kishte ilaçe.

**Sa vjeçe kane qene femijet qe kane vdekur?**

Nga 3 dite ne 10 vjeçe. Me kane vdekur nga 1 vjeç, 2 vjeç, vetem nje vajze me ka vdekur 10 vjeç, ajo u semur nga zemra.

**Si e ke perjetuar humbjen e femijeve?**

Sigurisht u hidherova shume si çdo nene. Qaja e i bija kokes me grushta me dhembte shpirti. Por me e keqja ishte se nuk ua di as

varret. Femijet i varroste im shoq ashtu ishte zakoni dhe nuk me tregoi varret. I kam kerkuar me pas por nuk i kam gjetur.

**Si ishte gjendja ne ate periudhe?**

Ne pergjithesi njerezit ishin te varfer sidomos te ardhurit si ne. Nuk kishte pune ku te punoje. Kishte pak dyqane, kishte nje spital ne qytet dhe materniteti, kishte dhe disa shkolla.

**Si ishin marredheniet me bashkeshortin?**

Ne pergjithesi mire, por kemi vuajtur shume. E respektoja si bashkeshort e si babane e femijeve, por ne ato kushte qe kemi jetuar ne nuk behet fjale per dashuri, ne luftonim per buken e gojes, nuk ngopeshim me buke. Nuk kishte mes nesh perkedhelje apo fjale te ngrohta si sot, atehere behej fjale per te mbijetuar. Kohet e fundit burri im punonte si hamall derisa doli ne kemp pasi u semur. Ne kete kohe ne moshen 42 vjeçare ne vitin 1969 me lindi nje vajze Silvana me te cilen jetoj edhe sot. Ne kohen kur doli ne pension burri filloi te pinte shume dhe nisi te me rrihte. Femijet i donte i keshillonte gjithmone dhe nuk i rrihte. Ai vdiq ne nje dasem ne Vlore. Martonte nje kusheririn e tij ne Vlore dhe duke kercyer i ra infrakt ne zemer dhe vdiq. Te nesermen ne mengjes e sollen ne Elbasan dhe e varrosem.

**Si e perjetove vdekjen e burrit?**

Me erdhi e papritur vdekja e tij, nuk e prisja dhe kjo me tronditi me shume. Me erdhi shume keq per burrin sepse kishim kaluar shume vite bashke, kishim hequr shume halle edhe pse kohet e fundit ai filloi te pinte e ndonjehere me rrihte. Mbeta vetem me vajzen e djemte. Djali i madh ishte i martuar dhe djali i vogel ishte i fejuar, kishim prere diten e dasmes. Jetonim te gjithe ne ne shtepi. Pas dy javesh qe vdiq burri morem nusen e djalit te vogel por pa orkester.

**Ç'ishte puna per ty?**

Me thene te drejten nuk kam punuar kurre, pasi pune per gra mezi gjeje dhe une i linda femijet shume shpesh. Keshtu kam qendruar





gjate gjithe kohes ne shtepi. Vetem kur me lindi vajza e vogel Silvana punova 1 vit ne konservim.

**A kishe shoqe atje, si i kishe marredheniet me to?**

Kisha shume shoqe, shkoja mire me te gjitha. Punonim shume e paguheshim pak. Mbaj mend qe pergjegjesi yne na bertiste megjithese ne punonim e realizonim normen. Puna ishte shume e veshtire, laja gjithe diten kavanozat per konservat, me ngrinin duart dhe kembet dhe me çaheshin gishterinjte nga uji. Kur kthehesha ne shtepi e lodhur gjeja femijet ne rruge nuk kishte kush te kujdesej per ta.

**Po bashkeshorti juaj nuk kujdesej?**

Eh burrat si burrat. Thoshte qe kujdesem une por nuk e bente se edhe ai lodhej tere diten duke punuar. Ishin vitet 76 – 77, jetonim ne varferi, e kishim marre nje shtepi te vjeter ku jetonte dhe nje familje tjeter dhe kishim nga dy dhoma secila.

## MIKET E MIA I VETMI NGUSHELLIM PER MUA

**A ke pasur ndonje mike ne jeten tende?**

Disa kohe kam punuar si yzmeqare ne dy shtepi. Njeren e kisha shume prane shtepise time. E zonja e shtepise me donte shume quhej Rukie. Une atje laja rrobat, enet, piqja kafen. Ajo u be shoqe per mua se me mbante afer, me jepte ushqime dhe per femijet. Edhe ne nje shtepi tjeter qe kam punuar u lidha shume me Shyqyrien te zonjen e shtepise, ajo me thoshte mos ik po rri ketu me mua. Me ka ardhur shume keq kur vdiq Shyqyria sepse ishte bere si moter per mua. Une atje mbeshtetesha e qaja hallet qe kisha. Ajo kurre nuk hante buke pa mua. Kam punuar edhe neper shtepi te tjera por keto dy gra i kujtoj si miket e mia me te mira.

## NUK ARRIJ TI KUPTOJ TE RINJTE E SOTEM

**Si e gjykon ndryshimin qe ndodhi?**

Ndryshimi per mua eshte me i mire. Gjendja e njerezve ishte

permiresuar, marrin pensione, ka plot gjera te ngopet syri. Shtepite jane rregulluar, me duket me mire. Por edhe kjo ka te keqiat e veta. Eshte prishur qetesia e rregulli qe kishim ne periudhen e diktatures, edhe sjellja e njerezve ka ndryshuar, me dukeshin me te edukuar me pare.

**Po rinine e sotme si e sheh, a te pelqen sjellja e saj?**

Jo. Ka qene me mire me pare, me duken te terbuar keta te rinjte e sotem, çunat ngjajne si goca e gocat si çuna, me duken te çuditshem. Nuk kane rregullin dhe sjelljen e te rinjve kohe me pare.

## TE SHOH EDHE NJE HERE ÇAMERINE PA LE TE VDES.

**Si e shikon vdekjen?**

E pres si diçka qe nje dite do te ndodhe, jemi mysafir ne kete bote. Nuk kam frike nga vdekja. I vetmi pishman i madh i jetes time ishte qe nuk vajta edhe nje here ne Çameri te shoh vendin tim ku kam lindur e jam rritur. Kjo ka qene edhe deshira e burrit tim.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II



| | |
|---|---|
| Intervistoi | Nadire Sinani |
| Emri i te intervistuarit: | **Shyqyri Shehu** |
| Vendlindja: | me 9 mars 1930 ne Peqin |
| Emri i te atit: | Musa Shehu |
| Profesioni i te atit: | Hoxhe |
| Emri i te emes: | Hedije Kongoli |
| Profesioni i te emes: | Shtepiake |

## KAM KUPTUAR QE FAMILJA ESHTE E VETMJA GJE QE MERITON SAKRIFICEN

Babai im ka lindur ne 10 maj 1885 dhe ka vdekur ne 6 nentor 1960. Eshte rritur jetim dhe xhaxhallaret e tij e kane derguar ne Turqi ku ka perfunduar "Medresene" (shkolle qe pregatit hoxhallaret e besimit mysliman). U kthye ne Shqiperi ne 1911 kur shkolla Normale hapi nje kurs per mesues, keshtu ai beri nje kurs prej 4 muajsh dhe mori nje diplome si mesues. E ushtroi kete profesion deri me 1947 kur doli ne pension.

Nena ime ka lindur me 22 tetor 1897 dhe ka vdekur me 26.12.1980. Rridhte nga nje familje e mesme e Elbasanit, nga nje familje patriotike dhe qe e donte arsimimin. Nena ime nuk kishte asnje klase shkolle, ishte shtepiake. Kam pasur 4 motra dhe 4 vellezer. Keshtu ishim nje familje e madhe prej 9 femijesh. Motra ime e madhe quhej Emine dhe nuk kishte asnje klase shkolle ishte shtepiake. Motra tjeter Sofia ka bere 4 vjet shkolle, pastaj ndoqi nje kurs per infermiere, profesion te cilin e ushtroi deri sa doli ne pension. Vellai im Hyseni beri 8 klase shkolle me pas kreu te mesmen dhe u be mesues muzike,u mesonte nxenesve instrumentin e violines. Vellai tjeter Ndricimi pasi mbaroi shkollen 7 vjecare doli partizan. Eshte vrare ne lufte dhe sot eshte deshmor i atdheut.

Motra ime Vjollca pasi mbaroi shkollen 8 vjecare kreu te mesmen dhe ushtroi profesionin e infermieres.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II

Motra tjeter Burbuqe mbaroi shkollen 8 vjecare me pas kreu shkollen e mesme per tu bere infermiere ne maternitet me pas studioi ne Bullgari per mjekesi duke u bere keshtu mjeke gjinekologe, profesion te cilin e ushtroi deri sa doli ne pension. Vellai tjeter qe quhej Bardhyl pasi mbaroi shkollen 8 vjecare dhe te mesme shkoi te studionte ne Bashkimin Sovjetik per inxhinier ujrash dhe u be nje ekspert ne hidrocentrale. Vellai tjeter Pellumbi pasi mbaroi shkollen e mesme studioi per stomatologji dhe u be dentist.

**Si ishin marredheniet midis nenes dhe babait dhe antareve te tjere te familjes?**

Maredheniet midis nenes dhe babait tim kane qene shume te mira, respektonin njeri – tjetrin. Babai im e donte shume nenen time, e vleresonte, e keshillonte sepse ai ishte shume me I madh ne moshe dhe I shkolluar. Ne familje morem nje edukim shume te mire, se si ti duam jo vetem prinderit tane por te donim dhe te resprektonim njeri – tjetrin.

Ne baze te ketij edukimi cdo gje shkonte mire ne shtepi, nuk kishim zenka apo kontradita te medha midis nesh. Babai im ishte shume autoritar ne familje dhe I degjohej shume fjala. Besimi I familjes time ishte mysliman. Gjendja ekonomike ishte e nje niveli mesatar.

## FEMIJERIA IME ISHTE NJE STRHEZ E QETE KU UNE PREHESHA ME KENAQESI DUKE E KUJTUAR ATE HERE PAS HERE

Kam lindur ne 9 mars 1930 ne Peqin por familja ime jetonte ne Elbasan. Kjo sepse babai ishte mesues dhe nga 1930 deri me 1939 kur erdhi Italia fashiste, familja ime ka jetuar ndonjehere ne fshatra, dhe here te tjera ne qytet. Ne periudhen e shkolles ndiqte babain tim kudo qe ai transferohej me pune. Keshtu kur linda une ai ishte mesues ne fshatin Gjuzaj te Peqinit dhe per kete arsye une kam lindur atje. Nga femijeria me kujtohen gjerat me te bukura, keshtu me kujtohet qe per festen e Bajramit (feste fetare) babai na blinte rroba te reja dhe me ato kalonim gjithe vitin deri ne festen e ardhshme te Bajramit. Ne ate kohe ishte tradite qe per Bajram na blinin rroba te reja.





**Si e kujton figuren e babait tend, si ishte ai?**

Babai im ishte figura kryesore e familjes. Ai ishte I qete, I rregullt, familjar dhe me autoritet. Na donte shume por nuk na perkedhelte kurre. Me mamane time kishte marredhenie te mira e donte shume madje prej dashurise ndonjehere behej dhe xheloz sepse mamaja ishte shume e bukur. Thone se kur eshte martuar mamaja ime njerezit kane dale te gjithe ne dritare per te pare bukurine e saj. Babai im megjithese ishte mesues nuk na deturonte te mesonim por kerkonte te na bente te ndergjegjshem per rendesine qe kishte te studjuarit dhe te gjithe ne duhet te jepnim me te miren per veten tone. Gjyshi im nga babai ka qene sheh mysliman domethene nje figure fetare e bektashizmit dhe te gjithe ne e therrisnim babe shehu. Kur ai vdiq I la prinderve te mi si amanet te kujdeseshin per teqen. Ajo ndodhej perballe shtepise dhe nena ime shkonte shpesh per ta pastruar. Ndersa babai merrej me kopshtin qe ndodhej perreth teqes. Mbillte zarzavate sidomos gjate periudhes se veres kur nuk punonte si mesues. Une nuk e kam njohur gjyshin por babai me ka treguar se ishte nje njeri shume besimtar dhe predikonte fene bektashiane. Ai bente "ziger"( keshtu quheshin veprimet te tilla si: vrima ne hunde ne dore, ne veshe). Njerezit mblidheshin dhe e shikonin. Ishte dicka qe nuk mund ta bente cdo njeri. Pasi vdiq gjyshi babai im u kujdes per teqen. Ai nuk bente ato qe bente gjyshi por ushtroi profesionin e hoxhes. Lexonte kuranin sepse kishte studiuar ne Turqi per kete por e bente dhe per dicka tjeter: per te fshehur faktin se u mesonte femijve gjuhen shqipe, sepse turqit (gjate pushtimit te Shqiperise nga Turqia) denonin ata qe mesonin gjuhen shqipe.

**Cfare kujton nga tregimet e babait tend per periudhen e monarkise? Si ishte e organizuar shkolla?**

Para periudhes se monarkise, babai me tregonte qe nxenesit mblidhesin vullnetarisht pra kush deshironte te mesonte vinte vete dhe nuk eksistonte nje organizim I mire per kete gje. Mesuesit zakonisht shkonin ne shtepine e ndonje fshatari qe kishte nje gjendje me te mire ekonomike dhe aty mblidheshin nxenesit qe donin te mesonin. Mesuesi paguhej nga vete prinderit e femijeve. Keshtu me

1909 familja qe mbante ne shtepi babain tim e furnizonte ate me ushqime keshtu qe buka dhe ushqimi nuk mungonte ne shtepine tone. Ne kohen e mbretit Zog mesuesit paguheshin nga shteti, paga merrej cdo tre apo kater muaj. Babai im me ka treguar nje histori interesante gjate jetes se tij si mesues. Ne kohen e pushtimit turk e kishin kapur me nje liber te gjuhes shqipe dhe e kishin arrestuar. Babai u tha atyre se ishte nje hoxhe mysliman dhe duke perfituar nga shkolla qe kishte bere ne Turqi shpetoi nga burgu. Babai me ka treguar dhe per figuren e Haxhi Qamilit, per qendrimin qe kishte ai ndaj mesuesve. Sipas babait Haxhi Qamili I persekutonte mesuesit qe u mesonin gjuhen shqipe nxenesve.

Ai mbante anen e pushtuesit turk pra ndryshe nga ç'mendohej ne periudhen e diktatures ku ai u vendos ne piedestal si hero dhe si udheheqes I kryengritjeve fshatare. Shpallja e tij si hero eshte pasoje e idologjise komuniste qe kerkonte ti evidentonte fshataret si iniciues te protestave dhe per kete shkak moren figuren e udheheqesit Haxhi Qamili duke thene se ishte patriot dhe duke I atribuar keshtu merita te tjera dhe duke e quajtur hero. Protestat e tij kane qene ne vitet 1910 - 1912 kunder regjimit turk. Inisiativat e tij per te treguar se ishte pro shqiptareve ishin per te justifikuar faktin se nuk ishte pro turk. Haxhi Qamil ishte nje njeri pa shkolle dhe ka pasur nje sekretar te quajtur Sul Zalla, I cili ishte nga Shijaku dhe I formulonte aktet zyrtare.Ky njeri qe ishte me I besuari I tij influencoi me pas me dhenien e informacioneve te favorshme duke e bere figuren e Haxhi Qamilit figuren e nje heroi.

**Cfare ishte per ty nena jote, si e kujton ?**

Qe nga femijeria ime do te mbetet e paharruar figura e nenes sime.Ajo ishte e gatshme per te bere gjithcka per ne.Ajo u martua qe 15 vjece dhe per kete arsye i rriten moshen duke e bere 17 vjec sepse nen kete moshe nuk ishte e lejuar martesa.Babai duhej te ishte rreth 30 vjec.Nena ime ishte shtepiake dhe duhej te merrej me punet e shtepise,pastronte, gatuante, lante dhe si tani me kujtohet qe gatimi I saj ishte shume i mire dhe i paster.Artin e guzhines ia la pastaj gruas time. Nena na perkedhelte gjithmone dhe nuk bente diferencime. Ajo





kishte nje dashuri te madhe jo vetem per ne por edhe per motrat dhe vellezerit e saj.Kishte 3 vellezer dhe 2 motra te cilet vinin nga nje familje artizane.

Dua te tregoj nje fakt shume interesant qe prezanton nenen time si nje grua me nje zemer te madhe.Nje nga vellezerit e saj nuk kishte femije dhe i kishte kerkuar nenes time qe ajo ti jepte nje,Nena kishte tentuar qe ti jepte nje nga vellezerit e mi me te medhenj por nuk mundi dhe ne fund beri nje djale qe e quajti Frederik dhe ia dha edhe pse vazhdoi te kujdesej per te. Kur Frederiku u rrit nena na tha te mos I thonim gje qe ai ishte vellai yne sepse ajo mendonte se duke I thene keshtu ai do te largohej nga prinderit qe e kishin adoptuar.Ajo donte qe ai ta njihte dajen sikur te ishte babai I tij I vertete sepse I vinte keq per vellane. Kur Frederiku vinte ne shtepine tone ai e therriste mamane, halle dhe ne fakt mamase I vinte keq per kete fakt por ajo ishte e bindur se nuk do te tregonte asgje.Vellai I nenes sime u vra nga gjermanet dhe vdiq, keshtu qe Frederiku mbeti vetem me gruan e xhaxhait tim qe e donte shume dhe qe kujdesej per te sikur te ishte tamam femija I saj. Frederiku e mesoi te verteten kur u rrit. Nena i tregoi te gjitha por ai nuk u zemerua sepse ne shkonim shume mire me te dhe ai kishte gjetur tek nusja e dajes tim nje nene te vertete. Qe nga ai moment ai u lidh me shume me ne .

Babai i nenes sime ishte berber kurse e ema ishte shtepiake.Vellai I saj I madh kishte mbaruar shkollen e mesme .Ishte tregtar.Vellai tjeter ishte mesues ne shkollen e mesme.Vellai I trete Xhaferri ishte diplomuar jashte shtetit per mjeksi.Nje vella tjeter u diplomua si violinist ne Itali. Familja e nenes sime ishte nje familje qe donte dijen por kishte edhe nje ndjenje te madhe patriotike duke marre pjese te gjithe kunder pushtuesit.Dy prej vellezerve te saj rane ne lufte si heronj dhe ky qe ishte violinist doli partizan , pas lufte ai punoi si mesues muzike.Sot spitali I Elbasanit mban emrin e dajes tim Xhaferr Kongoli I cili pasi ka punuar si mjek ne Berat e transferuan ne Elbasan ku eshte bashkuar me partizane te tjere .Ai eshte zgjedhur komandant I keshillit nacional clirimtar per rajonin e Elbasanit.U vra prapa kraheve ne 1943 nga ballistet.Njihej me pseudonimin "Doktori I kuq". Ballistet I kishin ngritur nje kurth duke I thene se

dikush ishte i semure dhe ai shkoi pas tyre keshtu e arrestuan dhe e futen ne burg.Asnjehere nuk u mor vesh fati I tij por gjithmone kane thene qe eshte vrare.Kjo eshte nje histori e shkurter se si eshte vrare daja im qe sot eshte nderi I Elbasani dhe une jam krenar per kete .

Familja e nenes sime ishte e preferuara e jone : Gjyshja na priste shume mire,shkonim tek ajo me rradhe dhe ajo gatuante gjera shume te mira vecanerisht kur shkonim ne.Gjyshja na donte dhe na perkedhelte shume.Jetonte me njerin nga djemte e saj.Gjyshin nuk e kam njohuur.

**Si ishte jeta ne periudhen e femijerise tende?**

Familja ime ekonomikisht ka qene mire dhe kjo nga tradita qe kishte krijuar babai im ne mbledhjen e ushqimeve, jetonim mire .megjithate jeta ne pergjithesi nuk ka qene e mire.Nuk ekzistonte nje kulture ne te veshur psh.kishim kepuce dhe nuk I mbanim , rrinim kembezbathur dhe I vishnim vetem per festa ose kur shkonim per vizite ose ne shkolle. Ne shoqerine time ishin vetem djemte e lagjes time dhe me kujtohet qe luanim ne fushen e futbollit me top kurse gjate veres shkonim per te bere banje ne lumin Shkumbin dhe merrnim me vete buke .Elbasani ne ate kohe ishte nje qytet I vogel me rreth 13.000 (mije) Banore . Ne qender te Elbasanit rreth viteve 1937-1939 kujtoj qe ishte markata e grurit ,atje kishte ndretesa te vogla tip barakash ku punonin njerez . Shitej gruri ,kishte gjithsashtu leshpunues ,dyqane kafeje : pijet alkolike nuk perdoreshin shume ne ate kohe. Shtepite tona ishin te vjetra te ndertuara me tulla prej balte. Shume njerez mereshin me punime artizanale p.sh kishte nga ata qe punonin lesh,samarepunues, corapepunues, bakerxhinj kurse persa I perket doktoreve ishin te pakte psh daja im dhe pak te tjere.Kishte edhe infermiere.

Njerezit nuk ishin ambicioze te pasurise e te luksit.Benin nje jete te qete mjaftonte te sigurinonin buken e perditshme.Femijet nuk luteshin te hanin sic ndodh sot qe prinderit u shkojne nga pas me pjate ne dore.Me kujtohet sesi nena ime gatuante gjelle tradicionale Elbasanase dhe kur vinte ora per te ngrene ,uleshim te gjithe prane sofres (tavoline e rrumbullaket me kembe te shkurtra ku njerezit uleshin ne toke me jastike)Shtepia ime ku jam rritur kishte dy dhoma te





shtruara me balte,siper dyshemese shtronim rrogoza prej kashte,dhe mbi to vendosnim postiqe delesh.Na duhej qe nje dhome ta perdornim si dhome ngrenie e per te pritur njerezit dhe ne tjetren te flinim te gjithe tok.Mbaj mend qe babai kujdesej shume per nenen sidomos kur ajo ishte shtatzene.Ne ate kohe ne qytet kishte dhe kisha dhe xhami ,maredheniet midis te krishtereve dhe myslimaneve ishin te mira por nuk benin lidhje martesore midis tyre,ishin raste te rralla kur ndodhte kjo.Ne ate kohe kishte 5 shkolla elementare ne qytet dhe pasi mbaroje shkollen elementare vazhdoje nje shkolle tjeter 4 vjecare.Ekzistonte vetem nje shkolle e quajtur shkolla "qytetare". Pastaj disa nxenes vazhdonin shkollen e mesme Normale qe u hap ne Elbasan per here te pare ne 1909( Ishte shkolla e pare ne te gjithe Shqiperine per formimin e mesuesve ) Kjo situate zgjati deri ne vitin 1939 .Pas clirimit u happen shkollat 8 vjecare dhe e para qe ajo qe u hap ne vitin 1946.

Ne periudhen e femijerise time ne pergjithesi jeta ishte e varfer. Ne raste vdekje shpenzimet e ceremonise I benin te afermit e familjes.Grate qendronin pothuajse te gjitha ne shtepi, visheshin me citjane ( veshje egjere siper tek beli dhe e ngushte ne kavilje).Ngjyrat e tyre ishin te ndryshme sipas moshes n.q.se ishe e vjeter apo e re dhe vetem ne kohen e pushtimit italian fillun te vishen me veshje normale.Grate kur martoheshin mbanin "duvak" ne koke ( shami e kuqe e gjate deri ne gjoks , ekstremisht e rregulluar bukur, e dekoruar me fije dhe rruaza) Dasmat beheshin ne shtepi te kryefamiljarit dhe ishin festa te medha duke ftuar shume persona , te njohur te familjes, te aferm.komshinjete e shtepise dhe miq. Ne ate kohe, familjet ishin te medhaja dhe akoma nuk kishte lindur ideja qe djali qe martohej te shkonte e te jetonte ne nje shtepi tjeter, por te gjithe djemte e martuar qendronin ne te njejten shtepi.Vetem pas clirimit njerezit filluan te jetonin vetem. Nusja merrej me kale, me koke te mbuluar me duvak. Ne vitin 1942, filluan qe te perdornin makinat dhe karrocat e zbukuruara . Ceremonia martesore ishte shume e bukur. Nusen e priste vjehrra para portes dhe te afermit e tjere te burrit. Sapo vinte nusja I hidhnin oriz te perzier me leke mbi koke per te treguar mireqenie. Pastaj nusja me dy gishta te lyer me mjalte lyente pjesen e siperme te deres e cila do te thoshte se nusja do te ishte e embel si

mjalti me personat e shtepise. Gjate fejeses, te fejuarit nuk e takonin njeri – tjetrin por prinderit shkonin dhe benin vizita tek njeri – tjetri. Ne diten e dasmes, burri e priste nusen ne shtepi, nuk shkonte ta merrte. Orkestrantet ishin cigane qe kendonin, kishin klarineta dhe daulle dhe dy gra te tyre qe kercenin nen ritmet e muzikes. Nusja dhe dhendri takoheshin per here te pare ne diten e dasmes, kur dhendri shkonte tek dhoma e nuses. Te gjithe burrat vendoseshin ne rradhe perpara portes dhe para se te hynte dhendri brenda, e gjuanin me dore me shaka. Meshkujt martoheshin te medhenj dhe diferenca midis burrit dhe gruas ishte shume e madhe. Nese vajzat kalonin te njezetat quheshin "te mbetura ne shtepi". Gezimi I femijeve ne dasma ishte kur vinte nusja dhe kur hidhnin oriz, para dhe karamele. Vraponim te gjithe per te marre sa me shume karamele ose para. Ne pergjithesi, femijeria ka qene e qete. Maredheniet ndermjet motrave dhe vellezerve kane qene te mira. Babai im nuk na linte te ziheshim, na blinte te gjitheve veshje te reja dhe ne nuk shikonim se kush e kishte me te bukur, mjaftonte qe te ishin te reja.

Grindjet tona ishin feminore. Mund te them se kam pasur nje femijeri te qete pa shume veshtiresi. E kujtoj si dicka te bukur dhe per te cilen kam shume nostalgji.

## SHKOLLA IME ISHTE FILLIMI I REALIZIMIT TE ENDRRAVE TE MIA

Shkollen e fillova ne vitin 1937. Me kujtohet shume mire qe nena me beri nje cante prej cope stofi si te gjithe femijet e tjere per te mbajtur librat. Shkolla Ime kishte vetem 2 dhoma,kurse klasat e tjera ishin ne nje ndertese aty afer. Ndertesa e shkolles ishte e re dhe mesuesit ishin burre e grua. Klasa kishte 20 –25 femije. Femrat ishin te pakta. Shkolla ishte e frekuentuar me teper nga femije familjet e te cileve e kuptonin rendesine e saj.

Marredhniet midis shokeve ishin te mira po ashtu dhe midis shoqeve, e respektonim njeri – tjetrin edhe kur u rritem dhe gjate moshes 15- 16 vjec luanim perseri bashke.





Cfare benit gjate kohes se lire? Me kujtohen shume mire lojrat e asaj kohe. Ne nuk kishim lodra sic kane femijet e sotem. Ne luanim me lojra te tjera qe sot quhen "popullore" si per shembull: kala dibrance ( ishte nje loje e perbere nga dy skuadra prej 5 personash secila, ku njera rrinte e perkulur me koke poshte te kapur tek beli I njeri – tjetrit kurse skuadra tjeter duhet tu hidhej siper ne kurriz dhe ne qofte se njeri prej tyre binte atehere skuadra humbte dhe zinte vendin e tjetres) , luanim futboll me top prej lecke, edhe vajzat luanin me ne por jo te gjitha. Vajzat ishin te mbyllura.

Vajzat qe shkonin ne shkolle dilnin pa shami te zeze ndersa te tjerat qe mbaronin 4 klase shkolle dhe nuk vazhdonin me tej duhet te mbanin kete shami dhe quheshin "vajza te mbuluara". Perse quheshin keshtu? Keto vajza mbylleshin ne shtepi nga prinderit dhe nuk mund te dilnin pa lejen e tyre dhe kur dilnin duhet te mbanin shamine e zeze. Ne moshen 15 vjec, vajza qe nuk shkonte ne shkolle mbulonte fytyren dhe nuk dilte jashte per te lozur. Ato mblidheshin ne shtepite e njera – tjetres dhe qendisnin. Ne ate kohe kishte nje shkolle ne nje kishe katolike ku murgeshat jepnin mesime per te qendisur dhe per te qepur.

Ne ate kohe fejesat beheshin nepermjet mblesit. Te fejuarit ndoshta nuk njiheshin por nese familja e vajzes ishte dakort fejesa behej, por ne disa familje te emancipuara kerkonin mendimin e vajzes. Te rinjte mundoheshin te takoheshin fshehur kur kishin mundesi. Vajzat nuk kishin kurajon te thonin nese e donin apo jo ate djale. Ishin shume te nenshtruara. Ne lidhje me kete gje dua t'ju tregoj nje ngjarje e cila eshte shume interesante. Me kujtohet qe vajzat ne shkollen e mesme Normale (per mesues), per te mos terhequr vemendjen e djemve ne gjoks vendosnin nje fasho, te cilen e lidhnin forte mbrapa, per te mos iu dukur gjoksi. Donin te mbulonin te gjitha format femerore. Per kete dua t'ju tregoj nje gje per te qeshur. Nj e vajze, duke qeshur me shoket e klases, qeshi kaq shume sa iu keput fashoja dhe keshtu qe I erdhi shume turp. Edhe motra ime kur shkonte ne shkolle qepi nje fustan qe I rrinte shume mire pas trupit dhe qe I dukeshin te gjitha format femerore te trupit por nuk mundi kurre ta vishte.

**Si jeni ndjere ne shkolle?**

Humba ne kujtime .... fillova shkollen ne 1937. Babai im na kishte folur shpesh per vleren e shkolles dhe une ndjehesha shume mire, isha I lumtur qe shkoja ne shkolle. Nuk kishim kushte te mjaftueshme per te mesuar. Kishim nje dhome ku rrinim te gjithe se bashku. Per drite perdornim kandilin me vajgur. Mesonim me shume veshtiresi shkruanim te ulur per toke sepse nuk kishim tavoline.

**Po babai juaj ju ndihmonte?**

Babai im ishte mesues por nuk na ndihmonte ne mesime. Ishim pese vellezer qe shkonim ne shkolle dhe ai kujdesej per ne, ne ishim kaq te pergjegjshem dhe e kuptonim vleren e shkolles sepse babai yne na fliste shpesh per kete.

Gjate vitit te pare dhe te dyte te shkolles fillore nuk kishim lapsa e fletore dhe shkruanim ne nje derrase te vogel te cilen e merrnim cdo dite ne shtepi.

**Si ishin mesuesit?**

Mesuesit ishin shume te serte dhe na qellonin me vizore kur ne nuk ishim pergatitur, kishim frike nga mesuesit. Kur mesuesi kalonte perpara nesh, ne te gjithe ngriheshim ne kembe per te treguar respekt por ne te vertete ata punonin shume me ne.Shume here kemi ndenjur ne klase edhe pasi mesimi kishte mbaruar.per kete fakt dua tju tregoj nje ngjarje per te qeshur .Me kujtohet qe nje mesues pasi mbaroi ora e mesimit doli nga klasa pa mbaruar shpjegimin e mesimit te ri. Nje dite, kur kishte mbaruar ora beri si gjithmone nderpreu mesimin dhe doli e iku. Pasi doli ai ne bertitem: Kapeni! Kapeni! Ai na degjoi dhe u kthye duke thene: Kush foli? Ne nuk I dhame pergjigje dhe ai iku

.

**Çfare aktivitetesh benit ne shkolle?**

Se pari ne shkolle festonim diten e flamurit (28 Nentorin).Me kujtohet qe nje here ,me ngarkuan per te ngritur flamurin mbi nje shtylle sepse te gjithe e dinin qe une isha I zoti per tu kacavjerre pemeve dhe te gjithe me therrisnin " çita i vogel",( majmuni I Tarzanit ) une u kacavirra deri ne shtylle, vendosa litarin ne nje rrote per ta





bere te rrotullueshem litarin.Ndersa isha lart mesuesit ishin poshte me nje mbulese qe te me mbanin ne qofte se bija.Ate dite ne u vendosem dy e nga dy dhe u be ceremonia e ngritjes se flamurit. Ne fund te cdo viti shkollor, mesuesit bashke me nxenesit benin fotografi me njeri tjetrin dhe mernim deftesat. Me kujtohet se ajo dite kur une merja deftesen time ishte dita me e lumtur dhe me te ne dore vrapova drejt shtepise sime pa fryme per ti treguar prinderve te mi deftesen.

Nje tjeter gje e bukur nga femijeria ime ishte edhe festimi I dites se pranveres. Cfare do te thoshte kjo feste? Kjo feste festohej me teper ne Elbasan.Eshte epiqendra e kesaj feste.Kjo dite do te thoshte qe dimri mbaroi dhe bashke me te edhe I ftohti dhe gjera te tjera te keqia ( ketu mendohej qe dimri ishte lidhur me vuajtjet). Keshtu vinte pranvera e ngrohte,e bukur, e mbushur me shendet e bollek.Per kete dite gatuheshin gjera karakteristike psh ballakume, revani, veze, pilaf, arra dhe fiq te thate.Ne ate kohe ishte tradite qe ne familjet qe kishte çifte te sapomartuar, ate dite feste shkonte tek ta nje djale I cili mbante ne dore nje pjate ku ishin vendosur keto ushqime dhe shkonte shpejt ne mengjes para se te vinin njeres te tjere me qellimin qe nusja te lindte femije mashkull.

**Si festohej kjo dite ?**

Ishte mjaft bukur kjo dite.Te gjithe njerezit, femije, te rinj, te aferm shkonin ne pik-nik duke marre me vete ushqime.Merrnin mish gjel deti, bollokume, revani, arra dhe pilafin e gatuanin atje.Njerezit vendoseshin prane kodrave me ullinj dhe ndiznin zjarre te medhenj. Grate gatuanin orizin ,pinin edhe kafe , kurse femijet dhe te rinjte luanin lojera tradicionale ose kendonin kenge qe i dedikoheshin natyres ose dashurise

**Perse gatuheshin ballakumet ate dite ?**

Ballakumet gatuheshin per dite vere sepse meqenese njerezit benin pik-nik ate dite, ishte nje embelsire e thate , pa sherbet e keshtu transportohej lehte, pa u bere pis. Ka dhe nje arsye tjeter : Meqenese festa e 14 marsit eshte festa e pranveres, eshte periudha e ndryshimit te stineve dhe trupi ka nevoje per embelsi, keshtu gatuhen ballakumet

qe njihen si embelsira tradicionale e qytetit te Elbasanit dhe jane kthyer ne simbol te dites se pranveres. Elbasani eshte quajtur qyteti I dites se veres ose qyteti i ballakumeve.

**Ne shtepine tuaj gatuheshin keto embelsira?**

Natyrisht qe po. E thashe edhe me pare qe nena ime gatuante shume mire edhe ballakumet I bente shume te mira dhe familja ime festonte bashke me qytetare te tjere.

**Kishit pasion per shkollen?**

Te them te drejten deshiroja me teper qe te luaja por, babi im ,insistonte kaq shume per rendesine e shkolles dhe qe une duhet te vazhdoja sepse ishte dicka qe une duhej ta beja Keshtu, pasi kisha mbaruar shkollen fillore prej 4 vjetesh, ne ate kohe u hap shkolla 7 vjecare, une hyra ne klasen e peste dhe mbarova shkollen .Pasi hyra ne shkollen normale ne vitin 1947 shkolla qe pergatiste mesuesit e ardhshem , mbarova 2 vjet te shkolles normale por, per arsye ekonomike e lashe shkollen dhe fillova te punoj si mesues dhe dy vjetet e tjera I vazhdova me sistemin e kooerespondences pa shkeputje nga puna.

## RINIA IME, NJE RINI QE ADAPTOHEJ ME REALITETIN

**Cfare kujtoni nga jeta ne shkollen 7 vjecare dhe pastaj nga Normalja?**

Dua te kujtoj qe mosha jone pershtatej shume shpejt ne realitetin e asaj kohe dhe atehere ishte koha kur ndertoheshin hekurudhat.Kur mbarova klasen e shtate, gjate periudhes se veres shkova te punoj vullnetarisht ne ndertimin e rruges Durres – Tirane. Kur isha ne Normale mora pjese ne ndertimin e rruges Durres- Peqin dhe kur u bera mesues mora pjese ne ndertimin e rruges Elbasan-Prrenjas.Me kujtohet qe ne ate kohe disa prej nxenesve qe nuk e kalonin vitin,nuk lejoheshin te merrnin pjese ne keto aksione.sepse duhet te studionin per te kaluar provimet qe beheshin ne shtator.

Por kishte ndermjet tyre ndonje qe nuk tregonte qe kishte mbetur ne klase dhe vinte me ne si vullnetar :keshtu nje here erdhen dy





shoket e mi por duke pare deshiren qe ato kishin per te marre pjese. i mbajtem dhe nuk i lame te iknin.Per punen e mire qe benim merrnim si stimul, nje steme ne shenje mirenjohje.Stemat ishin te bera me material plastik ne forme "S" – je me ngjyre te kuqe.Ishte nje moment gezimi kur mernim kete stimul mirenjohjeje ne sy te shokeve.

**Si ishte e organizuar jeta ne aksionet e rinise?**

Ne mengjes te gjithe benim gjimnastike,shkonim ne pune dhe ne mbremje organizonim mbremje vallzimi . Te rinjte kendonin e kercenin kenga e valle tradicionale.Kush nuk dinte te kercente, mesonte nga te tjeret. Ne keto aksione, te rinjte zinin miqesi ndermjet tyre, kishte edhe nga ato qe pelqenin njeri-tjetrin.

**Keni patur simpati per ndonje vajze?**

Ne fakt une isha ne nje moshe te vogel per te patur lidhje me ndonje vajze dhe ne qofte se kisha simpati per ndonje isha tip I ndrojtur.

**Si e keni kaluar pushtimin fashist?**

Pushtimi I Shqiperise nga Italia ndodhi ne 7 prill te viti 1939 kur une isha ne klasen e dyte.

**Si e kujton ate dite?**

Ate dite une me shoket e mi shkova ne fushen sportive per te pare aeroplanet qe mbulonin qiellin. Ne ishim femije dhe nuk e kuptonim se cfare ishte pushtimi. Kishim degjuar nga te rriturit qe bisedonin te shqetesuar per pushtimin fashist, por nuk mundnim ta perceptonim. Nje dite me pas, ne mbremjen e tete prillit nga dritarja e shtepise time pashe rrugen e Qafe-Krrabes qe ishte e mbuluar me autoblinda me ushtare qe u vendosen ne Elbasan dhe shume prej tyre zaptuan fushen tone te sportit. Kur shkuam nje dite me pas per te luajtur me shoket fusha ishte e zene nga fashistet dhe me kujtohet qe ne ate moment u ndjeva shume keq. Ne nuk kishim me vend se ku te loznim. Per here te pare ne mendjen tone femijenore I dhame pergjigje pyetjes se cdo te thote pushtim. Fusha jone ishte pushtuar

por edhe te tjerat paten te njejtin fat . Pushtimi kishte nje hije te zeze. Fusha nuk u lirua me dhe ne luanim ne rrugicat e lagjes.Ne ate kohe degjoja motren time me te madhe dhe vellane tim qe diskutonin me babane te shqetesuar. Nje dite e pyeta babane se si do te zgjidhej problemi yne pasi ne nuk kishim me fushe ku te luanim. Ai me pa me dhembshuri dhe me tha: Pushtimi eshte I keq biri im, te shkretet ne.

**Si reaguan njerezit menjehere pas pushtimit?**

Me kujtohet qe nxenesit e shkolles normale pak dite para pushtimit bene protesta dhe kerkuan arme per te pritur pushtuesin me arme ne dore. Ndersa pas pushtimit ata filluan aktivitetin guerrilas ne grupe te vogla,grisnin flamuret e fashizmit, shperndanin trakte etj.

**Po ju femijet si reaguat?**

Edhe ne dhame kontributin tone si femije. Keshtu ne mitingjet e organizuara nga fashistet per te treguar vlerat e tyre ne ishim prezent, dhe kur ata bertisnin: Duce, Duce; ne therrisnim ne te kunderten : Cedu, Cedu, duke turbulluar mitingun. Pastaj iknim me vrap te ndjekur nga fashistet qe therrisnin: Maskarenj, maskarenj. Keto ishin aksione spontane qe benim ne femijet pasi aktiviteti yne me vone u be I organizuar.Keshtu ne 1942 u ngriten "Grupet edukative" neper lagje me nxenesit e shkollave. Ne keto grupe benin pjese femijet me te besuar. Qellimi I ketyre grupeve ishte te shikonte dhe te jepte informacione mbi opinionet e njeresve dhe te mesuesve nese ata ishin kunder ose ne favor te fashizmit.Pasi mernin Informacionin , pergjegjesit e grupeve qe ishin me te rritur informonin udheheqesit mbi pozicionin e mesuesve dhe te njeresve te tjere. Keto ishin format e para te organizimit ne luften kunder fashizmit.

**Keni pasur ndonje anetar tjeter te familjes te lidhur me levizjen per clirim ?**

Po , dy nga vellezerit e mi , ishin lidhur me levizjen , madje njeri prej tyre ishte pergjegjes I njerit prej grupeve edukative.





**Si organizoheshin keto te rinj ne levizjen kunder fashizmit?**

Pasi u lirua fusha sportive sepse ne femijet insistuam shume per lirimin e saj, filluam te organizonim ne sheshin sportiv ndeshje futbolli midis te rinjve te lagjeve te ndryshme.Ky moment u shfrytezua per te terhequr te rinjte me aktive dhe per te bere propagande kunder fashizmit. U krijua Rinia Antifashiste ne 1942.dhe njeri nga vellezerit e mi u be anetari I saj.

**"BIJTE E BABAI, JU QE JENI TE RINJ , DUHET TE JENI NE BALLE TE LUFTES".**

**Si reaguan prinderit e tu ndaj perfshirjes ne Levizjen Antifashiste?**

Babai im dha menjehere aprovimine tij kurse nena ime jo . Kishte frike per femijet. Por babai Im e bindi duke I thene se rinia duhet te ishte ne balle te luftes per clirimin e shqiperise. Keshtu shtepia jone dale-ngadale u be baze e luftes antifashiste. Vellai im ne ate kohe ishte 16 vjec. Ishte ne perfundim te vitit te katert

**Si shihej kjo qe po ndodhte ne shtepine tende me syte e nje 12 vjecari?**

Duhet te theksoj qe te rriturit vepronin me ilegalitet te plote.Dua te tregoj nje fakt interesant.Te dy vellezerit e mi ishin pjesetare te grupit antifashist por, asnje nuk e dinte se ne cfare grupi benin pjese.Keshtu nje nate kur njeri nga ata shkoi ne nje mbledhje te grupit te tij , atje gjeti vellain tjeter dhe keshtu mbeten te habitur te dy.Pra benin pjese ne nje grup dhe asnje nuk e dinte, sepse aksionet organizoheshin ne grupe prej 4-5 personash. Qe nga ajo dite ato filluan te bashkepunojne dhe filluan te dalin hapur perpara nesh dhe prinderve tane.Cdo nate mblidheshin te gjithe ne dhomen kryesore vellai hapte Harten e botes dhe fliste per levizjen dhe progresin e Ushtrise se Kuqe te Bashkimit Sovjetik.Ishte nje nxenes I normales dhe ishte shume I informuar per ngjarjet e reja ne frontin e luftes kunder fashizmit.

**Kishit frike? Si I gjykonit veprimet e vellezerve tuaj?**

Veprimet e vellezerve te mi I gjykoja shume te drejta dhe nuk kisha frike. Ne qofte se mua do te me jepej mundesia do te kisha vepruar njelloj si ato por isha akoma nje femije, kisha mbetur I vogli I grupit edukativ dhe kerkonin qe ti vija ne ndihme ne momente kur kishin nevoje per sherbime te vogla.Do te me pelqente qe te flisja me teper per njerin nga keto vellezer , per Ndricimin .Si te gjithe vellezerit e motrat e tjere kemi patur raporte shume te mira, jemi dashur·shume por Ndricimi vdiq shume shpejt.

**Si ndodhi?**

Ai mori pjese ne manifestimin e bukes qe bene disa prej nxenesve. Atje tregoi nje kurajo te madhe duke dale ne krye te manifestimit, keshtu fashistet e pane dhe ai u detyrua te aktivizohej ne shperndarjen e komunikatave. Ai u lidh me drejtuesit kryesore te levizjes si psh me Tomorr Sinanin, Kozma Nasken etj.Traktet duhej ti shperndanin edhe ne vendet ku ishin italianet dhe jo vetem neper rruget e lagjeve.Dua te tregoj nje aksion ku demonstroi nje kurajo te madhe Kishte marre si detyre qe te shperndante traktet tek Grand hotel qe sot eshte turizmi I vjeter.Ne kete hotel qendronin drejtuesit me te medhenj te pushtuesit.Keshtu ai u nis per te bere detyren e tij me komunikata nen sqetull. Pas tij vinte Kozma Naska (hero I popullit ne lufte kunder pushtuesit) sepse me te vegjelit duheshin shoqeruar nga te rriturit dhe ne rast rreziku duhet ti mbronin ato. Keshtu Kozmai mbeti ne nje cep dhe vellai im hyri ne Grand Hotel.dhe pa atje qe te gjithe oficeret italiane po luanin bilardo.Hyri shpejt duke I lene traktet para syve te tyre.Menjehere iku me vrap duke vrapuar dhe vuri ne koke nje kapele per te humbur gjurmet.Shkoi ne ate vend ku ishte fshehur Kozmai dhe ai e pergezoi per kurajon e madhe qe kishte treguar.

Vellai im ishte shume I shkathet dhe babai e keshillonte duke I thene : Kujdes biri im, Ruhu.Kishte edhe raste te tjera kur ai ka treguar guxim ne aksione te tilla. Keshtu edhe nje here tjeter kur ai duhej te shperndante traktet ne nje lagje, mori nje shporte .I vuri traktet ne fund dhe I mbuloi me portokalla qe do ti shperndante. E ndaluan 4





ushtare italiane duke I thene: ku po shkon ? Cfare ke ne kosh ? Nena ime eshte e semure dhe une po shesh portokalle per te blere ilace per te, iu pergjigj ai. Njeri nga ato futi duart ne kosh dhe e kontrolloi por nuk pa asgje. Atehere vellai im I dha 2 portokalla dhe ata u larguan.keshtu ia hodhi edhe nje here por tashme kishte rene ne sy te fashisteve. Vellai im ishte I pari qe kishte lexuar komunikaten e atehershme te Partise Komuniste se bashku me disa shoke te tjere ne shtepine tone. Ai foli me babane dhe ai ia dha lejen qe edhe shoket e tij te vinin ne shtepi per te lexuar komunikaten.

Qe nga ky moment shtepia jone ishte nje strehe qe favorizonte levizjen per liri.Ne kete komunikate behej thirrje qe te rinjte te ngriheshin ne lufte kunder fashizmit. Kur mbaruan se lexuari kete komunikate babai im tha ne dialekt:" Bijte e babait, ju qe jeni te rinj, duhet ti dilni me balle hapur luftes. Keshtu shtepia jone u be nje baze e mbledhjeve dhe per grumbullimin e armeve per partizanet.Shoket e vellait, Ndricimit, thonin gjithmone qe babai im dinte se cfare bente kurse baballaret e tyre, jo. Kjo donte te thoshte qe babai e mbeshteste gjithcka qe benin bijte e tij. Ne 1943 u be nje miting nga Normalistet me rastin e dites se veres. Ne kete miting ftuan edhe te rinjte qe do te dilnin partizane dhe keshtu ne 1 maj, 100 Normaliste u bene partizane.

Ne qershor ne nje mbledhje nga Partia Komuniste e organizuar nga Bardhul Popa u diskutua akoma problemi I te rinjve qe do te beheshin partizane .Ndricimi kishte deshiren per tu bere partizane bashke me 4 shoket e tij.U kthye ne shtepi per te me pershendetur dhe me kujtohet babai im qe qante dhe qe e perqafonte fort dhe I tha qe te kishte kujdes. Dhe keshtu ne fillim te korrikut ai doli partizan. Une vazhdova te jem pjesetar I grupit edukativ qe nga viti 1942 e mori emrin " Debatik"( Organizata e pionereve qe ndihmonin partizanet).

Keshtu dhashe ndihmen per shperndarjen e komunikatave qe vinin nga Partia komuniste Shqiptare. Ndersa Ndricimi ishte partizan, une mbaja lidhje me miqte e tij dhe merrja informacione per te.Pasi ai ishte zgjedhur delegat ne nje mbledhje te rinise komuniste qe u mbajt ne Funar erdhi ne shtepi dhe kjo ishte hera e pare dhe e fundit

qe e pame. Ai shkoi ne Funar dhe iu ngarkua si detyre per te marre 500 ushtare italiane qe ishin rob lufte dhe qe gjendeshin ne Labinot e duhej qe ti conin ne Dumre ku gjendej batalioni partizan. Ndricimi bente pjese ne kete batalion dhe kishte me vete 4 shoke te tjere ndermjet tyre edhe nje grua qe quhej Liri Hakani. Ishte e veshtire per ti transportuar keto ushtare sepse gjermanet kishin ardhur .Ato e moren kete detyre dhe e realizuan me sukses.

Meqenese gjermanet erdhen, partizanet donin te dinin nese kishin hyne ne Belesh apo jo dhe per kete ngarkuan Ndricimin me nje shok tjeter. Gjate rruges ndaluan ne nje fshat qe quhet Shales ,ndenjten atje ate nate por kur e zonja e shtepise e mori vesh qe Ndricimi ishte djali I mikut te saj te shtepise, I tha qe nuk duuhet te shkonte ne Belesh sepse atje ishin gjermanet, por kjo ishte nje detyre qe Ndricimi duhej qe ta conte deri ne fund .Keshtu nje mengjes ai u nis bashke me shokun e tij qe quhej Sul Jella.Kur u afruan ne Belesh, nga nje koder pane qe gjermanet ishin vendosur prane liqenit. Edhe gjermanet I pane dhe filluan qe ti qellonin ne drejtim te tyre. Keshtu filloi beteja , ato ishin shume kurse keto ishin vetem 2.Ndersa largoheshin , shoku I tij mbeti I plagosur rende dhe I tha qe tia mbathte porai nuk pranoi dhe I tha qe nese duhej te vdisnin do te vdisnin te dy.Keshtu vdiqe te dy te perqafuar .Keshtu vdiq vellai im qe u be hero I popullit .

Gjate periudhes ne nuk dinim gje per Ndriucimin dhe fatin e tij .Une pyeta miqte por asnjeri nuk me tha asgje derisa nje dite babai im mori nje leter nga komandanti ku ai I thoshte se Ndricimi kishte vdekur dhe qe kishte rene duke mbrojtur partine.Ne fillim babai im nuk na tha gje por kur ne filluam te pyesim gjithmone per te, na tha te verteten . Nena ime filloi te qante por babai I tha qe duhej te ishte krenare per te sepse ai kishte dhene jeten per partine.Ne vazhdonim qe te kryenim aksione te vogla , me shoke te tjere deri sa erdhi dita e lirise.Keshtu me 11 nentor 1944 Elbasani u clirua nga armiqte gjermane.E kujtoj ate dite si dite me te lumtur te jetes sime .Dy dite me pare na kishin thene se gjermanet donin te minonin te gjithe qqytetin dhe familja ime iku e gjithe ne shtepine e gjyshes qe gjendej ne qender te qytetit ne nje lagje te vjeter por partizanet nuk ia dhane





mundesine gjermaneve qe ta minonin qytetin , keshtu hyne ne qytet me 11 nentor. Ka patur shume qytetare me gezim te madh e me lot ne sy.Ishte nje dite e vecante te shikoje njeres qe perqafoheshin, qe qanin nga gezimi,qeshnin, kendonin,e keshtu duhej te jete liria.E gjithe Shqiperia u clirua me 29 nentor 1944.

**PUNA, PASIONI ME I MADH I JETES TIME**

Pasi mbarova 2 vitet e para te shkolles Normale , ne 25 korrik1949 deri ne fund te shtatorit 1949, bera nje kurs per mesuesi ne shkollen fillestare te Shkodres dhe ne fillim te shtatorit fillova pune si mesues ne nje fshat te qytetit te Tropojes.Ishim 10 mesues te emeruar ne kete qytet nga Ministria e edukimit dhe une isha emeruar konkretisht ne ne nje fshat qe quhej Markaj ne lokalitetin e Kolgecajt.

**Si e pritet kete emerim ne kete fshat kaq te larget?**

Te beja mesuesin ishte pasioni im .Keshtu nuk me beri shume pershtypje por perkundrazi isha shume I kenaqur.Rruga per te shkuar ne Tropoje ishte shume e larget dhe e veshtire.Ishte nje aventure e vertete sepse duhej te nderroje shume mjete udhetimi per te shkuar atje. Keshtu nga Elbasani ne Peqin kemi udhetuar me tren .Durres –Tirane me makine , Tirane – Shkoder me makine, Shkoder - Kukes me makine dhe Kukes Tropoje e kemi bere per dy dite me kembe.

**Si ishte ambienti ne fshat? Si jetonin njerezit?**

Njerezit ne kete zone ishin shume miqesor, bujar. Burrat ishin me te emancipuar se grate. Ndejta ne shtepine e nje fshatari por ne pergjithesi fshati ishte shume I varfer. Dua te tregoj nje ngjarje per te treguar kete varferi. Per te flejtur, nuk kishin krevate por mbulonin token me fier (nje lloj bime) mbi te I vendosnim postiqe leshi (leure deleje e qinjgji) dhe aty flinin. Si jastek perdornin nje cope trung te rrumbullaket. Gjate dimrit, binte shume bore por une nuk mungoja kurre ne shkolle e cila ndodhej pak larg shtepise ku jetoja une. Nje here me kujtohet qe u semura nga verdheza dhe shkova ne spitalin e Tropojes. Me kujtohet qe spitali ishte pa dritare dhe mjeket me thane

qe duhet te shkoja ne Shkoder sepse isha shume rende. Por une nuk mund te shkoja sepse ndjehesha shume I dobet per te bere gjithe ate rruge ne kembe dhe keshtu mora disa ilaçe dhe u ktheva ne fshat. Atje nje fshatar me sheroi me nje menyre popullore. Me preu fijen e te verdhit ne brendesi te buzeve, te siperme dhe te poshtme dhe keshtu u sherova sepse dilte leng jeshil dhe haja pak nga ushqimi special mjalt dhe perzierje te frutave te ndryshme. Ne shkollen time ishim vetem dy mesues. Mesuesi tjeter vinte nga nje fshat tjeter I Tropojes. Natyra ishte shume e bukur me male te larta, te mbushura me peme dhe me lendina. Ajri ishte I fresket, plot shendet.

Gjate shkolles nuk vija ne shtepine time ne Elbasan, por isha ne kontakt me ata nepermjet letrave. Nxenesit ishin inteligjent dhe shume te interesuar per shkollen. Ne 20 shkurt te 1952 u propozova ne partine komuniste (e cila u quajt parti e punes pas clirimit te vendit) ne organizaten baze te qytetit te Tropojes. Ishte nje eveniment shume I pritur nga une qe kerkonte nje impenjim shume te madh. Pastaj shkova ne Tirane ku bera nje kurs tjeter per nje muaj dhe ne 1 shtator te 1953 Ministria e Arsimit me transferoi ne qytetin e Gramshit ne nje fshat qe quhej Terrove.

**Si e perjetove kete transferim?**

E thashe dhe me pare qe une kisha pasion per punen time dhe kudo qe shkoja une me kenaqesi punoja, por meqenese ishte afer shtepise, per mua ishte nje gje shume e mire. Pas tre muajsh me emeruan drejtor ne nje shkolle te nje fshati tjeter, Poroçan dhe pas nje viti, u emerova mesues ne shkollen fillore ne qytetin e Gramshit. Kam punuar shume me nxenesit dhe ne mars te 1953, u bera antar I Pleniumit te "Mbledhjes se Rinise se Punes Shqiptare" per qytetin e Gramshit. Ne 25 shtator te vitit 1953 u bera kryetari I komitetit profesional ne qytetin e Gramshit. Me 28 shtator u bera anetar I partise ne organizaten baze te partise ne Gramsh. Pasataj u mobilizova si ushtar ne ushtri sepse kisha bere vetem dy vjet shkollen e normalistit. Ushtria zgjati dy vjet e gjysem. Ne fillim donin qe une te vazhdoja shkollen per oficer dhe une duhet te vendosja nese doja





te ndryshoja profesion apo jo. Por une vendosa te mos e le profesionin tim te vertete sepse me pelqente shume dhe keshtu nuk shkova ne kete shkolle dhe bera ushtrine sipas kohes se caktuar ne Kavaje.

Pasi mbarova ushtrine me emeruan instruktor ne Komitetin e Partise ne qytetin e Elbasanit. Ky komitet I partise (I barabarte me bashkine e sotme) dhe pas nje viti shkova ne shkollen e partise e cila zgjati nje vit.Ne kete periudhe jet ime ndryshoi . U Fejova.

**TAKIMET E FSHEHTA MBANIN GJALLE DASHURINE TONE.**

**Si e keni njohur te fejuaren tende?**

Dua te them qe ne shkolle njoha dy vajza , njera vinte nga Peshkopia dhe tjetra nga Shijaku,por asnjera prej tyre nuk ishte e fejuara ime.Ishin me te medhaja se une, sepse gra qe frekuentonin ate shkolle kishin nje moshte me te madhe dhe ishin te pakta.Keshtu ne klasen time kishte vetem 6 femra Mikja ime qe quhej Hyjrije.mori me vete ne nje ekskursiomn te shkolles qe ne organizuam motren e saj te vogel qe quhej Teuta. U prezantova me te dhe me beri shume pershtypje sjellja e saj.

**Si ishte ajo?**

Ishte nje vajze shume e brishte dhe kur u prezantuam u be e kuqe ne fytyre dhe me kujtohet qe kishte dy gersheta dhe me beri pershtypje spontaniteti I saj.Eshte e embel dhe qeshte shume.Ato kishin nje vella qe ishte oficer dhe vinin shpesh ne Elbasan tek I vellai.Keshtu jam takuar edhe here te tjera me Teuten dhe prezantimi im me vellain e tyre krijoi nje lidhje.

**E kishit kuptuar qe kishit rene ne dashuri me te?**

Kisha shume simpati per Teuten , deshiroja qe ta shikoja me shpesh.Ajo kishte dicka te vecante qe me terhiqte, keshtu ne fund te shkolles vendosa qe te fejohem me te.Fola dhe me te vellain e saj dhe pas disa ditesh me dha pergjigje pozitive.

**Po te afermit e tu si u sollen?**

Kur ia thashe atyre kete nena nuk foli.Kurse babai im me tha :" nese te pelqen ty per ne nuk ka problem , je ti ai qe do te kalosh jeten me te."Keshtu u fejova dhe fejesa ime zgjati per rreth 2 vjet.Shkoja nje here ne muaj ne Shijak ne shtepine e Teutes dhe cdo jave I dergonim letra njeri –tjetrit.

**Cfare i shkruanit njeri- tjetrit?**

Flisnim per momentet qe kalonim se bashku. Ne ate kohe kishim turp te flisnim me fjale te tilla qe perdorin sot te dashuruarit si " te dua", " e dashur",etj. Keto ishin gjera qe kuptoheshin. Prane shtepise se Teutes, ishte nje kinema dhe shkonim bashke per te pare film sa here qe shkoja atje.Takimet tona te fshehta mbanin gjalle lidhjen tone.Gjenim momentin qe te rrinim vetem, te fshehur dhe letrat tona ishin te mbushura me ato momente qe kishim kaluar bashke.P.sh si tu duk ky vend ?Ishte pak ftohte .Binte shi por ne nuk donim te iknim,etj.

**Si ishte familja e Teutes?**

Babai I Teutes quhej Haxhi Dedja, ishte drejtor I postes kurse e ema quhej Sulltana dhe ishte shtepiake. Ishin tre vajza dhe kater djem. Te gjithe kishin mbaruar shkollen 8- vjecare por dy vellezer kishin mbaruar edhe te larten njeri per oficer kurse tjetri vazhdonte studimet ne Kine per Gjuhe-Letersi.U be sekretar ambasade.

**A kishe deshire qe te shkoje ne Shijak?**

Shkoja me shume deshire edhe pse me vinte turp. Rruga per te shuar atje ishte shume e veshtire sepse nuk kishte makina. Me trenin shkoja deri ne Sukth e pastaj ne kembe dhe per nje ore shkoja ne shtepine e Teutes dhe kur mendoja se do ta takoja rruga me dukej e shkurter. Me kujtohet nje here nderkohe qe ishim ne nje karroce duke u kthyer nga shtepia e saj, karroca u smontua dhe une isha gati per te rene. Teuta bertiti fort, mes nesh kishte lindur dashuria dhe respekti I ndersjellte per njeri – tjetrin.





**A ke menduar ndonjehere se do te ishte ndonje tjeter ne vend te saj?**

E kisha menduar disa here gjate fejeses, sepse ajo ishte me shkolle tetevjeçare, por ajo me sjelljen e saj meritoi gjithe dashurine time. Shpesh duke e pare ashtu te vogel, te dobet, me dukej si diçka e brishte, sikur te ishte vajza ime. E kam dashur shume, me dhembshuri keshtu erdhi dhe dita e marteses time dhe u martova me 14 gusht 1960.

**Si je ndiere gjate kesaj martese?**

Ishte diçka e gezueshme, e lumtur, beme nje cermoni te madhe. Teuta ishte bere shume e bukur kishte ndryshuar shume dhe te gjithe njerezit mbeten te habitur sepse ajo dukej shume me e bukur se me pare. Ajo u be edhe me e bukur gjate marteses sepse nga nje vajze e vogel dhe e brishte mori formen e nje grua te vertete. Lidhja jone u be me e forte. Ajo sillej mire me te gjithe pjestaret e familjes dhe kishte marredhenie te mira me nenen time por menjehere pas marteses ndodhi nje fatkqesi ne familjen tone. Vdiq babai im.

**Si ndodhi kjo?**

Babai im qe nga 1947 doli ne pension por ai kishte deshire te vazhdonte te punonte dhe keshtu I ngarkuan nje detyre qe te shiste cigare dhe pulla poste. Kete pune e bente me shume kenaqesi dhe thoshte gjithmone qe puna e mbante gjalle. Dyqani I tij I vogel ishte ne qender te qytetit. Kete profesion e beri deri ne fund te 1960 dhe per shkak te pleqerise e la.

**Si u ndje pasi e la punen?**

Me kujtohet shume mire ajo dite. Erdhi ne shtepi dhe ishte shume I trishtuar dhe me vete kishte nje karrige te vjeter ku ulej. Kujtimi I vetem I kaq viteve pune. E I tha nenes time "e dashur grua, kjo karrige me ka mbajtur gjalle, tani mos prisni asgje prej meje, ta dini qe une po vdes". Me thene te drejten brenda vitit ai vdiq. Ishte koha kur une sapo isha martuar dhe duke ndjekur zakonet tona, te afermit e nuses duhet te vinin tek ne per te na

vizituar. Babai im shkoi per te blere pak vaj ulliri dhe ndersa ai ecte, nje karroce e perplasi ne toke dhe keshtu ai vdiq aksidentalisht ne moshen 74 vjeç. Ishte diçka e pabesueshme per ne. E kemi perjetuar me shume dhimbje humbjen e tij.

**Si po ecte karriera juaj?**

Dua te kujtoj qe ne 1958 u bera korrespodent I gazetes "Zeri I popullit". Me 1960 u emrova drejtor ne I nje shkolle ne Gjinar ne komunen e Shpatit dhe me 1962 mora diplomen e shkolles pedagogjike dhe me 1 shtator u emerova drejtor I nje shkolle ne Labinot Mal. Ne prill te 1963, komiteti I partise me ngarkoi pergjegjesine per te marre pjese ne pleniumin e komitetit qendror te partise se punes se Shqiperise.

Me 1 shtator te vitit 1965 jam transferuar si drejtor I shkolles fillore ne Bishqem nje fshat I Elbasanit dhe pastaj jam transferuar ne fund te vitit 1972 si mesues ne shkollen e fshatit Shtepanje. Kur isha mesues ketu ne gazeten "Zeri I popullit" shkruajti per punen tone me nxenesit. Nga 1 shtatori 1972 deri me 31 gusht te vitit 1975 u emerova pegjegjes I konviktit I shkolles se ndertimit ne Elbasan.

Nga 1 shtatori 1975 deri me 5 prill 1985 u emrova mesues ne shkollen "Hamit Mullisi" ne Elbasan. Me 26 tetor 1982 presidiumi kuvendit popullor me dha nje medalje me titullin "Naim Frasheri" (figure shume e njohur, shkrimtar dhe njohes I Shqiperise). Me 4 janar te vitit 1984 komiteti qendor I partise se punes se Shqiperise, me dha nje medalje tjeter me titullin " 40 vjet ne partine e punes se Shqiperise". Me 6 mars te vitit 1985 Ministria e Arsimit dhe e Kultures me dhane titullin "Mesuesi I popullit" dhe me 6 prill 1985 dola ne pension. Kjo ishte karriera ime profesionale.

**Si ja bere me familjen tende kur gjendeshe larg Elbasanit?**

E merrja me vete kudo qe shkoja familje ime ishte me mua, keshtu kemi qene bashke per gjithe kohen. Ne shtepine tone nuk mungonte asgje sepse une ndiqja zakonet e babait tim qe kujdesej shume per femijet.





**Si e shikoje rregjimin e Enver Hoxhes?**

Kam pasur pershtypjen se çlirimi I vendit I dedikohej Enverit dhe gjithe popullit qe ka luftuar dhe keshtu Shqiperia po ecte perpara. Rruget e hekurta qe ndertoheshin, dritat qe shkuan ne zonat me te thella pak e nga pak gjithçka po permiresohej. Fabrikat qe ndertoheshin, njerezit kishin pune dhe une mendoja se regjimi I Enver Hoxhes ishte per popullin. Ekzistonte nje moto ne ate kohe qe asnje nuk duhej te ishte I papune, te gjithe punonin. Kishte disipline dhe une me familjen time ishim dakort me keto gjera. Ne ate regjim ne qofte se ti ishe njeri I edukuar, punetor, mund te ecje perpara.

Gjerat e keqia te ketij regjimi ishin mungesa per te dale jashte vendit si dhe lufta e klasave qe ishte shume e forte, dhe shpeshhere e padrejte sepse persekutonte jo vetem fajtorin por dhe familjen dhe te gjithe te afermit e ngushte. Vendi ishte I mbyllur kundrejt shteteve te tjera.

**Si e ke perjetuar mbylljen e besimeve fetare?**

Normalisht, edhe pse gjyshi im ishte nje figure fetare ne nuk e trasheguam kete besim dhe babai im na ka folur gjithmone qe ekziston nje fuqi e mbinatyrshme te ciles duhet ti besojme, por qe nuk ndjenim kaq te forte. Dhe keshtu per ne nuk pati asnje problem per mbylljen e besimeve fetare.

## PO VRAPOJME SHUME SHPEJT NE KETO KOHE TE REJA

**Si e perjetove ndryshimin?**

Me thene te verteten, shume gjera me duken te mira dhe shume te tjera jo. Per shembull me pelqen qe vendi yne tani eshte nje vend i hapur dhe nuk ekziston me lufta e klasave ( ne kuptimin e persekutimit te te afermeve qe ishin kunder regjimit), me pelqen ky zhvillim por jo ne kete menyre siç po ndodh ketu ne Shqiperi. Nuk me pelqen qe njerezit nuk kane pune, nuk me pelqejne fenomenet negative qe jane bere nje plage per shoqerin tone siç eshte prostitucioni, droga dhe gjera te tjera qe me pare nuk i njihnim.

**Si te duken te rinjte e sotem?**

Jane shume me te pregatitur se ne, por nuk me pelqen mmenyra se si sillen ata, sigurisht nuk flas per te gjithe, por ne pergjithesi. Me duket sikur e kane kuptuar pak si keq demokracine, me duket se po vrapojne shume shpejt.

**Po ti me çfare merresh gjate dites?**

Tani qe jam ne shtepi perpiqem te merrem me diçka e cila te me ndihmoje qe te mos qendroje palevizur. Merrem me kopshtin qe kam ne shtepi, me lulet, takohem me miqte, ndonjehere sistemoj dokumentat qe kam, librat dhe tani qe vij ne qendren sociale Balashe ndjehem me i organizuar. Sapo zgjohem ne mengjes me duket sikur jam ne kohen a kaluar kur shkoja ne pune dhe tani vij ketu ku mund te kaloj kohen e lire me miqte dhe kenaqem shume.

**Cfare mund te me thuash per familjen tende?**

Une kam tre femije, nje djale Eduart, dy vajza qe quhen Manjola e Monika. Dy vajzat jane te martuara dhe une mbeta me djalin tim te martuar qe ka dy femije dhe me gruan time. Kujdesem shume per niperit e mi jane shume te dashur, jane gezimi Im.

**A e ke dhene opinionin tend ne zgjedhjet e familjes tende?**

Po, une kam dhene gjithmone mendimin tim per shkollen qe duhej te benin, keshtu vajza me e madhe, pas shkolles se mesme nuk donte te shkonte ne universitet. Une e binda dhe tani me falenderon shume per kete qe kam bere sepse tani ajo ka nje pune te mire, keshtu kam bere dhe me djalin tim sepse kur ai ishte ne Tirane ne shkolle te mesme per gjuhe francese, ai ne vitet e para nuk shkonte mire ne shkolle dhe une fola me te dhe I binda se ishte e nevojshme, ai ndryshoi dhe filloi te merrte nota te mira dhe keshtu e vazhdoi dhe ai universitetin dhe me pas u be mesues I frengjishtes. Ne familjen time une dhe gruaja ime perpiqemi te japim gjithmone opinionin tone sepse mendoj qe femijet kane gjithmone nevoje per nje drejtim dhe ne zgjedhjen e gruas ose te burrit, une dhe gruaja ime kemi influencuar gjithmone ne keto zgjedhje duke kenaqur femijet tane.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II



Tani kam nje jete te qete edhe femijet e mi kane familjet e tyre, jane rregulluar mire dhe per kete ndjehem shume I kenaqur. Besoj se e kam bere mire detyren time si prinder.

**A ke femije te cilet jane emigrant?**

Po, kam pasur. Djali im ka qene ne Gjermani per 5 vjet. Ishin vitet e para te demokracise dhe te gjithe shqipetaret deshironin te iknin jashte shtetit, edhe djali im deshironte te ite me shoket e tij dhe me kerkonte shpesh lejen per tu nisur. Gruaja ime nuk donte sepse kishim degjuar per shume te tjere qe binin ne det ose shume gjera te tjera te shemtuara mbi emigrantet dhe keshtu nuk donim qe ai te largohej. Por erdhi momenti qe edhe ne e kuptuam qe ishte me mire qe ai te nisej sepse ketu nuk kishte pune dhe ajo qe bente shperblehej me nje rroge shume te vogel. Keshtu gjetem mundesine dhe ai iku me trupen e pare te teatrit e cila ikte ne Hollande per nje spektakel dhe ai shkoi me ata si nje anetar I ketij grupi dhe ne kthimin nga Hollande qendroi ne Gjermani. Punoi 5 vjet por nuk ndjehej mire, gjithmone na thoshte qe donte te kthehej dhe qe vendi I tij ishte ketu ne atdheun e vet, edhe ne donim qe ai te kthehej dhe keshtu ne 1999 u kthye per te mos u nisur me.

**A ndryshoi djali yt kur vajti jashte shtetit? A solli nje kulture te re?**

Jo, ai ndejti po ashtu siç ishte, nje djale I thjeshte, I edukuar mire dhe per kete ndihem krenar. Dua te vazhdoj te jetoj me djalin tim, me niperit e mi, me gruan time dhe me nusen time sepse e dua familjen time dhe per kete gje kam hequr dore nga shume gjera dhe nga nje karriere me e mire, per te qendruar me afer atyre dhe per prandaj ndihem krenar qe kam vepruar keshtu.

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II

# PERSHKRIM SHKURTER I AKTIVITETEVE TE CISP NE SHQIPERI

Komiteti internacional per zhvillimin e popujve (CISP) eshte nje organizat jo qeveritare europiane e krijuar 1982 dhe e themeluar formalisht ne 1983. CISP bazen ne Itali dhe operon ne fushen e Kooperimit Internacional. Objektivat e saj jane permbledhur ne Deklaraten e Qellimeve dhe Kodin e Normave per programet e Kooperimit (Prill 1997).

## AKTIVITET KRYESORE

Me qellim per te arritur objektivat e tij, CISP realizon ne bashkepunim te ngushte me partneret lokal, aktivitete specifike te zhvillimit, te rehabilitimit, aktivitete umanitare e programe te kerkimit social e aplikuar ne rreth 30 vende te, Afrikes, Amerikes Latine, Lindjes se Mesme, Azise dhe Europes Lindore. Ne europe CISP realizon aktivitete informimi, formuese, programe arsimore interkulturore dhe te zhvillimit, ashtu si dhe programe kundra racismit dhe ulejs se varferise. Per me teper CISP eshte i angazhuar ne promovimin e politikave kulturore dhe te solidaritetit internacional. Ne kuadrin e Kooperimit Internacional per zhvillim, sektoret kryesor ku ai vepron jane: zhvillimi rural, sigurimi i bazes ushqimore dhe ulja e varferise, shendetesia ne kuadrin rural dhe urban, arsimimi dhe formimi, administrimi i territori dhe burimeve natyrore, mbeshtetje ne proceset e paqes.

## CISP NE SHQIPERI

CISP vepron ne Shqiperi qe nga 1998, sot eshte zyrtarisht i regjistruar ne baze te ligjislacionit vendas qe rregullon aktivitetet e OJQ – ve Internacionale.

*Ne nivelin sektorial*, gjate viteve te para te prezences se tij ne Shqiperi, CISP ka realizuar aktivitete te ndihmes se emergjences dhe fushata informuese ne nivel kombetar ne fushen socio - shendetesore.

Pas krizes se piramidave finanziare ne 1997 ka realizuar projekte te shumta duke u specializuar, ne fazat e pas emergjences, ne fushen socio – shendetesore e ne vecanti persa i perket administrimit te sherbimeve sociale, formimit, mbeshtetjes per shtresat me te dobta te popullsise e ne vecanti te te moshuarve dhe te paafteve, si dhe forcimin e institucioneve ne nivel te decentralizuar. Per me teper, me pas, nje tjeter sektor mbi te cilin jane perqendruar angazhimet eshte ai i zhvillimit urban administrimit e rikualifikimit te territorit dhe te mbrojtes se ambjentit, nder te cilat administrimi i mbeturinave, sensibilizimi dhe informimi mbi tematikat ambientale.

*Ne nivelin gjeografik*, prezenca e CISP eshte perqendruar ne Bashkine e Vlores, Elbasanit, Lacit, Krujes, ne zonat urbane te periferie se Tiranes (Bashkia e Kamzes, dhe lagja Ali Demi) ne zonen e parkut Kombetar te Butrintit dhe ne Bashkite prane Parkut.

*Ne nivelin metodologjik*, nderhyrjet realizohen gjithnje ne bashkepunim me partneret lokal kryesisht me autoritet lokale, insitucionet vendase si dhe me shoqata vendase e OJQ – te. Pjesemarrja aktive ne proceset e zhvillimit dhe realizimit te projekteve, e te gjithe aktoreve present ne territorin ku veprohet, eshte konsideruar thelbesore per nje sukses me te madh per arritjen e objektivave.





# BREVE DESCRIZIONE DELLE ATTIVITÀ DEL CISP IN ALBANIA

Il **Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli (CISP)** e' una Organizzazione Non Governativa europea nata nel 1982 e costituita formalmente nel 1983. Il CISP ha base in Italia e opera nel campo della Cooperazione Internazionale. I suoi obiettivi sono riassunti nella Dichiarazione di Intenti e nel Codice di Condotta per i Programmi di Cooperazione (Aprile 1997).

## ATTIVITÀ PRINCIPALI

Al fine di raggiungere i suoi obiettivi, il CISP realizza, in stretta collaborazione con i partner locali, attività specifiche di sviluppo, di riabilitazione, attività umanitarie e programmi di ricerca sociale applicata in circa 30 paesi in Africa, America Latina, Medio Oriente, Asia, and Europa dell'est.

In Europa il CISP realizza attività di informazione, formazione, programmi di educazione interculturale e allo sviluppo, così come programmi contro il razzismo e di riduzione della povertà. Il CISP e' inoltre, impegnato nella promozione di politiche culturali e di solidarietà internazionale. Nell'ambito della Cooperazione Internazionale allo Sviluppo, i principali settori in cui opera sono: sviluppo rurale, sicurezza alimentare e riduzione della povertà, sanità in ambito rurale ed urbano, educazione e formazione, gestione del territorio e delle risorse naturali, sostegno ai processi di pace.

## IL CISP IN ALBANIA

Il CISP opera in Albania dal 1998, ad oggi è ufficialmente registrato ai sensi della legislazione nazionale che regola l'attività delle ONG internazionali.

*A livello settoriale*, nei primi anni della sua presenza in Albania, il CISP ha realizzato attività di aiuto di emergenza e campagne di informazione a livello nazionale in campo socio-sanitario.

In seguito alla crisi delle piramidi finanziarie del 1997 ha realizzato numerosi progetti specializzandosi, nelle fasi successive all'emergenza, nel campo socio-sanitario in particolare per quanto riguarda la gestione dei servizi sociali, la formazione, il sostegno alle fasce più deboli della popolazione in particolare anziani e disabili, ed il rafforzamento istituzionale a livello decentrato.

Inoltre, più di recente, un altro settore su cui si stanno concentrando gli impegni è quello dello sviluppo urbano e gestione e riqualificazione del territorio e della salvaguardia ambientale, tra cui la gestione dei rifiuti e sensibilizzazione e informazione sulle tematiche ambientali.

*A livello geografico*, la presenza del CISP si e' concentrata nelle Municipalita' di Valona, Elbasan, Laç, Krujà, nelle aree urbane della periferia di Tirana (municipalità di Kamza, e comune di Ali Demi), nell'area del Parco Nazionale di Butrinto e nelle municipalità limitrofe al Parco.

*A livello metodologico*, gli interventi vengono realizzati sempre in collaborazione con partner locali, prevalentemente autorità locali, istituzioni nazionali ed anche associazioni comunitarie di base ed ONG. La partecipazione attiva ai processi di sviluppo e di realizzazione dei progetti, di tutti gli attori presenti sul territorio in cui si opera, è considerata fondamentale per un maggior successo nel raggiungimento degli obiettivi.





Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elbasanit", faza II

**CISP - Comitato Internazionale per lo Sviluppo dei Popoli**

***Sede di Roma - Adresa ne Rome***
Via Germanico, 198 - 00192 ROMA - ITALIA;
Tel.: +39 06 3215498; Fax: +39 06 3216163;
E-mail: cisp@cisp-ngo.org; www.cisp-ngo.org

***Sede di Tirana - Adresa ne Tirane***
Rruga "Deshmoret e 4 Shkurtit"
Tel.: +355 4 250409
E-mail: cisp@icc-al.org

Nen kujdesin e CISP, ne kuadrin e projektit "Fuqizimi i shërbimeve te asistences ne ndihme te te moshuarve ne prefekturen e Elabsanit", faza II